



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 197

Tiranë – E enjte, 12 nëntor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 122/2020, datë 15.10.2020	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar..... 13825
Ligj nr. 123/2020, datë 15.10.2020	Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 13826
Ligj nr. 127/2020, datë 15.10.2020	Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit..... 13826
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 850, datë 4.11.2020	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020–2023 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj..... 13832
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nr. 13618/10, datë 1.10.2020	Gjergo dhe Babicenko kundër Shqipërisë dhe 76 kërkesa të tjera..... 13893
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 44, datë 9.11.2020	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 13920
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 451, datë 28.10.2020	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Gjuhës Blu, të shfaqur në shtetin e Belgjikës, Bullgarisë, Kroacisë, Gjermanisë, Luksemburgut, Zvicrës, Portugalisë, Rumanisë, Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut..... 13921

**LIGJ**
Nr. 122/2020**“Neni 16**
Deklarimi**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.**
9632, DATË 30.10.2006, “PËR SISTEMIN E
TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Paragrafi i parë i nenit 10, ndryshohet, si më poshtë:

“Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, u nënshtrohet detyrimeve të parashikuara në këtë kre.”.

Neni 2

Neni 11, ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 11
Shkalla tatimore

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero).”.

Neni 3

Neni 15 shfuqizohet.

Neni 4

Neni 16, ndryshohet, si më poshtë:

Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore.”.

Neni 5

Paragrafi i parë i nenit 17, ndryshohet, si më poshtë:

“Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore është e ngarkuar me vlerësimin dhe kontrollin e tatimpaguesve, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.”.

Neni 6

Nenet 18 dhe 19, shfuqizohen.

Neni 7

Në nenin 27, pika 9, pas fjalëve “investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave” hiqen fjalët “të destinuara për qëllime banimi”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2021, me përjashtim të nenit 7, i cili hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 15.10.2020

**LIGJ**
Nr. 123/2020**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.**
92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E
SHTUAR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Pas pikës 8, të nenit 49, “Shkallët e reduktuara”, shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“9. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të punimeve të ndërtimit për investimet shtetërore të klubeve sportive/federatave sportive apo për investimet e subjekteve private në infrastrukturën sportive, të përcaktuar në legjislacionin e fushës për sportin, është në nivelin 6 për qind.”.

Neni 2

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2021.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 15.10.2020

LIGJ
Nr. 127/2020**PËR REGJISTRIMIN, MËNYRËN E**
PËRDORIMIT DHE KONTROLLIN E
MJETEVE LUNDRUESE TURISTIKE
DHE TË ARGËTIMIT

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I**Neni 1**
Qëllimi

Ky ligj rregullon mënyrën elektronike të regjistrimit, të përdorimit dhe të kontrollit të mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit, të klasifikuara si të tilla nga shoqëria klasifikuese, me kapacitet deri në 12 pasagjerë, pa përfshirë ekuipazhin e mjetit lundrues, me motor me fuqi mbi 30 kilovatë/orë (KW) ose 40.8 kuaj/fuqi (KF) dhe tonazh nën 500 grostonë (GT).

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit, të klasifikuara si të tilla nga shoqëria klasifikuese, me kapacitet deri në 12 pasagjerë, pa përfshirë ekuipazhin e mjetit lundrues, me motor me fuqi mbi 30 KW ose 40.8 KF dhe tonazh nën 500 GT, që mbajnë flamurin shqiptar ose përdorin hapësirën detare shqiptare dhe ujërat e brendshme tokësore.

2. Ky ligj nuk zbatohet për mjetet lundruese në përdorim të Forcave të Armatosura, të kapitanerisë së porteve, të forcave të policisë, të doganave dhe të organeve të tjera të parashikuara me ligj.



Neni 3 Përkufizime

1. Për qëllimin e këtij ligji përkufizimet kanë këto kuptime:

a) “Certifikatë regjistrimi” është dokumenti që përfitohet pas regjistrimit të pronësisë për mjete lundruese mbi 15 ml.

b) “Certifikatë sigurie apo të klasit” është dokumenti i lëshuar nga shoqëria klasifikuese, krijuar sipas dispozitave të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.

c) “Deti territorial” përfshin hapësirën detare nga vija e drejtë bazë në drejtim të detit në distancën 12 milje detare ose me vijën delimituese të arritur me marrëveshje me fqinjët detarë.

ç) “Dëshmi drejtimi për mjete të vogla lundruese” është dokumenti i aftësisë së drejtimit të mjetit.

d) “Dëshmi e aftësisë së lundrimit për mjete të vogla lundruese” është dëshmia e regjistrimit për mjete të vogla lundruese deri në 15 ml.

dh) “Hapësira detare” përfshin detin e brendshëm dhe detin territorial të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të Konventës së OKB-së për të drejtën e detit 1982, ratifikuar me ligjin nr. 9055, datë 24.4.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën mbi të Drejtën e Detit të OKB-së”.

e) “Mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtim” janë mjetet sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me tonazh nën 500 GT, që kanë një fuqi të përgjithshme të motorit ose të motorëve të marrë së bashku më të lartë se 30 KW ose 40.8 KF, të klasifikuara si të tilla nga Regjistri Detar Shqiptar ose nga institucionet korresponduese të shteteve të tjera, që përdoren për qëllime turistike dhe argëtimi.

ë) “Regjistri Elektronik i Detarëve të Mjeteve Lundruese” është regjistri elektronik i detarëve, që disponojnë dëshminë profesionale përkatëse për të drejtuar dhe/ose punuar me mjetet lundruese, objekt i këtij ligji.

f) “Regjistri Elektronik i Mjeteve Lundruese” është regjistri elektronik i mjeteve lundruese objekt i këtij ligji.

g) “Regjistrim” është regjistrimi fillestar i mjeteve lundruese në regjistrin fizik të pronësisë.

gj) “Sistemi i posaçëm elektronik për lëvizjen e mjeteve lundruese” është sistemi elektronik i raportimit të aktivitetit lundrues të mjeteve të përshkruara në këtë ligj.

h) “Ujëra të brendshme tokësore” përfshijnë edhe hapësirat ujore në territorin tokësor, si: lumenjtë, liqenet, rezervuarët, kënetat etj.

i) “Ujërat e brendshme” ka të njëjtin kuptim sipas legjislacionit në fuqi për aktivitetet e turizmit detar.

j) “ZRMLD” është zyra e regjistrimit të mjeteve lundruese dhe detare pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

k) “Regjistri Elektronik i Shërbimeve të Mjeteve Lundruese” është regjistri elektronik i subjekteve që prodhojnë, rristrukojnë apo riparojnë mjete lundruese, që rregullohen me këtë ligj, si dhe çdo veprim apo ndërhyrje që kryhet në mjetet lundruese.

l) “Survejimi i mjeteve lundruese” është shërbimi që kryhet nga subjekte fizike ose juridike të licencuara, i cili mund të delegohet nga autoritetet përkatëse të administratës detare apo pronarët e anijeve për të kryer inspektime dhe survejime në mjetet lundruese dhe dhënien e rekomandimeve.

KREU II

Neni 4

Procedura e regjistrimit, lëshimit të certifikatës së sigurisë apo të klasit dhe drejtimit të mjeteve lundruese turistike dhe argëtimit

1. Aplikimi për regjistrimin e mjeteve lundruese bëhet pranë ZRMLD-së, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, nga pronari ose personi i autorizuar prej tij.

2. Në funksion të regjistrimit ose lëshimit të certifikatës, administrata detare apo shoqëria klasifikuese e njohur prej saj kryen verifikimet, sipas parashikimeve ligjore, nëpërmjet inspektorëve të saj ose personave fizikë/juridikë të licencuar për ushtrimin e veprimtarisë së survejimit të mjeteve lundruese.

3. Subjekti i licencuar për kryerjen e shërbimit të survejimit, pas njohjes nga administrata detare, verifikon mjetin dhe dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim.



4. Lëshimi i certifikatave të sigurisë dhe të klasit bëhet nga shoqëria klasifikuese e njohur nga administrata detare shqiptare. Periudha e vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë do të përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin detar.

5. Për certifikatat e lëshuara nga shoqëri klasifikuese të huaja, shoqëria klasifikuese e njohur nga administrata detare shqiptare lëshon certifikatën përkatëse shqiptare.

6. Shoqëritë klasifikuese të huaja, të cilat do të njihen nga shoqëria klasifikuese e njohur nga administrata detare shqiptare, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin detar.

7. Drejtimi i mjeteve lundruese, objekt i këtij ligji, bëhet nga persona të kualifikuar. Kriteret e kualifikimit dhe kategorive të drejtimit të këtyre mjeteve përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin detar.

Neni 5

Detyrimi i përgjithshëm

1. Mjetet lundruese, objekt i këtij ligji, duhet të respektojnë rregullat dhe normat e regjimit të lundrimit në det dhe në ujërat e brendshme tokësore, sipas parashikimeve të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Mjetet lundruese shqiptare, objekt i këtij ligji, duhet të jenë të pajisura me Sistemin Automatik të Identifikimit (AIS) në zbatim të konventës ndërkombëtare “Për sigurinë e jetës në det (SOLAS)” dhe ta kenë funksional përgjatë gjithë periudhës që ndodhen në hapësirën detare shqiptare.

3. Mjetet lundruese, objekt i këtij ligji, në çdo rast duhet të kenë në bord dhe të paraqesin me kërkesën e autoriteteve përgjegjëse dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) dokumentin e identifikimit;
- b) certifikatën e sigurisë së mjetit lundrues ose dokumente të tjera të klasit;
- c) dëshminë e aftësisë së lundrimit për mjetin e vogël lundrues ose certifikatën e regjistrimit;
- ç) dëshminë e aftësisë së drejtimit për mjetin lundrues;
- d) policën e sigurimit për dëmet ndaj të tretëve.

4. Mjetet lundruese me fuqi motorike më të vogël se 30 KW ose 40.8 KF, me distancë lundrimi deri në 1 milje nga bregu, regjistrohen vetëm në ZRMLD.

5. Mjetet lundruese, të parashikuara në pikën 4 të këtij neni, zbatojnë të gjitha rregullat dhe detyrimet e sigurisë e të lundrimit të parashikuara në këtë ligj, por përjashtohen nga pajisja me sistemin GPS. Drejtuesit e këtyre mjeteve përjashtohen nga detyrimi për t'u pajisur me dëshmi aftësie drejtimi.

Neni 6

Njoftimi për operimin e mjetit lundrues

1. Mjetet lundruese turistike dhe ato për qëllime argëtimi njoftojnë kapitanerinë e portit nëpërmjet sistemit të posaçëm elektronik, në nisje dhe në mbërritje.

2. Njoftimi për hyrjen dhe daljen ose lëvizjen në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë bëhet në sistemin e posaçëm elektronik të lëvizjes së mjeteve lundruese.

3. Njoftimi për lëvizje duhet të përfshijë si më poshtë:

- a) emrin e mjetit, numrin e regjistrimit;
- b) emrin e drejtuesit të mjetit;
- c) orën e përafërt të nisjes/mbërritjes;
- ç) destinacionin;
- d) numrin dhe gjeneralitetet e personave në bord.

Neni 7

Regjistri Elektronik i Mjeteve Lundruese

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare krijon, mirëmban dhe përditëson Regjistrin Elektronik të Mjeteve Lundruese.

2. Me qëllim kryerjen e verifikimeve të nevojshme brenda fushës së përgjegjësisë, në këtë sistem do të kenë të drejtë aksesit organet shtetërore të njohura me ligj.

3. Regjistri Elektronik i Mjeteve Lundruese do të vendoset në funksion nga data 1 janar 2022.

4. Deri në vënien në funksionim të Regjistrat Elektronik shkëmbimi i informacionit me institucionet ligjore do të kryhet në rrugë elektronike nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

5. Përmbajtja, formati, rregullat e krijimit dhe të përditësimit të regjistrave elektronikë të



mjeteve lundruese dhe të sistemit të posaçëm elektronik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin detar dhe ministrit përgjegjës për Policinë e Shtetit.

6. Funksionimi i regjistrave elektronikë dhe i sistemit të posaçëm elektronik për lëvizjen e mjeteve lundruese do të miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin detar dhe ministrit përgjegjës për Policinë e Shtetit.

KREU III

Neni 8

Deklarimi pas importimit

1. Subjekti që importon një mjet lundrues, objekt i këtij ligji, përveç ndjekjes së procedurave doganore të parashikuara, duhet të bëjë deklarimin me shkrim tek autoritetet e Policisë Kufitare, pranë pikave të kalimit kufitar, duke shënuar vendqëndrimin dhe vendbazimin e mjetit lundrues, gjeneralitetet e pronarit ose të bashkëpronarëve, si dhe të subjektit importues.

2. Brenda 10 ditëve nga importimi, pronari ose bashkëpronarët duhet të bëjnë regjistrimin e mjetit lundrues pranë ZMRLD-së.

Neni 9

Ndryshimi i kushteve dhe pronësisë

1. Çdo subjekt që përfiton ose mban me çfarëdolloj titulli një mjet lundrues ose pjesë të tij, duhet të bëjë deklarimin brenda 24 orëve nga marrja në zotërim ose në mbajtje në sistemin e posaçëm për deklarimin e lëvizjes së mjetit, duke shënuar gjeneralitetet dhe vendqëndrimin e tij, vendbazimin e përhershëm të mjetit, si dhe gjeneralitetet e pronarit ose të bashkëpronarëve.

2. Pronari ose bashkëpronarët e mjetit lundrues dhe personi i autorizuar janë të detyruar të njoftojnë brenda 24 orëve në sistemin e posaçëm për deklarimin e lëvizjes së mjeteve çdo ndryshim që ka të bëjë me një ose disa nga kushtet e mëposhtme:

a) ndryshimi i titullarit të pronës ose të përdorimit;

b) zëvendësimi i personit të autorizuar për drejtimin e mjetit ose përdoruesit të mjetit;

c) ndryshimi i vendbanimit të personave të mësipërm;

ç) ndryshimi i vendbazimit të përhershëm të mjetit;

3. Pronari ose bashkëpronarët e mjetit lundrues dhe personi i autorizuar janë të detyruar të bëjnë ndryshimin e pronësisë pranë ZRMLD-së brenda 10 ditëve.

4. Brenda 5 ditëve nga paraqitja e njoftimit të ndryshimit, ZRMLD-ja duhet të bëjë regjistrimin e ri dhe të lëshojë një dëshmi të re lundrimi.

5. Deri në lëshimin e dëshmisë së re të lundrimit, mjeti lundrues nuk mund të zhvendoset nga vendi i ruajtjes dhe as të përdoret për çfarëdolloj qëllimi.

6. ZRMLD-ja njëkohësisht me ndryshimet në regjistrat fizikë bën edhe ndryshimin në Regjistrin Elektronik të Mjeteve Lundruese.

KREU IV

Neni 10

Fabrikat dhe kantieret detare

1. Fabrikat dhe kantieret detare, të certifikuara nga shoqëria klasifikuese e njohur nga administrata detare shqiptare, që ndërtojnë, rristrukturojnë objekte të këtij ligji, ndërveprojnë me regjistrin elektronik të shërbimeve të mjeteve lundruese për ndërtimin, rikonstruktimin dhe riparimin.

2. Në regjistër do të shënohen në mënyrë kronologjike të dhënat që kanë të bëjnë me çdo prodhim, rristrukturim e riparim: modeli, numri i matrikullës së prodhimit, emri i mjetit, gjeneralitetet e plota të blerësit, të pronarit, të bashkëpronarëve ose të ceduesit dhe atij që e ka transportuar e dorëzuar mjetin lundrues.

KREU V

Neni 11

Mjetet lundruese të regjistruara jashtë shtetit

1. Shtetasi shqiptar, shtetasi i huaj ose pa shtetësi, pronar ose mbajtës i mjeteve lundruese, që nuk janë të regjistruara në Shqipëri, duhet të deklarojë në sistemin e posaçëm elektronik për lëvizjen e mjeteve lundruese në çastin e



mbërritjes në port, përveç të dhënave të tjera, kohën e parashikuar të qëndrimit në ujërat territoriale shqiptare.

2. Përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni dhe detyrimeve të tjera që rrjedhin nga legjislacioni për lundrimin, pronarët ose mbajtësit e mjeteve lundruese, të regjistruara jashtë shtetit, të cilët duan të qëndrojnë në ujërat territoriale shqiptare për një periudhë më të gjatë se 18 muaj, i nënshtrohen detyrimit të regjistrimit.

3. Për regjistrimin e tyre duhet të paraqiten dokumentet sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e mjeteve lundruese.

Neni 12

Kontrollet e mjeteve lundruese

1. Mbi bazën e regjistrave elektronikë të administrimit të mjeteve lundruese, sistemit të posaçëm elektronik për lëvizjen e mjeteve lundruese dhe mbi bazën e analizës së riskut, Policia Kufitare ushtron kontrolle specifike për dokumentacionin, për zbatimin e rregullave të lundrimit dhe të sigurisë së mjeteve lundruese, objekt të këtij ligji, si dhe për veprime të kundërligjshme brenda fushës së kompetencës.

KREU VI

Neni 13

Ndalime

1. Personat, të cilët janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi në fushën e terrorizmit, trafikimit të qenieve njerëzore, të lëndëve narkotike, të armëve, të lëndëve kimike dhe radioaktive, të kalimit të paligjshëm të kufirit, ose të transportit të kundërligjshëm të mjeteve monetare, nuk kanë të drejtë të drejtojnë ose të mbajnë në përdorim të çdo lloj forme mjete lundruese, objekt të këtij ligji. Përdoruesi i mjetit lundrues, përpara marrjes së kualifikimit të drejtimit të mjetit lundrues, objekt i këtij ligji, plotëson formularin e vetëdeklarimit, ku deklaron se nuk rezulton i dënuar për veprat e lartpërmendura. Formulari i vetëdeklarimit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për transportin detar.

2. Ndalohet përdorimi i mjeteve lundruese të paregjistruara.

KREU VII SANKSIONET

Neni 14

Kundërvajtjet administrative

1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) mungesa e regjistrimit të pronësisë së mjetit brenda afatit të parashikuar në nenet 8 dhe 9, të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë;

b) mungesa në bordin e mjetit lundrues e dokumenteve të përmendura në nenin 5, të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë dhe me bllokim administrativ të mjetit lundrues;

c) refuzimi për vendosjen në dispozicion të dokumenteve të parashikuara në nenin , të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe me bllokim administrativ të mjetit lundrues për 30 ditë;

ç) mosdeklarimi i importimit në përputhje me pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe me bllokimin administrativ të mjetit lundrues për 60 ditë;

d) mosdeklarimi në sistem i zotërimit ose i mbajtjes së mjetit lundrues brenda afatit dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe me bllokim administrativ të mjetit lundrues për 60 ditë;

dh) përdorimi i një mjeti lundrues, objekt i këtij ligji, të paregjistruar, dënohet me gjobë në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe bllokim administrativ të mjetit për 60 ditë;

e) falsifikimi i karakteristikave teknike të mjetit lundrues, i fuqisë së motorit ose të motorëve, ose ndryshimi i tyre pa i deklaruar pranë ZRMLD-së, dënohet me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe me bllokim të mjetit lundrues;

ë) mosmbajtja e regjistrave në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 10, të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë;

f) mosdeklarimi i ndryshimeve të parashikuara në nenin 9, të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Nëse kjo



shkelje përsëritet, dënohet me dyfishin e gjobës dhe bllokimin e mjetit lundrues për 30 ditë;

g) transporti me një mjet lundrues, objekt i këtij ligji, të një numri jo më të madh se 1/2 e personave mbi limitin e përcaktuar në lejen e lundrimit dhe në certifikatën e sigurisë apo të klasit, dënohet me gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo person mbi numrin e lejuar;

gj) transporti me një mjet lundrues, objekt i këtij ligji, të një numri më të madh se 1/2 e personave mbi limitin e përcaktuar në lejen e lundrimit dhe në certifikatën e sigurisë apo të klasit, dënohet me gjobë në masën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe me bllokim të mjetit lundrues për 30 ditë;

h) kryerja nga mjeti lundrues, objekt i këtij ligji, i një veprimtarie të kundërligjshme në fushën e terrorizmit, të trafikut të qenieve njerëzore, të trafikut të lëndëve narkotike, të armëve, të lëndëve kimike dhe radioaktive, transportit të kundërligjshëm të mjeteve monetare, dënohet me konfiskim të mjetit lundrues dhe të çdo mjeti tjetër që ka shërbyer për transportin e tij;

i) shkelja e kalimit paqësor dënohet me gjobë në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë;

j) drejtimi i mjetit lundrues nën efektin e pijeve alkoolike ose të substancave narkotike apo psikotrope dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe me heqje të dëshmisë së aftësisë për drejtimin e mjetit lundrues për 60 ditë;

k) shkelja e ndalimit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 13, të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe bllokim të mjetit lundrues për 30 ditë.

2. Në rast konstatimi të shkeljes së parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, pronari, bashkëpronari ose drejtuesi i mjetit lundrues ka detyrimin që brenda 2 ditëve të vendosë në dispozicion të zyrës kompetente të Policisë Kufitare dokumentet e kërkuara. Nëse këto dokumente nuk paraqiten brenda këtij afati, mjeti lundrues bllokohet me urdhër të drejtuesit të zyrës së Policisë Kufitare kompetente për 90 ditë. Mosparaqitja e dokumenteve edhe gjatë kësaj periudhe kohore, sjell si pasojë konfiskimin e mjetit lundrues.

3. Në rast përsëritjeje më shumë se një herë të shkeljeve të parashikuara në shkronjën “ë”, të

pikës 1, të këtij neni, dënimi me gjobë shoqërohet me mbylljen e fabrikës apo të kantierit detar nga 30 deri në 60 ditë.

4. Oficeri ose agjenti i Policisë Kufitare, që ka bërë kontrollin, zbaton masat e dënimit të përcaktuara në këtë nen, duke respektuar procedurën e parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

5. Shpenzimet e depozitimit të mjetit lundrues përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e brendshme dhe janë në ngarkim të kundërvajtësit.

KREU VIII

Neni 15

Pjesët e mjeteve lundruese

Dispozitat e parashikuara në sanksionet e këtij ligji zbatohen edhe kur bëhet fjalë për pjesë të mjeteve lundruese, të cilat në bazë të të dhënave të bazuara, të vendndodhjes, të mënyrës së fshehjes në ngarkim të pronarit ose të bashkëpronarëve, të mbajtësit ose të zotëruesit, janë të destinuara për formimin, ndryshimin ose montimin e mjeteve lundruese.

KREU IX

Neni 16

Ruajtja gjyqësore e mjeteve të sekuestruara e të konfiskuara

Mjetet lundruese, të sekuestruara e të konfiskuara në bazë të këtij ligji, i besohen në ruajtje institucionit përgjegjës për Rezervat Materiale të Shtetit.

Neni 17

Përdorimi i mjeteve të konfiskuara

1. Mjetet lundruese që kanë kryer shkeljet e parashikuara në nenin 14, pika 1, shkronja “i”, të këtij ligji, pasi konfiskohen, bëhen pronë e shtetit.

2. Institucioni përgjegjës për Rezervat Materiale të Shtetit, sipas akteve ligjore në fuqi, me kërkesë të Departamentit për Kufirin e Migracionin dhe me miratim të organeve përgjegjëse, mjetet lundruese të konfiskuara ia jep



në përdorim Policisë së Shtetit për kryerjen e detyrave institucionale.

Neni 18
Ankimi administrativ

1. Për masat administrative me gjobë dhe bllokim administrativ, të marra në bazë të këtij ligji, kundërvajtësi mund të bëjë ankim brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim tek autoriteti kompetent që ka nxjerrë ose ka kompetencë të nxjerrë aktin.

2. Kur organi publik kompetent vlerëson se ankimi nuk është i pranueshëm dhe plotësisht i bazuar, pa vonesë dhe pa u shprehur mbi të, e përcjell atë për shqyrtim dhe vendimarrje tek organi epror së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse të dosjes dhe një raport me shkrim të qëndrimit të tij.

3. Ndaj vendimeve të marra sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, kundërvajtësi mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 19
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 7, pika 5, të tij.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për transportin detar dhe ministria përgjegjëse për Policinë e Shtetit, që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të nenit 7, pika 6, të tij.

3. Ngarkohet ministria përgjegjëse për transportin detar, që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, pikat 4, 6 e 7, dhe 13, pika 1, të tij.

4. Ngarkohen ministria përgjegjëse për transportin detar dhe ministria përgjegjëse për Policinë e Shtetit, që brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për rregullat dhe mënyrën e zbatimit të sanksioneve administrative të parashikuara në nenin 14 të tij.

Neni 20

Dispozitat kalimtare

Deri në vënien në funksionim të Regjistrat Elektronik të Mjeteve Lundruese, informacioni për regjistrimin e mjeteve lundruese do t'u dërgohet çdo muaj, në rrugë elektronike, drejtorive vendore të kufirit dhe migracionit të Policisë së Shtetit.

Neni 21

Dispozitat përfundimtare

1. Dispozitat e ligjit nr. 7873, datë 16.11.1994, “Për sekuestrimin e mjeteve tokësore, detare dhe ajrore, me të cilat kryhen vepra penale” nuk zbatohen për mjetet lundruese, objekt të këtij ligji.

2. Ligji nr. 8663, datë 18.9.2000, “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 15.10.2020

VENDIM
Nr. 850, datë 4.11.2020

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
KOMBËTARE PËR PROKURIMIN
PUBLIK 2020–2023 DHE TË PLANIT TË
VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020–2023 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.



2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia e Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Departamenti i Administratës Publike dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR PROKURIMIN PUBLIK 2020–2023

Përmbajtja

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit

2. Kuadri ligjor dhe institucional, arritjet, mësimet

2.1 Kuadri ligjor

2.2 Kuadri institucional

2.3 Arritjet

2.4 Mësimet

3. Vizioni i Strategjisë

3.1 Vizioni

3.2 Treguesit e impaktit dhe treguesit e rezultatit

PJESA II: QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË

4. Qëllimi i politikës 1 – Prokurim publik eficient dhe i qëndrueshëm

4.1 Objektivi specifik 1 – Përmirësimi i legjislacionit të prokurimit dhe përafrimi me *acquis* të BE-së

4.2 Objektivi specifik 2 – Fuqizimi i rolit dhe kapaciteteve të Agjencisë së Prokurimit Publik

4.3 Objektivi specifik 3 – Organizimi dhe profesionalizimi i funksionit të prokurimit

4.4 Objektivi specifik 4 – Rritja e eficiencës në prokurimin publik

4.5 Objektivi specifik 5 – Zgjerimi i politikave dhe i metodave për prokurimin e qëndrueshëm

4.6 Objektivi specifik 6 – Forcimi i integritetit në prokurimin publik

4.7 Objektivi specifik 7 – Përmirësimi i sistemit elektronik të prokurimit

5. Qëllimi i politikës 2 – Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për koncesionet dhe partneritetin publik-privat

5.1 Objektivi specifik 1 – Reforma rregullatore

5.2 Objektivi specifik 2 – Kuadri institucional

6. Qëllimi i politikës 3 – Riorganizimi i prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë

6.1 Objektivi specifik 1 – Përmirësimi i kuadrit rregullator të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

6.2 Objektivi specifik 2 – Përmirësimi i kuadrit institucional për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

7. Qëllimi i Politikës 4 – Blerja e përqendruar

7.1 Objektivi specifik 1 – Veprimtaria e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara

7.2 Objektivi specifik 2 – Blerja e përqendruar në fushën e shëndetësisë

8. Qëllimi i politikës 5 – Përmirësimi i sistemit të shqyrtimit të ankesave

PJESA III: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

PJESA IV: PLANI I VEPRIMIT DHE BURIMET FINANCIARE PËR ZBATIM

ANEKSI 1: PLANI I VEPRIMIT

ANEKSI 2: PLANI I VEPRIMIT I KOSTUAR DHE I DETAJUAR

ANEKSI 3: PASAPORTA E INDIKATORËVE.

PJESA I KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit

Prokurimi publik është një fushë dinamike që ndryshon dhe evoluon në mënyrë të vazhdueshme si pasojë edhe e ndryshimeve të klimës së tregtisë dhe të biznesit, si dhe të zhvillimeve e përmirësimeve të teknologjisë.

Për më tepër, prokurimi publik ka një natyrë ndërsektoriale, duke qenë ngushtësisht i lidhur në mënyrë reciproke me fusha të tjera të



rëndësishme, si: konkurrenca e lirë dhe e ndershme, lufta kundër korrupsionit, mbrojtja e shëndetit dhe e konsumatorit, mbrojtja e mjedisit, klima e biznesit dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), zhvillimi i qëndrueshëm etj.

Në këtë kuptim, prokurimi publik është konsideruar vazhdimisht si një mjet i domosdoshëm për qeverinë, nëpërmjet të cilit jo vetëm sigurohet dhënia e shërbimeve të nevojshme për popullsinë, por njëkohësisht garantohet mirëqenia dhe siguria e qytetarëve.

Për këto arsye, prokurimi publik është një nga fushat kryesore, të cilat janë vazhdimisht në vëmendjen e raporteve të ndryshme monitoruese dhe vlerësuese, ku ndër më kryesoret përmenden:

1. Raportet vjetore të Komisionit Evropian;
2. Raporti monitorues i SIGMA-s i 2017-ës, “Për zbatimin e parimeve të administratës publike”;
3. Raporti i Bankës Botërore i 2017-ës, “Për prokurimin dhe zbatimin e kontratave në Shqipëri”.

Të gjitha këto dokumente, pavarësisht progresit të bërë në disa aspekte, kanë identifikuar një sërë problematikash, të cilat kanë qenë vazhdimisht të pranishme në Shqipëri prej vitesh, si: i. numri i lartë i procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës; ii. përdorimi i ulët i marrëveshjeve kuadër; iii. nevoja e vazhdueshme për ngritje kapacitetesh; iv. nevoja për rritjen e transparencës; v. mungesa e stafit në institucionet rregullatore dhe politikëbërëse; v. vonesa në procesin e shqyrtimit të ankesave; vi. probleme në zbatimin e kontratave; vii. prokurim i përqendruar joeficient; viii. nevoja për harmonizimin e plotë të legjislacionit shqiptar në fushën e prokurimit publik me atë të BE etj.

Për më tepër, dokumente të tilla shprehin domosdoshmërinë për të përmirësuar sistemin në mënyrë që fusha e prokurimit publik të përafrojë kuadrin e saj ligjor, institucional dhe operacional me standardet dhe kriteret e BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Duke marrë në konsideratë problemet e sipërcituara, Qeveria Shqiptare ka përcaktuar prokurimin publik si një nga fushat kryesore reformuese për periudhën 2017–2021, duke u përqendruar, veçanërisht, në rritjen e

transparencës dhe në uljen e numrit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Nga ana tjetër, prokurimi publik lidhet ngushtësisht me prioritetet dhe objektivat strategjike të përfshira në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015–2020¹, konkretisht: i. 8.8 Reformimi i administratës publike dhe i shërbimit civil; ii. 8.9 Transparenca dhe lufta kundër korrupsionit; iii. 9.2 Forcimi i financave publike dhe stabiliteti fiskal etj.

Në këtë kuadër, prokurimi publik është një nga fushat kryesore të përfshira në strategjitë më të rëndësishme të Qeverisë Shqiptare, në të cilat janë përcaktuar prioritetet dhe objektivat për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, në raport me objektivat e përgjithshëm të dokumenteve strategjike të mëposhtme:

1. Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike;
2. Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit;
3. Strategjia për Reformën në Administratën Publike.

Pavarësisht të gjitha arritjeve të deritanishme, mbeten ende disa çështje, të cilat nevojiten që të adresohen, me qëllim garantimin e një sistemi prokurimi eficient dhe të qëndrueshëm në Shqipëri.

Për sa më sipër, dokumenti i paraqitur më poshtë synon që të identifikojë të gjithë objektivat kryesorë strategjike në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të sistemit të prokurimit, si edhe masat e nevojshme që duhen ndërmarrë për arritjen e këtyre objektivave.

2. Kuadri ligjor dhe institucional, arritjet, mësimet

2.1 Kuadri ligjor

Legjislacioni aktual në fushën e prokurimit publik është i përbërë nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Këto instrumente ligjore janë të bazuara në direktivën 2004/18/EC, “Për

¹ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020: <https://qbz.gov.al/share/GFu54aScSfCyykN99wZVCg>.



koordinimin e procedurave të prokurimit për dhënien e kontratave publike për punë, furnizime dhe shërbime” (direktiva e sektorit publik), direktivën 2004/17/EC, “Për koordinimin e procedurave të prokurimit të enteve që veprojnë në sektorin e shërbimit ujor, energjetik, të transportit dhe postar” (direktiva e utiliteteve), të cilat tashmë janë të shfuqizuara nga direktivat e reja të vitit 2014, si dhe në direktivën 2007/66/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, e datës 11 dhjetor 2007, që ndryshon direktivat 89/665/EC dhe 92/13/EC sa i takon rritjes së efektshmërisë për procedurat e shqyrtimit të kontratave publike.

Gjithashtu, legjislacioni në fushën e prokurimit publik përmban dy vendime të Këshillit të Ministrave, të cilat rregullojnë dhe më tej prokurimin e përqendruar në nivel qeverie, konkretisht VKM nr. 81, datë 14.2.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara”, dhe VKM nr. 82, datë 14.2.2018, “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”.

Si ndërveprues me fushën e prokurimit publik në Shqipëri është dhe fusha e koncesioneve dhe PPP-ve, e cila rregullohet nga ligji 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, i cili bazohet në direktivën 2014/23/BE për dhënien e kontratave të koncesionit. Ky ligj mbështetet edhe nga tri akte nënligjore, konkretisht: VKM nr. 280, datë 7.4.2020, “Për miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit të komitetit të përzgjedhjes të projekteve të koncesionit/PPP dhe kriteret për vlerësimin e kërkesave të autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar”; VKM nr. 285, datë 10.4.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO).

Së fundmi, si pjesë e fushës së prokurimit publik është edhe prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, e cila rregullohet nëpërmjet akteve nënligjore të miratuara me VKM apo udhëzime të nxjerra nga secili institucion, sipas fushës përkatëse pa pasur

rregulla të qarta dhe të unifikuara. Gjithsesi, me finalizimin e ligjit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë dhe miratimin e tij nga Kuvendi në muajin prill 2020, këto lloj prokurimesh do të rregullohen nëpërmjet këtij ligji, i cili është hartuar në përputhje me direktivën 2009/81/EC për prokurimet në këtë fushë. Në mënyrë që ligji i ri të jetë plotësisht i zbatueshëm, është e nevojshme hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore përkatëse, për të cilat është parashikuar një periudhë tranzitore.

2.2 Kuadri institucional

Institucionet përgjegjëse për këto fusha janë si më poshtë:

- Agjencia e Prokurimit Publik;
- Komisioni i Prokurimit Publik;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (ATRAKO);
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Brendshme;
- Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Agjencia e Prokurimit Publik (APP) është institucioni politikëbërës në fushën e prokurimit publik në Shqipëri dhe disa prej detyrave kryesore të saj janë propozimi i masave rregulluese, verifikimi i ligjshmërisë së sistemit të prokurimit publik, përgatitja e dokumenteve standarde të tenderit, asistimi dhe hartimi i programeve për ngritjen e kapaciteteve në fushën e prokurimit publik, si dhe përjashtim i operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik. Në shkallë hierarkike, APP-ja është institucion buxhetor dhe është nën varësi të Këshillit të Ministrave. Fushëveprimi i saj përcaktohet qartazi në nenin 13, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është organi më i lartë administrativ për shqyrtimin e ankesave në fushën e prokurimeve. KPP-ja është institucion i pavarur, anëtarët e të cilit zgjidhen nga Parlamenti, në vijim të një procedure përzgjedhëse të zhvilluar nga Këshilli i Ministrave dhe raporton para Parlamentit. KPP-ja shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, procedurat konkurruese për koncesionet dhe PPP-të dhe lejet minerare.

Agjencia për Trajtimin e Koncesioneve (ATRAKO) është një institucion në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe ndër



detyrat kryesore të saj është dhënia e asistencës për Autoritetet Kontraktore në projektet koncesionare dhe partneritetet publike-private, si dhe në zhvillimin e procedurave, dhënien e asistencës në hartimin dhe unifikimin e dokumenteve standarde të tenderit për procedurat koncesionare/PPP dhe organizimin e trajnimeve për stafin, që zbaton projektet e koncesionit/PPP. Kompetencat e ATRAKO-s janë të përcaktuara në ligjin 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar.

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara është një institucion buxhetor në varësi të Ministrisë së Brendshme dhe funksionon si organ qendror blerës për Kryeministrinë, ministrinë e linjës dhe institucionet e varësisë. ABP-ja i ushtron kompetencat e saj bazuar në VKM-në nr. 81, datë 14.2.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara”, dhe VKM-në nr. 82, datë 14.2.2018, “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”.

Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme janë institucionet kryesore përgjegjëse për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

2.3 Arritjet

Sa i takon prokurimit publik, nga fundi i vitit 2017 dhe gjatë vitit 2018 janë marrë një sërë masash dhe janë miratuar një sërë aktesh nënligjore, të cilat synonin rritjen e transparencës në procedurat e prokurimit dhe të eficiencës në përdorimin e fondeve publike. Si rrjedhojë e këtyre masave të ndërmarra, në dy vitet e fundit ka pasur një rritje të konsiderueshme të përdorimit të marrëveshjeve kuadër nga 61 për vitin 2017 në 763 për vitin 2019. Një tjetër rezultat pozitiv ka qenë dhe ulja e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës nga 2234 për vitin 2017 në 192 për vitin 2019.

Sa i takon rishikimit administrativ në fushën e prokurimit publik, u bë e mundur që me anë të ndryshimeve ligjore të kryera në vitin 2017, konkretisht nëpërmjet ligjit 47/2017, të rritej pavarësia e institucionit të KPP-së, duke

parashikuar përzgjedhjen e anëtarëve të tij nga Kuvendi. Gjithashtu, një nga parashikimet e këtij ligji, i cili ndikon njëkohësisht, në rritjen e pavarësisë së këtij institucioni si edhe në rritjen e përgjegjshmërisë së tij, është edhe fakti se rregullat për organizimin dhe funksionimin e tij tashmë miratohen nga vetë KPP-ja.

Sa u takon blerjeve të përqendruara, me VKM-në nr. 81, datë 14.2.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara”, duke parë eficiencën dhe efikasitetin e Organit Qendror Blerës, u vendos ngritja dhe fuqizimi i Organit Qendror Blerës, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP) duke e riorganizuar, për herë të parë, në formën e një institucioni në varësi të Ministrit të Brendshëm, me personalitet juridik të veçantë, duke plotësuar kushtin për të qenë organ qendror blerës, në përputhje me dispozitat e ligjit për prokurimin publik dhe rregullat e prokurimit publik. Ndërsa, me VKM-në nr. 82, datë 14.2.2018, “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, Organit Qendror Blerës i janë zgjeruar kompetencat.

Sa u takon koncesioneve dhe partneritetit publik privat, në vitin 2019 Kuvendi miratoi ligjin nr. 50/2019, datë 18.7.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/, ‘Për koncesionet dhe partneritetin publik privat’”, të ndryshuar. Kjo masë ligjore, e cila amendoi ligjin për koncesionet dhe PPP-në, ndër të tjera bëri të mundur heqjen e parashikimit ligjor në lidhje dhënien e pikëve bonus për propozimet e pakërkua, gjë e cila kërkohej edhe nga Komisioni Evropian në raportet e tij vjetore². Një parashikim tjetër i këtij projektligji është edhe shfuqizimi i sistemit të shpërblimit me pikë bonus të propozuesve të pakërkuar dhe zëvendësimi i tij me mekanizmin e kompensimit, i cili konsiston në kompensimin në vlerë

² European Commission. Albania 2020 Report: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf.

European Commission. Albania 2016 Report: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf.



monetare për shpenzimet e kryera për përgatitjen e studimit të fizibilitetit nga propozuesi i pakërkuar, në rast se ky i fundit nuk shpallet fitues. Në këtë projektligj është parashikuar edhe krijimi i një organi kolegjal, Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP, i cili do të përzgjedhë projektet e koncesionit/PPP, të cilat do të asistohen me ekspertizë të specializuar, për hartimin e studimeve të fizibilitetit dhe/ose oponencën e tyre, duke i dhënë kështu një mundësi autoriteteve kontraktore që të kërkojnë mbështetje për zhvillimin e projekteve me ekspertizë të specializuar.

Një tjetër arritje në këtë fushë ka qenë dhe miratimi i VKM-së nr. 280/2020, VKM-së nr. 285/2020 dhe VKM-së nr. 420/2020, të cilat kanë si qëllim të pasqyrojnë në mënyrë të qartë dhe të qëndrueshme, mënyrën e funksionimit të strukturës së komitetit të përzgjedhjes së projekteve të koncesionit/PPP, zgjerimin e rrethit të veprimtarisë së Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), si dhe rregullat për dhënien me koncesion/PPP.

Sa u takon prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, në prill të 2020-ës, për herë të parë në Shqipëri, është miratuar ligji 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, i cili, ndryshe nga praktikat e mëparshme, ka përcaktuar qartë objektin dhe qëllimin e kontratave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, parimet e prokurimit, përjashtimet e veçanta, mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe detyrimin për të publikuar njoftimin e kontratës për disa nga llojet e procedurave. Gjithashtu, në këtë projektligj është zgjeruar procedura e ankimit administrativ, duke u njohur të drejtën operatorëve ekonomikë, që në rast se janë dëmtuar apo rrezikohen të dëmtohen nga vendimmarrja e Autoritetit Kontraktor, përveç ankesës në AK të ankohen edhe në Komisionin e Prokurimit Publik. Në këtë pikë, ligji unifikon dhe plotëson bazën ligjore në këtë fushë, si dhe përafron më tej legjislacionin shqiptar me *acquis* të BE-së.

2.4 Mësimet

Nga konstatimet e kryera mbi sistemin e prokurimit publik gjatë viteve të fundit është vënë re se përdorimi i Marrëveshjeve Kuadër nga ana e autoriteteve kontraktore ka shërbyer si

mënyrë mjaft eficiente në uljen e përdorimit të procedurave me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, duke sjellë kështu dhe një përdorim më të mirë të fondeve publike. Për këtë arsye, APP-ja ka nxitur vazhdimisht autoritetet kontraktore që të përdorin MK-në sa më shumë që të jetë e mundur, duke publikuar rekomandime dhe organizuar sesione trajnimi.

Një tjetër mësim i nxjerrë gjatë këtyre viteve të fundit është rëndësia dhe ndikimi që ka pasur automatizimi i vazhdueshëm i sistemit të prokurimit publik. Kjo gjë është vënë re sidomos sa i takon planifikimit të procedurës së prokurimit publik, si dhe të procedurës me negocim pa shpallje paraprake, të cilat zhvillohen nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit që prej janarit të 2018-ës. Me përfshirjen e këtyre elementeve në sistemin elektronik është rritur përgjegjshmëria nga ana e autoriteteve kontraktore në kryerjen e procedurave të prokurimit publik, duke pasur parasysh se si procese janë lehtësisht më të monitorueshme.

Së fundmi, asistimi dhe nxjerra e rekomandimeve të vazhdueshme për autoritetet kontraktore është parë të ketë pasur efekt në rritjen e performancës dhe të eficiencës gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit publik, duke minimizuar kështu gabimet që mund të lindin nga paqartësitë që specialistët e prokurimit kanë në këtë aspekt.

3. Vizioni i Strategjisë

3.1 Vizioni

Vizioni i kësaj Strategjie është garantimi i një sistemi prokurimi eficient dhe efektiv në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës së lirë dhe të ndershme, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë, duke promovuar dhe nxitur një sistem të qëndrueshëm që garanton vlerën për para.

Aktualisht, tregu i prokurimit publik në Shqipëri zë në total 6.5% të PBB³, gjë që e kthen atë në një faktor të rëndësishëm për rritjen ekonomike të vendit. Për këtë arsye, përdorimi eficient i fondeve publike merr një rëndësi të veçantë, duke qenë se shërben për të garantuar ofrimin e shërbimeve të duhura për qytetarët.

Ngritja e një sistemi prokurimi publik efektiv kërkon përcaktimin e prioritetëve dhe të

³ Analiza vjetore e APP-së për vitin 2019.



objektivave jo vetëm në drejtim të përmirësimit të prokurimeve publike, në kuptimin klasik të tyre, por edhe të prokurimeve të zhvilluara në sektorë të caktuar, si p.sh.: transporti, energjia, shërbimet postare, uji etj.

Gjithashtu, një rëndësi shumë të madhe në këtë drejtim merr edhe përmirësimi i sistemit të koncesioneve dhe të partneritetit publik, si edhe ngritja dhe rregullimi i një sistemi të veçantë për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

Qëllimi i një prokurimi efektiv është që të sigurojë mallra dhe shërbime me çmime më të mira për cilësi më të mirë.

Në këtë kuptim, objektivat kryesorë, mbi të cilat duhet të mbështetet veprimtaria e institucioneve shqiptare për këtë qëllim, janë si më poshtë:

1. Rritja e transparencës;
2. Përmirësimi i planifikimit të prokurimit publik;
3. Përmirësimi i menaxhimit të kontratave;
4. Përmirësimi i kuadrit institucional përgjegjës për prokurimin publik;
5. Përmirësimi i sistemit të prokurimit të përqendruar;
6. Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional për shqyrtimin e ankesave;
7. Profesionalizimi i funksionit të prokurimit publik;
8. Përmirësimi i kuadrit ligjor;
9. Përmirësimi i sistemit elektronik të prokurimit;
10. Garantimi i procedurave të qëndrueshme të prokurimit publik në respektim të mirëqenies sociale, mbrojtjes së mjedisit etj.;
11. Përmirësimi i eficiencës në përdorimin e fondeve publike;
12. Rritja e pjesëmarrjes së SME-ve në procedurat e prokurimit publik.

Të gjithë objektivat e mësipërm, si edhe masat në zbatim të tyre vijnë në të njëjtën linjë me objektivat e përcaktuar në dokumentet e tjera strategjike të përmendura me herët, me qëllim garantimin e përputhshmërisë dhe harmonizimin me të gjitha dokumentet strategjike kombëtare.

3.2 Treguesit e impaktit dhe treguesit e rezultatit

3.2.1 Treguesit e impaktit

Zbatimi i masave dhe i aktiviteteve brenda kësaj Strategjie duhet të ketë ndikim në rritjen e

efikasitetit të sistemit kombëtar të prokurimit publik, por edhe në zhvillimin e përgjithshëm të tregut, si dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga institucionet publike.

Në këtë drejtim, treguesit kryesorë të impaktit përcaktohen si më poshtë:

1. Cilësi më e mirë e mallrave, punëve dhe shërbimeve të fituara

Masat e planifikuara legislative dhe zbatuese duhet të rezultojnë në rritjen e përdorimit të kriterëve më të mira për përcaktimin e ofertës fituese, bazuar mbi raportin çmim/cilësi në ofertën ekonomikisht më të favorshme në krahasim me kriterin e çmimit më të ulët. Kjo duhet të rezultojë në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të mallrave, punëve dhe shërbimeve të blera, duke pasur një ndikim indirekt në rritjen e cilësisë së shërbimit publik të ofruar nga autoritetet kontraktore.

Në këtë kuptim, ndikimi i zbatimit të Strategjisë do të vlerësohet bazuar në rritjen e numrit të kontratave të dhëna bazuar në raportin më të mirë çmim/cilësi.

2. Promovimi i pjesëmarrjes së SME-ve në procedurat e prokurimit publik

Megenëse prokurimi publik duhet të përshtatet me nevojat e SME-ve, një prej qëllimeve të shumë aktiviteteve brenda kësaj Strategjie është lehtësimi i pjesëmarrjes së SME-ve në prokurimin publik. Prandaj, pritet që impakti i Strategjisë të matet me përqindjen e kontratave të prokurimit publik të dhëna për SME-të në raport me numrin e përgjithshëm të kontratave.

3. Promovimi konkurrencës së tregut

Funksionimi i plotë i konkurrencës së tregut, si një nga qëllimet kryesore të sistemit të prokurimit publik, rrjedh nga elemente të ndryshme të proceseve të prokurimit që do të përmirësohen nga aktivitetet e parashikuara në këtë Strategji.

Lidhur me këtë, impakti i planifikuar i zbatimit të tij duhet të rezultojë në rritjen e konkurrencës në treg, e pasqyruar në rritjen e numrit mesatar të ofertave në procedurat e prokurimit.

4. Përmirësimi i planifikimit të prokurimeve

Duke qenë se prokurimi publik zë një përqindje të lartë të shpenzimeve buxhetore, përmirësimi i planifikimit të prokurimit publik ka



ndikim të drejtpërdrejtë në menaxhimin e financave publike, duke përfshirë efikasitetin e planifikimit buxhetor. Duke pasur parasysh këtë, impakti i Strategjisë duhet të rezultojë në përmirësimin e planifikimit buxhetor, në lidhje me mallrat, punët dhe shërbimet që do të merren nga autoritetet kontraktore.

Duke pasur parasysh që cilësia e ulët e planifikimit të prokurimit reflekton kryesisht në numrin e procedurave të anuluar, impakti i zbatimit të Strategjisë do të vlerësohet bazuar në uljen e numrit të procedurave të anuluar, për shkak se të gjitha e ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor.

5. Rritja e përfitimeve mjedisore dhe sociale të shërbimeve të ofruara nga organet publike

Autoritetet kontraktore, duke përdorur kompetencat e tyre në prokurim për të zgjedhur mallra, punë dhe shërbime me standarde më të larta mjedisore dhe sociale mund të japin një kontribut të rëndësishëm në konsumin dhe prodhimin e qëndrueshëm. Prokurime të tilla kanë impakt të drejtpërdrejtë mjedisor dhe social të shërbimeve të ofruara nga organet publike. Në përputhje me rrethanat, ndikimi i kësaj Strategjie do të vlerësohet duke matur rritjen e numrit të procedurave të prokurimit ku janë aplikuar elemente mjedisore ose sociale (specifikimet teknike, kriteret e dhënies së kontratës, kushtet e kontratës).

6. Rritja e eficiencës në dhënien e kontratës

Ndikimi kryesor i aktiviteteve të parashikuara në këtë Strategji është përdorimi eficient i fondeve publike nëpërmjet procedurave efikase të prokurimit.

Në mënyrë që të matet impakti i zbatimit të Strategjisë në atë drejtim, do të monitorohen trendet në uljen e numrit mesatar të procedurave të anuluar të prokurimit, për shkak të të përcaktimeve në kuadrin ligjor.

Vlerësimi i performancës në lidhje me të gjithë treguesit e impaktit do të bazohet në të dhënat e marra përmes Sistemit Elektronik të Prokurimit, të administruar nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Agjencia e Prokurimit Publik administron dhe përpunon të dhëna për të gjitha procedurat e prokurimit dhe kontratën e dhënë dhe i paraqet ato në raportet vjetore.

7. Përmirësimi i punëve dhe i shërbimeve publike afatgjata

Si kontrata afatgjata për punë dhe shërbime, kontratat e koncesionit dhe PPP-të janë element i rëndësishëm i cilësisë së shërbimeve të përgjithshme publike.

Shqyrtimi dhe miratimi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë i projekteve të propozuara nga autoritetet kontraktore është një mekanizëm që shërben për të garantuar vlerën në para të tyre, duke pasur një ndikim në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të punëve dhe shërbimeve publike afatgjata.

Ndikimi do të vlerësohet duke matur rritjen numrit të propozimeve për kontrata koncesioni dhe PPP të finalizuara vetëm pas miratimit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

8. Rritja e transparencës për kontratat e koncesionit dhe PPP

Aksesi i publikut në informacionin mbi koncesionet dhe PPP-të e dhëna mundëson kontrollin nga publiku mbi rregullsinë e zbatimit të tyre, duke ndikuar pozitivisht edhe në cilësi dhe rritjen e përgjegjshmërisë së autoriteteve kontraktore.

Prandaj, ndikimi i zbatimit të Strategjisë do të matet bazuar në rritjen e numrit të kontratave të koncesioneve dhe PPP-ve të publikuara në regjistër.

9. Standardizimi i shërbimeve të ofruara nga organet publike

Një nga ndikimet kryesore të prokurimit të përqendruar është standardizimi i proceseve të prokurimit, si dhe standardizimi i karakteristikave të artikujve të blerë. Si pasojë, përdorimi i mallrave dhe i shërbimeve të standardizuara, nga grupe organesh publike të nivelit të caktuar, siç janë organet qendrore shtetërore, duhet të rezultojë në shërbime më të standardizuara të ofruara nga ato organe. Ndikimi i duhur i zbatimit të strategjisë do të matet bazuar në rritjen e numrit të procedurave të prokurimit të realizuara me fitues nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

10. Rritja e eficiencës së sistemit të ankesave nëpërmjet rritjes së shpejtësisë në vendimarrje

Një sistem shqyrtimi i ankesave i cili është mirëfunksional, siguron një zbatim më të mirë legjislacionit të prokurimit publik, duke garantuar



që shkeljet e kryera nga autoritetet kontraktore të korrigjohen.

Një nga ndikimet kryesore të sistemit të shqyrtimit të ankesave është shpejtësia në marrjen e vendimeve nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik (KPP).

Prandaj, ndikimi do të vlerësohet duke matur numrin e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit të parashikuar në ligj mbi numrin e ankesave totale të depozituara pranë KPP në një vit.

3.2.2 Treguesit e rezultatit

Treguesit e rezultatit janë përcaktuar për secilin aktivitet dhe janë përfshirë në aneksin 1.

PJESA II QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË

Duke marrë në konsideratë fushat kryesore të ndërhyrjes, të cilat janë pjesë e prokurimit dokumenti është organizuar në pesë shtylla kryesore:

1. Prokurim publik eficient dhe i qëndrueshëm;
2. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për koncesionet dhe partneritetin publik-privat;
3. Riorganizimi i prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë;
4. Blerja e përqendruar;
5. Përmirësimi i sistemit të shqyrtimit të ankesave.

Secila shtyllë përbëhet nga një sërë komponentësh ku parashikohen objektivat specifike dhe masat përkatëse për secilin prej tyre.

Këto shtylla janë në harmoni të plotë me SKZHI 2015–2020 dhe, posaçërisht shtyllës 1: Rritja përmes stabilitetit makroekonomik dhe fiskal.⁴

Për secilin prej komponentëve jepet një përshkrim i shkurtër i situatës aktuale dhe arsyeve e gjetjeve kryesore, mbi bazën e të cilave është përcaktuar domosdoshmëria për të ndërhyrë me qëllim përmirësimin apo rregullimin e një aspekti të caktuar.

Për secilën masë janë listuar prioritetet dhe është përcaktuar periudha kohore për realizimin e plotë të saj, si edhe janë përcaktuar institucionet përgjegjëse dhe risqet që mund të ndikojnë në realizimin e saj.

Gjithashtu, për secilin komponent janë përcaktuar indikatorët përkatës të performancës, mënyra e matjes së tyre dhe janë përlogaritur kostot e nevojshme për realizimin e tyre.

Të gjitha masat, në rang shtyllash dhe përbërësish janë paraqitur në planin e veprimit në shtojcën 1.

Për përgatitjen dhe implementimin e duhur të Strategjisë nevojitet përfshirja e disa institucioneve, si: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ATRAKO, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, Komisioni i Prokurimit Publik etj., të cilat do të jenë përgjegjëse për implementimin e masave të lidhura me fushën e tyre të veprimit. Për këtë arsye, do të ngrihet një këshill drejtues me detyrë koordinimin dhe menaxhimin e Strategjisë.

Për më tepër, në varësi të objektivit, të tjera institucione qendrore dhe vendore, si dhe operatorët ekonomikë dhe organizatat e shoqërisë civile mund të përfshihen.

Një hap shumë i rëndësishëm për përgatitjen e Strategjisë ka qenë, gjithashtu, dhe konsultimi me Drejtorinë e Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes pranë Kryeministrit, me institucione qendrore dhe vendore, si dhe me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si: Zyra Vendore e Bankës Botërore, OSBE, Zyra e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, si dhe SIGMA në rolin e konsulentit teknik për këtë qëllim.

4. Qëllimi i politikës 1 – Prokurim publik eficient dhe i qëndrueshëm

Me qëllim garantimin e një sistemi prokurimi eficient dhe të qëndrueshëm është e nevojshme marrja e një sërë masave, sidomos sa u takon aspekteve të mëposhtme:

1. Përmirësimi i legjislacionit të prokurimit dhe përafrimi me *acquis* të BE-së;
2. Fuqizimi i rolit dhe i kapaciteteve të Agjencisë së Prokurimit Publik;
3. Organizimi dhe profesionalizimi i funksionit të prokurimit;
4. Rritja e eficiencës në prokurimin publik;

⁴ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020: <https://qbz.gov.al/share/GFu54aScSfCyykN99wZVCg>.



5. Zgjerimi i politikave dhe i metodave për prokurimin e qëndrueshëm;

6. Forcimi i integritetit në prokurimin publik;

7. Përmirësimi i sistemit elektronik të prokurimit.

4.1 Objektivi specifik 1 – Përmirësimi i legjislacionit të prokurimit dhe përafrimi me *acquis* të BE-së

- Analiza e situatës dhe sfidat e lidhura me objektivin specifik

Konteksti

Pavarësisht përmirësimit të vazhdueshëm, legjislacioni shqiptar i prokurimit ka nevojë të përmirësohet më tej.

Legjislacioni ekzistues ka nevojë të rishikohet në mënyrë që të harmonizohet me direktivat e reja të BE-së, veçanërisht me direktivën 2014/24/EU për prokurimet klasike dhe 2014/25/EU, për entet të cilat operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe të shërbimeve postare.

Në këtë kuadër është përgatitur një analizë e mangësive ligjore, e cila identifikon boshllëqet kryesore ndërmjet legjislacionit ekzistues dhe direktivave të mësipërme, si dhe jep rekomandime në lidhje me implementimin e dispozitave që mungojnë.

Nga kjo analizë është konstatuar se legjislacioni aktual në fushën e prokurimit publik është pjesërisht i përafruar me direktivat e 2014-ës dhe përfshin disa nga elementet e saj, si: objekti dhe qëllimi, parimet (mosdiskriminimi, trajtimi i barabartë dhe transparenca), si dhe shumica e procedurave, marrëveshjet kuadër, kontratat e dhëna nga organet qendrore blerëse dhe rregullat që lidhen me prokurimin elektronik, kriteret e kualifikimit dhe kriteret e skualifikimit, kriteret e përcaktimit të ofertës fituese dhe dispozitat për performancën së kontratës. Megjithatë, legjislacioni përmban boshllëqe, për sa u përket ankandëve elektronike dhe sistemeve dinamike të blerjes. Për më tepër, legjislacioni nuk ka dispozita në lidhje me disa procedura të prokurimit (procedura e dialogut konkurrues dhe partneritetit për inovacion), studimet paraprake të tregut, etiketat, prokurimin *in-house*, kontratat e rezervuara, kodet CPV, njoftimin paraprak dhe atë periodik të informacionit dhe njoftimin paraprak vullnetar të e transparencës, Dokumentin e Vetëm Evropian të Prokurimit

(ESPD), koston e ciklit jetësor, si dhe është e nevojshme të rishikohen dispozitat për performancën e kontratës, në mënyrë që të përafrohen me ato të direktivave.

Objektivi

Objektivi kryesor është miratimi i një ligji të ri për prokurimin publik, i cili të jetë sa më qartë dhe i kuptueshëm, duke u bazuar në parime, si: transparenca, mosdiskriminimi, trajtimi i barabartë, konkurrenca e lirë dhe vlera për para, i harmonizuar me direktivat përkatëse të BE-së, si dhe të garantojë një kuadër rregullues eficient për prokurimin e kontratave, të cilat nuk mbulohen plotësisht nga rregullat e detajuara të direktivave të BE-së.

- Treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet e pritshme

Objektivi i mësipërm është parashikuar të arrihet nëpërmjet një sërë masash të rëndësishme, si:

Masa 1.1.1: *Screening* horizontal i legjislacionit, me qëllim përcaktimin e shkallës së përafrimit me direktivat e BE-së dhe identifikimin e boshllëqeve kryesore për t'u adresuar.

Procesi *screennig* merr, gjithashtu, një rëndësi të veçantë duke pasur parasysh perspektivën e hapjes së negociatave për anëtarësim në BE.

Masa 1.1.2: Finalizimi i procesit të hartimit dhe miratimi i draftligjit të ri për prokurimin publik duke transpozuar direktivat 2014/24 dhe 2014/25.

Masa 1.1.3: Hartimi dhe miratimi i rregullave plotësuese dhe i legjislacionit dytësor për zbatimin e ligjit në mënyrën e duhur.

Screening i legjislacionit të prokurimit publik duhet të bazohet në gjetjet e analizës së mangësive ligjore (*legal gap analysis*), të përgatitur nga APP-ja, me qëllim identifikimin e çështjeve kryesore dhe dispozitave të detyrueshme për t'u transpozuar, nga direktivat.

Afati kohor

2020–2022

Institucionet përgjegjëse

Një grup ndërinstitucional pune i kryesuar nga APP-ja është ngritur tashmë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.



Treguesit e performancës

1. Analiza e legjislacionit e realizuar;
2. Tabela e përputhshmërisë;
3. Ligji i transpozuar i hartuar;
4. VKM-ja për miratimin e rregullave;
5. Miratimi i ligjit në Parlament;
6. Udhëzimet në zbatim të ligjit dhe VKM-së

të miratuara;

7. Dokumentet standarde të tenderit të rishikuara.

4.2 Objektivi specifik 2 – Fuqizimi i rolit dhe i kapaciteteve të Agjencisë së Prokurimit Publik

- Analiza e situatës dhe sfidat e lidhura me objektivin specifik

Konteksti

Agjencia e Prokurimit Publik është institucion qendror në varësi të Kryeministrit dhe që ushtron funksionet e saj në bazë të ligjit për prokurimin publik. Aktualisht, ky ligj parashikon një sërë kompetencash ndër të cilat edhe propozimin e rregullave të prokurimit, verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, shqyrtimin e rekomandimet e organeve audituese për procedurat e prokurimit, monitorimin e mbarëvajtjes së sistemit të prokurimit publik, nëpërmjet informacioneve të marra nga raportet periodike të autoriteteve kontraktore, përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, si dhe trajnimin e punonjësve të përfshirë në procedurat e prokurimit.

Gjatë vitit 2018, struktura e APP-së është përmirësuar, duke përfshirë funksione të reja, si përpunimi i raporteve për monitorimin e kontratave dhe koordinimi, dhe duke siguruar shtrirjen e veprimtarisë së APP-së në të gjitha fazat e prokurimit nga planifikimi deri në zbatimin e kontratës. Gjithashtu, edhe numri i punonjësve është rritur në 44 punonjës nga 29 që ishte më 2017-ën.

Gjithsesi, pavarësisht këtyre zhvillimeve, është e nevojshme që t'i jepet një rëndësi e veçantë fuqizimit të rolit të APP-së si institucion politikëbërës, si edhe rritjes së kapaciteteve të stafit të APP-së.

Objektivi

Objektivi është fuqizimi i rolit të APP-së si institucion politikëbërës nëpërmjet parashikimit të qartë të kompetencave në dispozitat ligjore, si edhe ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve të punonjësve të APP-së.

- Treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet e pritshme

Objektivi i mësipërm është parashikuar të arrihet nëpërmjet një sërë masash të rëndësishme, si:

Masa 1.2.1: Rritja e kompetencave të APP-së në të gjitha fazat e procesit në vijim të miratimit të ligjit të ri të prokurimit publik.

Masa 1.2.2: Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve të APP-së sipas fushave.

Afati kohor

2020–2022

Institucione përgjegjëse

APP

Treguesit e performancës:

1. Përcaktimi i saktë i kompetencave në nenet e ligjit të ri të PP-së;
2. Plani i trajnimit i hartuar;
3. Trajnimi i 40 punonjësve të APP-së sipas fushave;
4. Vizita studimore/trajtime në vendet e tjera.

4.3 Objektivi specifik 3 – Organizimi dhe profesionalizimi i funksionit të prokurimit

- Analiza e situatës dhe sfidat e lidhura me objektivin specifik

Konteksti

Rritja e kapaciteteve brenda autoriteteve kontraktore është një nga shqetësimet kryesore për sistemin e prokurimit publik në Shqipëri, duke qenë se kjo gjë është shumë e rëndësishme për garantimin e qëndrueshmërisë së stafit, transparencës, eficiencës dhe vlerës për para, gjatë procesit të prokurimit.

Për më tepër, mungesa e një sistemi të zhvilluar institucional për edukimin dhe trajnimin në prokurimin publik është qartësisht një pengesë madhore⁵. Në këtë kuptim, si problematikë është identifikuar, gjithashtu, edhe mospërcaktimi i specialistit të prokurimit si një profesion i mirëfilltë, si dhe mungesa e një

⁵ Raporti monitorues i SIGMA-s për parimet e administratës publike, i vitit 2017.



Strategjie të detajuar për profesionalizimin dhe trajnimin e tyre.

Një trajnim i përshtatshëm do të ndihmonte specialistët e prokurimeve për të projektuar një proces prokurimesh sa më pak të prekshëm edhe nga sjelljet antikonkurruese të operatorëve të tregut (marrëveshjet në oferta). Njohja me praktikant antikonkurruese do të ndihmonte stafin e prokurimeve që të zbulojë shpejt problemet, si dhe t'i rregullojë ato.

Ngritja e një rrjeti profesionistësh të prokurimit kërkon, nga ana tjetër, një bashkëpunim shumë të ngushtë ndërmjet institucioneve përgjegjëse për miratimin e përshkrimeve të punës dhe trajnimin e vazhdueshëm të personave të punësuar si specialistë prokurimi.

Një nga problematikat e identifikuar, gjithashtu, në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Komisionit Evropian në raportet e tij vjetore, është nevoja për rritjen e kapaciteteve brenda organeve të auditimit dhe shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimit publik, përfshirë gjykatat, veçanërisht për sa i përket interpretimit të dispozitave ligjore.

Megjithatë duhet theksuar se si hap i parë për rritjen e kapaciteteve për autoritetet kontraktore është hedhur nëpërmjet masave ligjore të cilat u miratuan me VKM-në nr. 305, datë 5.4.2017, me anë të së cilit janë bërë përpjekjet për unifikimin e përshkrimeve përgjithësuese të punës e të kriterëve specifikë për pozicionet “specialist prokurimi” në institucionet pjesë e fushës së veprimit të legjislacionit për nëpunësin civil. Gjithashtu, me anë të VKM-së nr. 139, datë 20.3.2019, është miratuar baza ligjore për krijimin e rrjeteve profesionale ndërinstitutionale të nëpunësve në fusha të caktuara, midis tyre sigurisht edhe në fushën e prokurimit.

Së fundmi, masa më e vonshme e ndërmarrë në kuadrin e rritjes së kapaciteteve për autoritetet kontraktore është miratimi i VKM-së nr. 797, datë 29.12.2017, me anë të së cilës është përcaktuar se autoriteti kontraktor në fillim të vitit do të caktojë një person/personat përgjegjës për prokurimin, i cili do të jetë pjesë e njësisë së prokurimit, si dhe do të administrojë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit.

Objektivi

Objektivi kryesor i këtij komponenti është ngritja e një sistemi profesionalizimi për prokurimin publik nëpërmjet ngritjes së një rrjeti të profesionistëve/specialistëve të prokurimit.

- Treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet e pritshme

Masat kryesore për arritjen e këtij objektivi janë:

Masa 1.3.1: Hartimi i një udhërrëfyese për profesionalizimin e funksionit të prokurimit ku të parashikohen hapat e nevojshëm për finalizimin e procesit.

Masa 1.3.2: Përgatitja e një kurrikule të re trajnimi për nëpunësit e përfshirë në procedurat e prokurimit dhe një plan trajnimi.:

- hartimi i një programi trajnimi certifikues dhe të posaçëm për trajnimin e trajnuesve për prokurimin publik;

- hartimi i një kurrikule për trajnerët;

- hartimi i një kurrikule trajnimi për prokurimin publik – pilotimi i kurrikulës.

Masa 1.3.3: Rishikimi i kriterëve specifikë që duhen plotësuar për punonjës prokurimi dhe rishikimi i përshkrimeve të punës për këto pozicione në institucionet pjesë e fushës së veprimit të legjislacionit për nëpunësin civil, në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe me këtë Strategji, si dhe hartimi dhe miratimi i tyre për të njëjtat pozicione në institucionet e tjera.

Masa 1.3.4: Ngritja dhe funksionimi i plotë i rrjetit të profesionistëve të prokurimit.

Profesionalizimi i funksionit të prokurimit do të mundësonte ngritjen e një rrjeti për ekspertët e prokurimit publik, të cilët do të mund të punësohen në çdo kohë nga autoritetet kontraktore në përputhje me parimet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin specifik që rregullon marrëdhënien e tyre të punësimit dhe, gjithashtu, do të kontribuonte në përmirësimin e performancës së sistemit të prokurimit në tërësi. Për këtë arsye, duhet të përgatitet një plan shumëvjeçar profesionalizimi, ku të përcaktohen të gjithë hapat e nevojshme për profesionalizimin.

Afati kohor

2020–2023

Institucione përgjegjëse

Procesi i profesionalizimit, përveç APP-së si institucioni përgjegjës për trajnimin në fushën e



prokurimit, kërkon, gjithashtu, përfshirjen e një sërë institucioneve të tjera përgjegjëse për administratën publike, burimet njerëzore dhe trajnimin, si: Departamenti i Administratës Publike dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Për më tepër, kërkohet dhe përfshirja dhe bashkëpunimi me të gjitha autoritetet kontraktore.

Treguesit e performancës

1. *Gap analysis*;

2. Udhërrëfyeni për profesionalizimin e funksionit të prokurimit i hartuar;

3. Një kurrikul trajnimi e re për trajnerë;

4. Kurrikul trajnimi bazë dhe e avancuar;

5. Kriteret specifike që duhen plotësuar për të qenë punonjës prokurimi të përcaktuara;

6. Përshkrimet e punës të hartuara;

7. Rrjeti i profesionistëve të prokurimit i ngritur.

4.4 Objektivi specifik 4 – Rritja e eficiencës në prokurimin publik

- Analiza e situatës dhe sfida e lidhura me objektivin specifik

Konteksti

Që një sistem prokurimi publik të jetë eficient, është e nevojshme që të ketë: i. planifikim sa më të mirë; ii. vlerësim të drejtë të ofertave të paraqitura; iii. një mjedis me konkurrencë të lirë dhe të ndershme; si dhe iv. një menaxhimi të mirë të kontratave. Megjithatë, këto elemente kyçe kanë nevojë për përmirësime, me qëllim që të garantohet një menaxhim sa më i mirë i fondeve publike dhe vlera më e mirë për para.

Planifikimi i prokurimit është një nga fazat më të rëndësishme të procesit të prokurimit. Një planifikim i mirë, i saktë dhe në kohë çon drejt një prokurimi të suksesshëm dhe eficient. Duke marrë në konsideratë që planifikimi është identifikuar si një nga aspektet më problematike të prokurimit në Shqipëri, është e nevojshme që t'i kushtohet një vëmendje e veçantë përmirësimit të këtij procesi, veçanërisht planifikimit të investimeve. Në këtë kuptim, planifikimi i prokurimit duhet të integrohet dhe të jetë vazhdimisht në përputhje me procesin e planifikimit strategjik të autoriteteve kontraktore në tërësi.

Sa i takon procesit të vlerësimit janë identifikuar problematika, si: i. numri i lartë

dokumenteve të kërkuara, të cilat çojnë në refuzimin e ofertave të mira për mangësi të vogla; ii. interpretim i ngurtë i dispozitave ligjore nga ana e AK-së gjatë fazës së vlerësimit; iii. hezitimi i AK-së gjatë vlerësimit të ofertave anomalisht të ulëta; iv. hezitimi i AK-së për të marrë në konsideratë deviacione të vogla të cilat ndikojnë negativisht në vlerën për para; v. qëndrim i ndryshëm i AK-së për operatorë ekonomikë të ndryshëm; vi. OE që kualifikohen edhe kur mungojnë dokumente të tenderit; vii. vlerësim i gabuar në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Parashikimi i formularit të vetëdeklarimit, duke eliminuar kështu nevojën për dorëzimin e disa dokumenteve që lëshohen nga institucione të tjera shtetërore është një hap shumë i rëndësishëm në këtë drejtim. Gjithsesi, mbeten ende disa probleme, të cilat kanë nevojë që të adresohen.

Ndërkohë, tregu i prokurimit publik ka nevojë që të bëhet më atraktiv për sektorin privat, gjë e cila reflektohet zakonisht nga interesi për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit dhe për të bërë biznes me sektorin publik. Konkurrenca e drejtë dhe efektive është një objektivi kyç për rritjen e eficiencës dhe të vlerës për para në dhënie të shërbimeve publike. Gjithashtu, një aspekt shumë i rëndësishëm që duhet konsideruar është edhe përbërja e tregut, sidomos raporti ndërmjet bizneseve të mëdha dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (SME) dhe mundësitë e këtyre të fundit për të konkurruar dhe për të përfituar një pjesë të kontratave publike. Të gjitha këto masa janë të rëndësishme për rritjen e konkurrencës dhe luftimin e marrëveshjeve në oferta (*Bid Rigging*).

Së fundmi, implementimi i kontratës, si faza përmbyllëse e procesit të prokurimit, është shumë e rëndësishme për sa i përket garantimit të përmbushjes së nevojave të autoriteteve kontraktore sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Momentalisht, sikundër është vërejtur, gjithashtu, dhe raportet e ndryshme të vlerësimit, menaxhimi i kontratës mbetet një hallkë e dobët e procesit të prokurimit, e cila karakterizohet nga kostot shtesë dhe vonesat në zbatim. Legjislacioni aktual i prokurimit përfshin vetëm disa aspekte lidhur me performancën e kontratave, sikurse janë dispozitat që detyrojnë autoritetet kontraktore për parashikimin e



kritereve në përputhje me qëllimin e kontratës, dispozitat për monitorimin e kontratës. Nga ana tjetër, nuk janë të pranishme dispozita që përcaktojnë rolin e autoriteteve kontraktore gjatë performancës së kontratës, pavarësisht se një pjesë e këtyre veprimtarive janë të parashikuara në legjislacione të tjera vendëse.

Objekti

Objekti kryesor për këtë komponent është garantimi i një prokurimi eficient.

- Treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet e pritshme

Masat kryesore për arritjen e këtij objekti janë:

Masa 1.4.1: Përcaktimi i rregullave për planifikimin e prokurimit të ndërlidhur me procesin e planifikimit buxhetor afatmesëm (PBA).

Planifikimi i prokurimit është i lidhur ngushtë me përgatitjen e buxhetit, duke sjellë kështu nevojën për koordinimin e dy proceseve. Ky koordinim do të ndihmojë autoritetet kontraktore që të planifikojnë më mirë procedurat e prokurimit dhe njëkohësisht të garantojë disponueshmërinë e fondeve në periudhën e zhvillimit të tyre.

Për këtë arsye është, gjithashtu, e nevojshme që të bëhet lidhja ndërmjet sistemit të prokurimit dhe bazës së të dhënave të thesarit/buxhetit, sikundër parashikohet edhe në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike.

Masa 1.4.2: Parashikimi për përdorimin e detyrueshëm të kodeve CPV nga ana e autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë.

Miratimi i kodeve CPV dhe detyrimi për përdorimin e tyre gjatë përgatitjes së regjistrit të parashikimit do të kontribuonte në unifikimin dhe standardizimin e regjistrave dhe, gjithashtu, do të kursente kohë për autoritetet kontraktore në identifikimin e objekteve të prokurimit.

Masa 1.4.3: Nxitja e përdorimit të njoftimit paraprak/periodik për procedurat e prokurimit

Masa 1.4.4: Miratimi i dokumenteve udhëzuese, në lidhje me implementimin e duhur të dispozitave ligjore për vlerësimin e ofertave dhe rishikimi i Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe hartimi i dokumenteve të reja të përmirësuara.

Masa 1.4.5: Analizimi i funksionimit të tregut publik, duke u bazuar njëkohësisht edhe në këndvështrimin e blerësve – autoriteteve

kontraktore edhe në atë të operatorëve ekonomikë.

Masa 1.4.6: Ngritja e një forumi për konsultim dhe dialog me sektorin privat.

Masa 1.4.7: Hartimi i dokumenteve udhëzuese për përmirësimin e funksionalitetit dhe atraktivitetit të tregut të sektorit publik për SME-në.

Masa 1.4.8: Përmirësimi i monitorimit të zbatimit të kontratës nëpërmjet ngritjes së një mekanizmi për menaxhimin e kontratës.

Afati kohor

2020–2023

Institucionet përgjegjëse

APP, MFE, Thesari, AK, MFE, Thesari, AKSHI, MFE, Thesari, AKSHI.

Institucione bashkëpunuese

Autoriteti i konkurrencës

Treguesit e performancës:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e kodeve CPV;

2. Njoftimi paraprak/periodik i parashikuar në ligj dhe akte nënligjore;

3. Dokument udhëzuese për lidhjen e sistemit të prokurimit elektronik me AGFIS (Sistemi i Informimit Financiar të Qeverisë Shqiptare);

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e kodeve CPV;

5. Njoftimi paraprak/periodik i parashikuar në ligj dhe akte nënligjore.

6. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit i përfshirë në dokumentet standarde të tenderit;

7. Udhëzimet/rekomandimet e APP-së (mesatarisht 2 udhëzime/rekomandime në vit);

8. Raporti i analizës së funksionimit të tregut të prokurimit publik i hartuar çdo vit;

9. Dokumentet udhëzuese për sektorin privat, në lidhje me të bërit biznes me sektorin publik të hartuara;

10. Plani i zbatimit të kontratës;

11. Formulari i raportimit të ecurisë së kontratës;

12. Udhëzues për menaxhimin e kontratës;

13. 5 punonjës të APP-së dhe 100 punonjës të AK-së, të trajnuar për menaxhimin e kontratës.

4.5 Objekti i specifik 5 – Zgjerimi i politikave dhe i metodave për prokurimin e qëndrueshëm



- Analiza e situatës dhe sfidat e lidhura me objektivin specifik

Konteksti

Sipas legjislacionit të BE-së, prokurimi i qëndrueshëm është një koncept shumë i gjerë dhe përfshin një sërë fushash ku prokurimi publik mund të luajë një rol të rëndësishëm në realizimin e qëllimeve të politikave të ndryshme sociale dhe mjedisore me natyrë horizontale. Gjithsesi, këto politika jo domosdoshmërisht lidhen me mallrat, punët apo shërbimet që prokurohen dhe për këtë arsye përfshirja e kriterëve që lidhen me to në procedurat e prokurimit është e limituar.

Në fakt, parashikimi i kriterëve të qëndrueshëm në prokurim nuk ka qenë historikisht një çështje prioritare. Direktivat e reja të prokurimit publik jo vetëm që ofrojnë mundësi më të mira për të përfshirë të ashtuquajturat politika horizontale në prokurim, por edhe i bëjnë ato të detyrueshme për t'u zbatuar në rrethana të caktuara.

Në këtë kuptim, Prokurimi Publik mund të përdoret, për shembull, për të promovuar inovacionin, për të mbështetur dhe për të zhvilluar sipërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME), si dhe për të mbështetur një sërë politikash me natyrë joekonomike. Këto mund të përfshijnë promovimin e mundësive të barabarta për të dizavantazhuarit për arsye gjinore ose etnike; promovimin e standardeve të punës; promovimin e mundësive për punësim për personat të cilët janë të papunë prej një kohe të gjatë ose mbështetjen për njerëzit me aftësi të kufizuara. Më së shumti, prokurimi publik është përdorur për të mbështetur objektivat mjedisore, si p.sh., adresimi i ndryshimeve klimatike ose ruajtja e biodiversitetit. Politikat mjedisore mund të jenë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, si p.sh., efienca e energjisë.

Politikat horizontale mund të aplikohen në të gjitha fazat e procesit të prokurimit:

1. Kriteret e kontratës, p.sh., specifikimet teknike;
2. Përzgjedhja dhe kualifikimi i ofertuesve;
3. Rezervimet, p.sh., rezervimi i kontratave për një grup të caktuar ofertuesish;

4. Dhënia e kontratës, p.sh., kostimi i ciklit jetësor për sa kohë është i lidhur me objektin e kontratës.

Si pjesë e harmonizimit të kuadrit tonë ligjor dhe institucional me legjislacionin e BE-së është e nevojshme që qëllimet e prokurimit publik të zgjerohen përtej fokusit tradicional, për sa i përket dhënies së kontratave bazuar vetëm mbi çmimin dhe kur përmbushen vetëm kriteret e përgjithshme (kriteret teknike në lidhje me objektin). Prokurimi publik duhet të përdoret si një instrument për të mbështetur zhvillimin ekonomik, modernizimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të punësimit, duke përdorur burimet dhe investimet tona të përbashkëta në mënyrë sa më eficiente dhe të qëndrueshme për vitet në vijim.

Objekti

Zgjerimi i përdorimit të objektiveve të qëndrueshme në sistemin e prokurimit.

- Treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet e pritshme

Masat kryesore për arritjen e këtij objekti janë:

Masa 1.5.1: Parashikimi i procedurave më të thjeshtuara të prokurimit që garantojnë mbrojtjen e mjedisit:

- hartimi i legjislacionit dytësor dhe parashikimi i kriterëve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit;
- trajnim i stafit të APP-së dhe AK-së për përdorimin e kriterëve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit në procedurat e prokurimit.

Masa 1.5.2: Ngritja e kapaciteteve dhe përgatitja për prokurimin e shërbimeve sociale:

- VKM për prokurimin e shërbimeve sociale;
- trajnim i stafit të APP-së dhe AK-së për prokurimin e shërbimeve sociale.

Afati kohor

2020–2022

Institucionet përgjegjëse

APP-ja, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Treguesit e performancës

1. Legjislacioni dytësor i hartuar;
2. VKM për prokurimin e shërbimeve sociale e miratuar;



3. 40 punonjës të APP-së dhe 100 punonjës të AK-së të trajnuar.

4.6 Objektivi Specifik 6 – Forcimi i integritetit në prokurimin publik

- Analiza e situatës dhe sfidat e lidhura me objektivin specifik

Konteksti

Korrupsioni përbën një nga faktorët kryesorë të riskut për prokurimin publik, i cili, përveç pasojave të tij demoralizuese, shkakton gjithashtu kosto shtesë, moseficiencë dhe shtrembërim të konkurrencës. Një sistem i shëndoshë i prokurimit publik, sikundër parashikohet në akte ligjore dhe nënligjore, bazohet mbi rregulla, nxit konkurrencën, promovon transparencën, forcon përgjegjshmërinë, është ekonomik dhe eficient. Çdo kompromis mbi integritetin do të rezultojë në kosto shtesë dhe efekte të tjera negative mbi funksionalitetin e sistemit të prokurimit. Sjellje pa integritet në prokurimin publik konsiderohen: marrëveshjet e fshehta ndërmjet ofertuesve, ryshfetet dhe konfliktin e interesit, si dhe vepra të tjera të jashtëligjshme. Parandalimi i korrupsionit synon të shmangë gjithashtu edhe situatat që çojnë në marrëveshje të ndaluara në oferta (*Bid Rigging*) në prokurimet publike. Lufta ndaj korrupsionit është një nga prioritetet kryesore të sistemit tonë politik duke përfshirë të gjitha fushat e shoqërisë.

Aktualisht, parimet e integritetit në sistemin e prokurimit publik në vend paraqiten brenda kuadrit të formularit të vetëdeklarimit mbi konfliktin të interesave që duhet të nënshkruajnë personat përgjegjës për procesin e prokurimit në AK. Ky formular duhet të nënshkruhet në mënyrë që të parandalohet çdo konflikt interesi ndërmjet zyrtarëve të prokurimit që janë të vendosur në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave dhe operatorit ekonomik. Një gjë e tillë parashikohet në nenin 26 të LPP-së dhe në udhëzimin e APP-së nr. 3, datë 24.10.2016, “Mbi deklaratën e konfliktit të interesit nga zyrtarët e prokurimit”, ku jepet dhe formulari i vetëdeklarimit.

Megjithatë, indeksi i perceptimit për korrupsionin i publikuar nga *Transparency International* për 2019 tregon se Shqipëria renditet në vendin e 106-të nga 180, por që ka shënuar 35 pikë nga 100, ku 0 konsiderohet si shumë i korruptuar dhe 100 si shumë i pastër.

Rrjedhimisht, lind nevoja e madhe edhe për të adresuar specifikisht risqet e integritetit në Strategjinë e Prokurimit Publik dhe për të hartuar një plan veprimi koherent dhe sistematik me qëllim zvogëlimin e tyre.

Çështjet e integritetit janë, gjithashtu, pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, në kuadër të së cilës është parë e nevojshme hartimi i një manuali dhe i planeve për integritetin institucional.

Objektivi

Lufta kundër korrupsionit dhe sjelljeve të tjera të paligjshme në fushën e prokurimit publik do të jenë pjesë integrale e Strategjisë për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik. Sistemet rregullatore dhe institucionale për realizimin e të gjithë objektivave politikë të rëndësishëm duhet të organizohen duke garantuar njëkohësisht vlerën për para dhe integritetin në dhënien e shërbimeve publike.

Objektivi kryesor i këtij komponenti mbetet ulja e praktikave korruptive dhe përmirësimi i perceptimit publik ndaj praktikave korruptive në fushën e prokurimit nëpërmjet indikatorëve të paracaktuar.

- Treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet e pritshme

Masat kryesore për arritjen e këtij objektivi janë:

Masa 1.6.1: Hartimi dhe zbatimi i një politike për integritetin dhe përgjegjshmërinë brenda autoriteteve kontraktore në përputhje me LPP-në.

Masa 1.6.2: Ngritja e kapaciteteve dhe rritja e ndërgjegjësimit për integritetin në fushën e prokurimit publik.

Afatet kohore

2021–2023

Institucionet përgjegjëse

APP

Institucione bashkëpunuese

Ministria e Drejtësisë, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoriteti i Konkurrencës.

Treguesit e performancës

1. Përfshirja e risqeve dhe e masave të lidhura me prokurimin publik në Manualin e Integritetit dhe në planet e integritetit si pjesë e Strategjisë kundër Korrupsionit.



2. Dokument i përbashkët APP – ILDKPKI-ja për integritetin e punonjësve në prokurimin publik;

3. Dokument i përbashkët APP-autoritete konkurrence për integritetin e operatorëve ekonomikë në prokurimin publik.

4. Manual mbi parandalimin e konfliktit të interesave në prokurimet publike;

5. 40 punonjës të APP-së dhe 100 punonjës të AK-së të trajnuar për integritetin;

6. Fushata ndërgjegjësimi mbi integritetin të zhvilluara.

4.7 Objektivi specifik 7 – Përmirësimi i sistemit elektronik të prokurimit

- Analiza e situatës dhe sfidat e lidhura me objektivin specifik

Konteksti

Sistemi elektronik i prokurimit është funksional në Shqipëri që në vitin 2009. Në vitin 2017, SPE-ja ka pësuar përmirësime madhore, duke përfshirë funksionalitete dhe module të rëndësishme jo vetëm për të përmirësuar performancën e sistemit elektronik, por edhe performancën e sistemit të prokurimit në tërësi.

Gjithsesi është e nevojshme që sistemi elektronik të përmirësohet më tej, me qëllim që Sistemi Dinamik i Blerjes të bëhet plotësisht funksional, si edhe të përfshihet një modul i ri për sa i përket implementimit të kontratës, si faza e fundit e procesit të prokurimit.

Objektivi

Rritja e performancës të sistemit elektronik të prokurimit.

Funksionimi i duhur i sistemit elektronik është thelbësor për të garantuar performancën dhe eficiencën e prokurimit publik në Shqipëri. Për këtë, është e nevojshme që të ndërmerren masa të mëtijshme me qëllim rritjen e akcesit dhe bërjen më të përdorshëm të tij.

Për këtë arsye, përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit është shumë i rëndësishëm, me qëllim, jo vetëm përmirësimin e funksionimit të sistemit elektronik, por edhe garantimin e transparencës dhe të përputhshmërisë me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet e pritshme

Masat kryesore për arritjen e këtij objektivi janë:

Masa 1.7.1: Përdorimi i detyrueshëm i kodeve CPV në sistemin elektronik, jo vetëm për autoritetet kontraktore, por edhe për operatorët ekonomikë, ofertuesit.

Masa 1.7.2: Ndërlidhja e sistemit elektronik të prokurimit me sistemin elektronik të thesarit.

Masa 1.7.3: Përfshirja e një moduli për menaxhimin e kontratës.

Masa 1.7.4: Bërja plotësisht funksional i sistemit dinamik të blerjes.

Masa 1.7.5: Lidhja e sistemit elektronik të prokurimit me sisteme të tjera për procesin e kualifikimit të OE-së, si: sistemi i taksave, sigurimeve shoqërore, databaza e licencave etj.

Afati kohor

2020–2023

Institucionet përgjegjëse

APP, AKSHI, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

Treguesit e performancës

1. VKM për miratimin e kodeve;

2. Manuali teknik për përdorimin e kodeve;

3. Trajnimi për funksionalitetet e reja të Sistemit Elektronik të Prokurimit);

4. *e-Manual* (video orientuese për përdorimin e kodeve) dhe moduli i ndërveprimit në sistemin AGFIS për verifikimin e fondeve në momentin e fillimit të procedurave të PP-së (Strategjia e PFM-së);

5. Moduli i shkëmbimit të të dhënave të kontratave të fituara nga sistemi i APP-së në sistemin AGFMIS;

6. Manuali teknik i brendshëm i përdorimit dhe i përgjegjëse;

7. Manuali shpjegues për autoritetet kontraktore i shoqëruar me *e-Instruction* (video shpjeguese);

8. Analiza funksionale për menaxhimin e kontratës;

9. Moduli për menaxhimin e kontratës;

10. Analiza funksionale për sistemin dinamik të blerjes;

11. Moduli i sistemit dinamik të blerjes;

12. Analiza funksionale për ndërlidhjen e SPE-së me sistemet e tjera.

5. Qëllimi i politikës 2 – Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për koncesionet dhe partneritetin publik-privat

Legjislacioni aktual, kryesisht, ligji nr. 125/2013, “Për koncesionet/PPP”, në përgjithësi, përmban

disa elemente thelbësore të direktivës 2014/23/EU, si: parimet e mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë dhe transparencës, kriteret e vlerësimit, procedurat dhe rregullat në lidhje me prokurimin elektronik sikurse janë komunikimi elektronik, njoftimet e kontratave dhe njoftimet e fituesit. Sidoqoftë, siç është treguar nga raportet vjetore të KE-së, legjislacioni në këtë fushë ka nevojë për mirësime të mëtejshme, në mënyrë që të arrihet përafrimi me direktivën përkatëse. Nga ana tjetër, për një zbatim më të mirë të legjislacionit është e nevojshme edhe një ndërhyrje në kuadrin institucional të tij.

5.1 Objektivi Specifik 1 – Përmirësimi i kuadrit rregullator në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve

- Analiza e situatës dhe sfidat e lidhura me objektivin specifik

Konteksti

Ligji nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetet publike private”, i ndryshuar, ka pësuar ndryshime të rëndësishme gjatë vitit të kaluar në vijim të rekomandimeve të përcjella nga Komisioni Evropian në raportet e saja të përvitshme, duke e sjellë kështu legjislacionin shqiptar në fushën e koncesioneve më në përputhje me atë të BE-së. Megjithatë, në kuadër të procesit *Screening*, si dhe të negociatave të anëtarësimit, është e nevojshme që të kryhet një analizë e legjislacionit aktual për të identifikuar boshllëqet ligjore dhe për të përcaktuar pikat e ndërhyrjet që do të ndërmerren.

Synimi i kësaj reforme është të përmirësojë kuadrin ligjor, mënyrën e zbatimit të procedurave për dhënien e koncesioneve/PPP, të rrisë kontrollin mbi angazhimet fiskale të marra përsipër nga autoritetet kontraktore nëpërmjet kontratave të koncesionit/PPP, me qëllim minimizimin e impaktit fiskal në buxhetin e shtetit.

Në këtë nismë janë marrë në konsideratë edhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, të cilat kanë raportuar dhe monitoruar legjislacionin dhe procedurat e dhënies së koncesioneve/PPP në vendin tonë⁶.

Deri më tani kemi bërë kufizimin e së drejtës së identifikimit dhe të zhvillimit të propozimeve të

pakërkua vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror dhe nuk do të jetë më e mundur të propozohen nga sektori privat projekte koncesioni/PPP, në formën e propozimit të pakërkuar për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale me rëndësi të veçantë.

Se dyti një pikë tjetër shumë e rëndësishme është heqja e bonusit për propozimet e pakërkua. Me qëllim rritjen e transparencës dhe trajtimit të barabartë për të gjithë operatorët në procedurën konkurruese është hequr mekanizmi i shpërblimit me pikë bonus, të operatorëve të cilët paraqesin propozim të pakërkuar. Për të nxitur sektorin privat për të propozuar projekte të studiuara, duke përdorur kapacitetet dhe eksperiencën e tyre, është propozuar zëvendësimi i sistemit me pikë bonus me atë të kompensimit në vlerë monetare të propozuesit të pakërkuar.

Mekanizmi i propozuar i kompensimit nuk cenon konkurrencën dhe nuk avantazhon propozuesin e pakërkuar.

Aktualisht është qartësuar roli dhe përgjegjësia e ministrisë përgjegjëse për financat, në lidhje me vlerësimin, miratimin e të gjithë projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat dhe ecurinë e kontratave të koncesionit/PPP nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Me qëllim rritjen e cilësisë së studimeve të fizibilitetit mbi projektet e koncesionit/PPP, me anë të ndryshimeve ligjore nëpërmjet ligjit 50/2019, dhe konkretisht nenit 12/1 të tij, është krijuar Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP, i cili do të jetë një organ kolegjal me objekt kryesor të veprimtarisë përzgjedhjen e projekteve të koncesionit/PPP, të cilat do të asistohen me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimeve fizibilitetit dhe/ose opoenencën e tyre.

Ne vijim është parashikuar në kuadër të procesit *Screening* si dhe të negociatave të anëtarësimit, është e nevojshme që të kryhet një analizë e legjislacionit aktual për të identifikuar boshllëqet ligjore dhe për

⁶ *Western Balkans Investment Framework. PPP Procurement Handbook Public-Private Partnerships in the Western Balkans: <https://www.wbif.eu/storage/app/media/Library/8.%20Public%20Private%20Partnership/4.%204-PPP-Procurement-Handbook-FINAL-310818.pdf>*



të përcaktuar pikat e ndërhyrjet që do të ndërmerren.

Objektivi

Përmirësimi i kuadrit ligjor për koncesionet dhe PPP.

- Treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet e pritshme

Masat kryesore për arritjen e këtij objektivi janë:

Masa 2.1.1: *Screening* i legjislacionit të koncesioneve/PPP, me qëllim arritjen e nivelit të përputhshmërisë me direktivën 2014/23 të BE-së dhe identifikimin e fushave të ndërhyrjes.

Afati kohor

2021–2022

Institucionet përgjegjëse

ATRAKO, APP, MFE

Treguesit e performancës

1. Analiza e mangësive ligjore;

2. Tabela e përputhshmërisë.

5.2 Objektivi specifik 2 – Kuadri institucional

- Analiza e situatës dhe sfidat e lidhura me objektivin specifik

Konteksti

Në kuadër të ndryshimeve ligjore miratuar me ligjin nr. 50/2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, hyrë në fuqi në datë 30.9.2019, kanë ndryshuar kompetencat e Agjencia e Trajtimit Koncesioneve (ATRAKO), duke u shtuar detyra të reja funksionale, si Sekretariati Teknik i Komitetit për përzgjedhjen e projekteve për t’u mbështetur me ekspertizë të specializuar.

Aktualisht ATRAKO, në zbatim të urdhrit nr. 123, datë 16.10.2012, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencinë së Trajtimit të Koncesioneve” ka 12 punonjës, por ky numër është i ulët për të përballuar detyrat e reja nga ndryshimet ligjore.

Objektivi

Rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i kuadrit institucional të Koncesioneve/PPP.

- Treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet e pritshme

Masat kryesore për arritjen e këtij objektivi janë:

Masa 2.2.1: Përmirësimi i rolit politikëbërës të ATRAKO-s dhe rritja e numrit të stafit.

Masa 2.2.2: Rritja e kapaciteteve të autoriteteve kontraktore për të kuptuar më mirë se si dhe kur

duhen përdorur koncesionet apo PPP-të për përmbushjen e nevojave të tyre.

Masa 2.2.3: Rritja e kapaciteteve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në procesin e vlerësimit të projekteve të koncesionit dhe monitorimit e kontrollit të zbatimit të kontratave koncesionare, me qëllim përcaktimin e një metodologjie standarde në vlerësimin e efektiv të risqeve apo implikimeve fiskale që derivojnë nga këto kontrata.

Masa 2.2.4: Përmirësimi i mekanizmave të menaxhimit të kontratës në autoritetet kontraktore dhe të kapacitetit monitorues të ATRAKO-s në këtë drejtim.

Masa 2.2.5: Publikimi i kontratave të nënshkruara brenda afatit ligjor.

Afati kohor

2020–2022

Institucionet përgjegjëse

ATRAKO

Treguesit e performancës

1. Nxjerrja e akteve nënligjore për reflektimin e ndryshimeve ligjore;

2. Miratimi i strukturës organike;

3. Punonjës të rinj të shtuar;

4. Stafi i MFE-së i trajnuar në vlerësimin e projekteve të koncesionit dhe të monitorimit të zbatimit të kontratave koncesionare;

5. Manuali i përdoruesve i përditësuar;

6. Programi i trajnimit;

7. 100 nëpunës të ngarkuar në kryerjen e procedurave të koncesioneve dhe PPP pranë ministrive dhe bashkive në vit të trajnuar;

8. 4 manuale udhëzimi specifike të publikuara;

9. Udhëzimi për monitorimin e kontratave;

10. Format i raportimit (si pjesë e udhëzimit);

11. Trajnim i 12 nëpunësve të ATRAKO-s për sistemin e monitorimit;

12. Kontratat e publikuara në regjistrin elektronik.

6. Qëllimi i politikës 3 – Riorganizimi i prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë

Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, pas miratimit të ligjit të ri 36/2020, kanë filluar me procesin e riorganizimit të tyre, si në aspektin ligjor, ashtu dhe në atë institucional. Ky riorganizim ka për qëllim plotësimin e kuadrit ligjor në këtë fushë, duke detajuar më tej dispozitat e parashikuara në ligjin e ri, si dhe të përmirësojë kuadrin institucional nëpërmjet së cilit varet zbatueshmëria e ligjit në këtë fushë. Për më tepër,



këto nisma vijnë dhe si nevojë për përmbushjen e kritereve dhe detyrimeve që vijnë nga procesi i integritetit evropian.

6.1 Objektivi specifik 1 – Përmirësimi i kuadrit rregullator të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

- Analiza e situatës dhe sfidat e lidhura me objektivin specifik

Konteksti

Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë ka qenë një fushë, e cila ka pasur mungesë të rregullave të qarta ligjore për sa u përket prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve të lidhura me mbrojtjen dhe sigurinë. Kjo pasi ka pasur një mungesë të një ligji të posaçëm për këtë fushë dhe është rregulluar vetëm nëpërmjet akteve nënligjore.

Për këtë arsye, në prill të 2020-ës, është miratuar një ligj për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duke transpozuar kështu direktivën 2009/81/EC.

Megjithatë, ligji i miratuar nuk rregullon plotësisht prokurimet në këtë fushë dhe për këtë arsye lind nevoja për miratimin e rregullave të detajuara, me qëllim që ligji të bëhet sa më i kuptueshëm për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë, gjë e cila do të sillte një zbatim eficient të procedurave.

Objektivi

Objektivi kryesor është rregullimi i procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë nëpërmjet hartimit të dispozitave ligjore dhe nënligjore.

- Treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet e pritshme

Masat kryesore për arritjen e këtij objektivi janë:

Masa 3.1.1: Miratimi i legjislacionit dytësor përkatës në zbatim të ligjit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Ligji i ri për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë do të plotësohet me akte nënligjore, me qëllim organizimin dhe detajimin e mëtejshëm të rregullave të prokurimit për këto lloje procedurash.

Afati kohor

2020–2021

Hartimi/miratimi i legjislacionit dytësor.

Institucionet përgjegjëse

Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, APP

Treguesit e performancës

1. VKM për rregullat e prokurimit;

2. Udhëzime të MM-së, MB-së etj.

6.2 Objektivi specifik 2 – Përmirësimi i kuadrit institucional për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

- Analiza e situatës dhe sfidat e lidhura me objektivin specifik

Konteksti

Miratimi i ligjit 36/2020 për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë jo vetëm që ka përmirësuar ndjeshëm kuadrin ligjor në këtë fushë, por edhe ka ofruar sigurinë ligjore për autoritetet kontraktore që prokurojnë në të. Gjithashtu, ligji e përcakton qartë se cilat lloje institucioneve konsiderohen si autoritete kontraktore për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Për më tepër, janë të parashikuara qartazi në dispozita, institucionet të cilat janë brenda fushës së zbatimit të këtij ligji, sikurse është Agjencia e Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, autoriteti përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar, si dhe Ministria e Mbrojtjes.

Megjithatë, ligji nuk parashikon dispozita për të gjitha institucionet të cilat gjenden brenda fushës së zbatimit të tij, ku të përcaktohet në mënyrë të detajuar dhe roli i tyre në të. Mungesa e këtyre dispozitave shfaq një pasqyrim jo të plotë të kuadrit institucional të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe mund krijojë paqartësi për rolin që kanë vetë institucionet në këtë fushë.

Nga ana tjetër, ligji 36/2020 sjell dispozita dhe procedura të reja, për të cilat është e nevojshme që të zhvillohen trajnime për punonjësit e AK-së që operojnë në këtë fushë.

Objektivi

Rritja e kapaciteteve të AK-së, të cilat zhvillojnë procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

- Treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet e pritshme

Masat kryesore për arritjen e këtij objektivi janë:

Masa 3.2.1: Përcaktimi i saktë i roleve të institucioneve publike për sa i përket politikëbërjes, zhvillimit dhe monitorimit të procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Masa 3.2.2: Organizimi i aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe të trajnimit për autoritetet kontraktore, në lidhje me përdorimin e dispozitave të këtij ligji.



Afati kohor
2020–2023

Institucionet përgjegjëse

Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme,
APP (DSIK, SHISH, MEPJ etj.)

Treguesit e performancës

1. Institucione përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë të identifikuar në ligjin e ri dhe aktet nënligjore;

2. Numri personave të trajnuar për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

7. Qëllimi i politikës 4 – Blerja e përqendruar

Blerja e përqendruar është pjesë shumë e rëndësishme e fushës së prokurimit publik e cila kryhet nga institucione të cilat luajnë rolin e organeve qendrore blerëse (OQB) për punë, mallra dhe shërbime të caktuara. Kur kushtet janë të përshtatshme, blerja e përqendruar, bazuar në nevojat e institucioneve për blerje, të cilat grumbullohen nga OQB-ja, krijon një mjedis shumë të favorshëm për biznesin, si dhe rrit eficiencën dhe ul kostot financiare dhe operacionale. Në Shqipëri operojnë disa institucione të cilat kanë rolin e OQB-së, por më kryesoret mbeten Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, e cila prokuron mallra dhe shërbime të caktuara për organet e qeverisjes qendrore, si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e cila prokuron produktet në fushën e mjekësisë. Megjithatë, blerja e përqendruar, e cila vihet në zbatim nga këto institucione kërkon përmirësime të mëtejshme, me qëllim që të rritet efienca gjatë zhvillimit të këtyre aktiviteteve.

7.1 Objektivi specifik 1 – Veprimtaria e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara

- Analiza e situatës dhe sfidat e lidhura me objektivin specifik

Konteksti

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara është krijuar, organizohet dhe funksionon sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 81, datë 14.2.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara”. ABP-ja është një institucion i krijuar rishtazi në vitin 2018, si nevojë e reformimit dhe e kalimit në një nivel më të lartë organizimi institucional, se sa ish-Drejtoria e Përgjithshme e Prokurimeve të Përqendruara, e

cila ishte pjesë e strukturës organizative të Ministrisë së Brendshme, e në këtë kuadër, Agjencia është krijuar që të funksionojë si institucion qendror buxhetor në varësi të ministrit.

Në cilësinë e organit qendror blerës të autorizuar me vendim të Këshillit të Ministrave, Agjencia ka si mision kryerjen e procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve të përcaktuara në aktin nënligjor përkatës. Përgjithësisht, Agjencia mund të zhvillojë procedurë prokurimi edhe kur kërkohet nga një autoritet ose një grup autoritetesh kontraktore, për mallra ose shërbime, që nuk i janë ngarkuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara është ngarkuar me unifikimin e specifikimeve teknike dhe termave të referencës, të disa mallrave dhe shërbimeve të përqendruara, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendës a të huaj, si dhe hartimin e katalogëve të standardeve.

Kompetencë e shtuar për Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara është e drejta për të monitoruar në çdo kohë zbatimin e kontratave nga autoritetet kontraktore, në drejtim të korrektesisë dhe cilësisë së zbatimit të kontratave, si dhe dërgimi i informacionit mbi rezultatet e monitorimit pranë Agjencisë së Prokurimit Publik.

Gjithsesi, mungojnë analizat e vlerësimit mbi aktivitetet e saj, gjë që krijon një boshllëk në informacion dhe pengon APP-në apo palë të tjera që të japin asistencën e tyre në çështje të ndryshme që mund të hasen nga ky institucion, si dhe të masin nivelin e saj të performancës.

Objektivi

Garantimi i një sistemi të blerjes së përqendruar eficient dhe transparent.

- Treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet e pritshme

Masat kryesore për arritjen e këtij objektivi janë:



Masa 4.1: Vlerësimi i veprimtarisë të Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara.

Është e nevojshme që të kryhen analiza mbi aktivitetet e deritanishme të ABP-së, si dhe sfidat dhe vështirësitë e hasura, si dhe të eksploroehen mënyra se si të zhvillohet sa më mirë prokurimi i përqendruar i mallrave apo i shërbimeve, përfshirë këtu dhe mjetet elektronike. Në këtë aspekt, është e rëndësishme që të vlerësohet niveli i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit që zhvillon Agjencia, për të analizuar më tej nëse nëpërmjet veprimtarisë së saj Agjencia garanton pjesëmarrje të gjerë dhe konkurrencë midis operatorëve. Gjithashtu, vlerësimi i nivelit të kursimit të fondeve publike në përfundim të procedurave të realizuara të prokurimit është i rëndësishëm për të përcaktuar nëse veprimtaria e Agjencisë është efiçiente.

Masa 4.2: Kryerja e studimeve dhe analizave të ndryshme dhe konsultimi me operatorët ekonomikë.

Konsultim i vazhdueshëm me operatorët ekonomikë, si dhe nxitja e tyre për bashkëpunim dhe dhënie mendimi, mbi specifikimet teknike/termat e referencës të mallrave dhe shërbimeve që prokurohen nga Agjencia, si dhe dhënia e çmimeve sa më reale nga ana e tyre, gjatë fazës së testimit të tregut.

Studime dhe analiza janë të nevojshme të kryhen, së bashku me autoritetet kontraktore dhe Agjencinë e Prokurimit Publik, si në drejtim të rishikimit dhe të përmirësimit të specifikimeve teknike/termave të referencës të unifikuara të disa mallra dhe shërbimeve, ashtu edhe në drejtim të vendosjes së kriterëve të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit që zhvillon Agjencia në emër e për llogari të tyre.

Standardizimi i kriterëve të pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit, për secilin objekt prokurimi mallrash apo shërbimesh, në varësi të specifikës që kanë.

Afati kohor

2020–2023

Institucionet përgjegjëse

APP, ABP

Treguesit e performancës

1. Raporti i vlerësimit i hartuar;

2. Lista e aktiviteteve të publikuara;

3. Analizat e tregut;

4. Takime me operatorët ekonomikë.

7.2 Objektivi specifik 2 – Blerja e përqendruar në fushën e shëndetësisë

- Analiza e situatës dhe sfidat e lidhura me objektivin specifik

Konteksti

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vepron si OQB *sui generis*. Konkretisht, përveç legjislacionit specifik të prokurimit publik, bazë ligjore në këtë fushë është:

- Me vendimin nr. 135, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë për disa mallra dhe shërbime”, të ndryshuar, është lejuar kjo Ministri të kryejë procedura të përqendruara prokurimi në 2018-ën, në emër dhe për llogari të spitaleve publike për barna dhe materiale mjekimi. Gjithashtu, në kuadër të këtij vendimi, kjo Ministri mund të lidhë kontrata të posaçme MEA (*Managed Entry Agreements*), sipas kushteve të përcaktuara në të.

- Mbështetur në pikën 15 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 5.11.2014, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore publike të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me kërkesë të autoriteteve kontraktore (qendrave shëndetësore), zhvillon procedura të përqendruara prokurimi për disa mallra dhe shërbime, kur blerja e përqendruar do të ishte më e leverdisshme, në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

- Bazuar në udhëzimin e ministrit të Shëndetësisë nr. 334, datë 4.8.2015, MSHMS-ja mund të veprojë si OQB për të gjitha institucionet e vartësisë për objektet: pajisje mjekësore, dentare, laboratorike, hotelerie spitalore dhe pajisje mobilimi në përdorim të QSH, pajisje mjekësore laboratorike për ISHP-në, QKTGJ-në dhe laboratorët e shëndetit publik, shërbimin e mirëmbajtjes së aparaturave mjekësore komplekse spitalore (skaner, rezonancë etj.).

Gjithsesi mungojnë analizat e vlerësimit mbi aktivitetet e saj, gjë që krijon një boshllëk në informacion dhe pengon APP-në apo palë të tjera që të japin asistencën e tyre në çështje të ndryshme



që mund të hasen nga ky institucion, si dhe të analizojnë nivelin e saj të performancës.

Mungojnë udhëzime të unifikuara lidhur me përdorimin e MEAs apo për standardizimin e objektit të blerjeve të përqendruara në fushën e shëndetësisë.

Objekti

Përmirësimi i praktikave të prokurimit të përqendruar në fushën e shëndetësisë, me qëllim garantimin e cilësisë, eficiencës dhe vlerës në para.

- Treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet e pritshme

Masat kryesore për arritjen e këtij objekti janë:

Masa 4.2.1: Vlerësimi i veprimtarisë së OQB-së në fushën e shëndetësisë.

Është e nevojshme që të kryhen studime mbi aktivitetet e deritanishme të MSHMS-së, si OQB-ja, si dhe sfidat dhe vështirësitë e hasura, si dhe të eksplorohej mënyra se si të zhvillohet sa më mirë prokurimi i përqendruar i mallrave apo i shërbimeve, përfshirë këtu dhe mjetet elektronike.

Masa 4.2.2: Analizimi i problematikave të hasura dhe marrja e masave për adresimin e tyre.

Afati kohor

2020–2023

Institucionet përgjegjëse

MSHMS

Treguesit e performancës

1. Raporti i vlerësimit i hartuar;

2. Studimet dhe analizat statistikore të realizuara.

8. Qëllimi i politikës 5 – Përmirësimi i sistemit të shqyrtimit të ankesave

- Analiza e situatës dhe sfidat e lidhura me objektivin specifik

Konteksti

Shqyrtimi i ankesave është parashikuar nga ligji i prokurimit publik, i cili parashikon procesin kryesor, si dhe organin përgjegjës për shqyrtimin e ankesave dhe për marrjen e vendimit përfundimtar në këtë drejtim.

LPP-ja është amenduar në 2017-ën, me qëllim sigurimin e pavarësisë së Komisionit të Prokurimit Publik, duke e sjellë atë në të njëjtën linjë me kërkesat e direktivave përkatëse të BE-së. Gjithsesi, ndryshimet e bëra në 2017 kishin të bënin vetëm me riorganizimin institucional dhe nuk iu referuan problematikave të tjera të identifikuara, si: periudha e pritjes dhe pavlefshmëria e kontratave.

Për më tepër, problematika të tjera janë identifikuar sa i takon funksionimit të KPP-së,

veçanërisht kohëzgjatjes së vendimmarrjes, të cilat kanë nevojë që të adresohen.

Objekti

Krijimi i një sistemi eficient për shqyrtimin e ankesave.

Në kuadër të krijimit të një sistemi sa më eficient për shqyrtimin e ankesave, KPP do të krijojë një platformë të posaçme trajnimi për të gjithë nivelet e stafit, staf mbështetës, inspektorë, Komisionerë. KPP në angazhim me SIGMA, Open Contracting Partnership, do të nisë një fushatë trajnimi duke nisur nga muaji Shtator e në vijim, mbi ligjin e ri të prokurimit publik, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve. Është planifikuar që duke nisur nga muaji Shtator e në vijim, do të dakordësohet një platforme trajnimi me ASPA, Shkolla e Magjistrurës, Universiteti i Tiranës, për stafin e KPP.

- Treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet e pritshme

Masat kryesore për arritjen e këtij objekti janë:

Masa 5.1: Përmirësimi i dispozitave të LPP-së mbi shqyrtimin e ankesave, me qëllim përafrimin me direktivën 2007/66.

Masa 5.2: Miratimi i rregullave procedurale të KPP-së, të cilat garantojnë vendime të përpikta dhe efektive.

Masa 5.3: Rritja e kapaciteteve institucionale të KPP-së nëpërmjet rritjes së numrit të stafit dhe organizimit të trajnimeve, sa i takon legjislacionit të Prokurimit Publik, koncesioneve/PPP dhe prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Masa 5.4: Ngritja e sistemit të ankesave për KKP-në (*e-Appealing*).

Komisioni i Prokurimit Publik, për realizimin e ngritjes së sistemit *online* të ankesave (*e-appealing*), ka kërkuar angazhim dhe bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për krijimin e Sistemit të *e-Ankesave* e lidhur me sistemin *e-Albania*. Përmes sistemit *e-Albania*, do të jepet mundësia në fazë të mëvonshme të zbatimit të projektit, të dorëzohet dhe informacioni nga ana e autoriteteve kontraktore.

Gjithashtu do të krijohet sistemi i menaxhimit të brendshëm të proceseve të punës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe arkiva e digjitalizuar. Pjesë e infrastrukturës së re të IT-së do të jetë edhe krijimi i *web* faqes së re të Komisionit të Prokurimit Publik, në të cilën do të pasqyrohet në kohe reale informacioni në lidhje me

vendimarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik, bazuar në parimet e *Open Data*. Sistemi do të krijojë mundësinë e *smart search* të vendimarrjes së Komisionit. Për secilën çështje do të krijohet *case/profile* në të cilën do të publikohet ecuria e shqyrtimit të çështjes dhe informacion mbi çështjet që janë duke u shqyrtuar pranë organeve gjyqësore.

Afati kohor

2020–2023

Institucionet përgjegjëse

KPP, APP

Treguesit e performancës

1. LPP i rishikuar;
2. Rregullat procedurale të hartuara;
3. Numri i personelit shtesë;
4. Numri i trajnimeve të organizuara;
5. Analiza funksionale për ngritjen e sistemit elektronik të menaxhimit të ankesave (pas miratimit të ligjit);
6. Sistemi i ankesave funksional.

PJESA III

ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020–2023 u realizua nga një grup ndërinstitucional pune, i përbërë nga të gjitha institucionet që veprojnë në fushën e prokurimit, bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 102, datë


3.7.2019, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për bashkërendimin, hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin publik dhe planit të veprimit”.

Angazhimi i institucioneve publike i jep kësaj Strategjie mundësinë për të qenë objektive dhe e realizueshme. Grupi ndërinstitucional i , si dhe të gjithë aktorët e përfshirë në konsultime dhanë komente të vlefshme, duke e rishikuar disa herë draftin e përgatitur, me qëllim miratimin e një Strategjie gjithëpërfshirëse, ku secili të gjejë veten e të japë kontributin e tij në garantimin e një menaxhimi sa më të mirë të fondeve publike dhe ofrimin e shërbimeve publike sa më cilësore.

Këto institucione janë përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit e aktiviteteve të përcaktuara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit.

Sikurse paraqitet edhe në objektivat specifike dhe aktivitetet kryesore të propozuara në këtë Strategji dhe Planin e Veprimit, Agjencia e Prokurimit Publik është institucioni kryesor për koordinimin dhe monitorimin e objektivave dhe aktiviteteve të parashikuara.

Koordinimi dhe monitorimi i zbatimit të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik do të bëhet në bazë të mekanizmit të mëposhtëm:





Përbërja, rolet dhe përgjegjësitë e strukturës drejtuese janë detajuar si më poshtë:

- Komiteti Drejtues i Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik

Komiteti Drejtues i SKPP-së është struktura mbikëqyrëse përgjegjëse për drejtimin dhe monitorimin e aktiviteteve të këtij dokumenti. Ai do të kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik dhe anëtarësia e tij do të jetë si më poshtë:

- Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik, kryetar;

- Drejtori i Drejtorisë Juridike, të Verifikimit dhe Integritetit, Agjencia e Prokurimit Publik, sekretar;

- Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, anëtar;

- Një përfaqësues i nivelit të lartë drejtues nga Ministria e Mbrojtjes, anëtar;

- Një përfaqësues i nivelit të lartë drejtues nga Ministria e Brendshme, anëtar;

- Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, anëtar;

- Kryetari i Komisionit të Prokurimit Publik, anëtar.

KD-ja do të mbledhet çdo gjashtë muaj për të shqyrtuar progresin e reformave, të rishikojë risqet dhe të miratojë masa lehtësuese. Herë pas here mund të ftojë persona të tjerë në KD në varësi të çështjeve që janë për shqyrtim.

Përgjegjësitë e KD-së renditen si më poshtë vijon:

1. Caktimi i koordinatorëve për secilin nga qëllimet e politikave të Strategjisë, bazuar në propozimet e institucioneve përgjegjëse për secilin prej tyre.

2. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë së PP-së kundrejt objektivave të synuar dhe treguesve të performancës dhe miratimi i raporteve gjashtëmujore dhe njëvjeçare;

3. Shqyrtimi i arritjeve, risqeve dhe problematikave për secilin qëllim të politikave dhe përcaktimi i masave për adresimin e tyre.

4. Bashkëpunimi me institucione të tjera për të garantuar zbatimin e masave dhe përmbushjen e objektivave të SKPP-së.

5. Në bashkëpunim me GQP-të përgatit dhe miraton raportin e ndërmjetëm trevjeçar të zbatimit të Strategjisë dhe rishikon objektivat dhe planin e veprimit.

Raportet e monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik, të miratuara nga KD-ja publikohen në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

- Sekretariati Teknik i Strategjisë Kombëtare për PP-në

Drejtorja Juridike, e Verifikimit dhe Integritetit do të shërbejë si Sekretariat Teknik për KD-në e SKPP-së. Përgjegjësitë e Sekretariatit Teknik (ST) janë renditur më poshtë:

1. Të sigurojë të gjithë mbështetjen teknike për menaxhimin e procesit për funksionimin e KD-së dhe të grupeve për qëllimin e politikave (GQP);

2. Të bashkërendojë punën midis KD-së dhe në raste të caktuara, me grupe ndërinstitucionale për kapitujt që lidhen me integrimin evropian, duke pajtuar kalendarët dhe agjendat përkatëse;

3. Të bashkërendojë punën midis institucioneve të përfaqësuara në KD dhe/ose GQP, institucioneve të pavarura, grupeve të interesit etj.;

4. Të sigurojë udhëzime të punës metodologjike, teknike dhe të standardizimit për KD-në dhe/ose GQP-në për përgatitjen e instrumenteve përkatëse të planifikimit strategjik;

5. Të organizojë takime të KD-së dhe/ose GQP-së dhe të parashtrijë çështje diskutimi të përgatitura në bashkëpunim me anëtarët dhe palët e tjera të interesuara;

6. Të përgatisë listën e anëtarëve të përhershëm dhe të ftuarve të tjerë për grupin përkatës; të organizojë agjendën, takime dhe aktivitete të tjera sekretariale;

7. Të përgatisë raporte periodike (6-mujore dhe vjetore), në lidhje me monitorimin e zbatimit të Strategjisë, bazuar në raportimet e dërguara nga institucionet përgjegjëse, si edhe në lidhje me funksionimin e KD-së dhe/ose GQP-së;

8. Të kryejë çdo detyrë tjetër të caktuar nga KD-ja dhe/ose GQP-në, në përmbushje të përgjegjësiave të tij.

- Grupet e Qëllimit të Politikës

Grupet e Qëllimit të Politikës (GQP) do të ngrihen si struktura në kuadrin e KD-së, të cilat do të shërbejnë si instrumente kryesore për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të planit të veprimit dhe do të vlerësojnë mbi baza të vazhdueshme progresin e objektivave për secilin qëllim të politikës.



Çdo GQP do të kryesohet nga një drejtues i cili/e cila do të jetë përgjegjës/e për të kontribuar në raporte gjashtëmujore të progresit, në vlerësimet e risqeve gjatë zbatimit të Strategjisë, të propozojë masa lehtësuese dhe të ndërmarrë masa përmirësuese, nëse kërkohet.

Në vijim do të ngrihen GQP-ja përkatëse si më poshtë:

GQP 1: Për prokurimin publik;

GQP2: Për koncesionet dhe PPP-të;

GQP3: Për prokurimet në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë;

GQP4: Për blerjen e përqendruar;

GQP5: Për sistemin e ankesave.

PJESA IV PLANI I VEPRIMIT DHE BURIMET FINANCIARE PËR ZBATIM

Vlerësimi i nevojave financiare për zbatimin e SKPP-së u realizua nëpërmjet procesit të vlerësimit në mënyrë të detajuar të kostos dhe shpenzimeve që do të kërkojë zbatimi i secilit prej aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit të zbatimit të Strategjisë. Vlerësimi i elementeve të kostove të nevojshme u realizua mbi bazën e një konsultimi dhe shqyrtimi të hollësishëm të të gjithë hapave të nevojshëm që do të duheshin për zbatimin e një aktiviteti të caktuar dhe gjithë veprimeve që do të ndihmonin për realizimin e produkteve përkatëse të aktiviteteve. Duke qenë se SKPP-ja është një Strategji horizontale me përfshirje të disa institucioneve publike, vëmendje e veçantë jiu kushtua përcaktimit të shpenzimeve shtesë që do të sillnin në buxhetin e secilit institucion zbatimi i secilit aktivitet. Për të mbajtur të pastër efektin shtesë nuk janë llogaritur shpenzimet administrative (paga të stafit, shpenzime operacionale dhe mirëmbajtjeje) të institucioneve publike të përfshira në zbatimin e Strategjisë. Kjo qasje u ndoq për të vlerësuar sa më qartë efektin shtesë në buxhetin e secilit institucion.


Nevoja financiare të nevojshme për zbatimin e veprimeve të SNRAP-së gjatë periudhës kohore prej 2020–2023 parashikohet të jetë në nivelin 41.18 milionë lekë ose 336.2 mijë euro⁷.

Tabela 1: Kostoja e zbatimit të Strategjisë sipas qëllimeve të politikës


Qëllimet e politikës	Kostoja totale (lek)	Kostoja totale (EUR)
1. Prokurim publik eficient dhe i qëndrueshëm	24,585,750.00	200,700
2. Përmirësimi i kuadrit ligjor për koncesionet dhe partneritetin publik-privat	13,048,308.00	106,517
3. Riorganizimi i prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë	1,102,500.00	9,000
4. Blerja e përqendruar		0
5. Përmirësimi i sistemit të shqyrtimit të ankesave	2,450,000.00	20,000
TOTALI	41,186,558.00	336,216.80

Siç shihet nga të dhënat në tabelat 1, si dhe grafiku 1 më poshtë, peshën specifike më të madhe e zënë shpenzimet për zbatimin e aktiviteteve në qëllimin e politikës “Prokurim publik eficient dhe i qëndrueshëm”, i cili zë edhe 55% të totalit të kostos së vlerësuar për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë.

⁷ Sipas lidhjes 3, “Vlerësimi i detajuar i kostos për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Prokurimit Publik 2020–2023”.

Grafiku 1: Pesha specifike e kostos, sipas qëllimeve të politikave


Në aspektin shpenzimeve, sipas klasifikimit ekonomik, grafiku 2 më poshtë paraqet shpenzimet e nevojshme, sipas të tria kategorive, paga, shërbime korrente dhe shpenzime kapitale. Pjesën më të madhe të shpenzimeve të vlerësuara e zënë shpenzimet korrente, pasi këtu përfshihet kostoja e asistencës teknike të nevojshme për realizimin e aktiviteteve, sidomos ato që lidhen me rishikimin e legjislacionit dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve që merren me zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik. Strategjia nuk parashikon asnjë investim kapital.

Grafiku 2 : Shpenzimet sipas zërave ekonomikë (lek)

Duhet përmendur se pjesa më e madhe e aktiviteteve të Strategjisë, 85% (35 ndaj 41 në total) do të realizohen me vetë kapacitetet njerëzore dhe administrative të strukturave institucionale të përfshira në zbatimin e strategjisë dhe vetëm për 6 aktivitete vlerësohet e domosdoshme mobilizimi i burimeve financiare dhe burimeve njerëzore shtesë.


Pjesa më e madhe e shpenzimeve siç paraqitet në grafikun 3 do të mobilizohen në dy vitet e para të realizimit të planit të veprimit. Kjo përkon me aktivitetet për të cilat është siguruar financimi i Buxheti i Përgjithshëm i Qeverisë, si dhe mbështetja në vazhdim e donatorëve të ndryshëm.

Grafiku 3: Shpërndarja e nevojave sipas viteve 2020–2023



Buxheti i shtetit do të jetë mbulojë rreth 36% të kostos shtesë nga zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit. Asistenca teknike parashikohet të ofrohet nga donator të ndryshëm, si Bashkimi Evropian, nëpërmjet SIGMA/OECD, Banka Botërore, GIZ, si dhe donatorë të tjerë.

Grafiku 4: Burimet e financimit dhe boshllëku financiar



Duhet theksuar se përcaktimi i financimit nga SIGMA/OECD nëpërmjet programeve të financuara nga Bashkimi Evropian, është përcaktuar bazuar në mbështetjen e kaluar të ofruar nga ky institucion. Përcaktimi i saktë i mbështetjes do të jetë subjekt i diskutimeve konkrete gjatë vitit 2020.



ANEKS 1
PLANI I VEPRIMIT

Plani i aktiviteteve 2020–2023								
Nr. i objektivit	Detajimi i objektivit	Aktivitetet			Institucioni përgjegjës	Institucioni bashkëpunues	Data e fillimit	Data e mbarimit
		Nr. i aktivitetit	Detajimi i aktivitetit	Treguesi i matjes në nivel produkti (<i>output</i>)				
1	2	3	4	5	6	7	8	9
Qëllimi i politikës 1: Prokurim publik eficient dhe i qëndrueshëm								
Objektivi 1.1	Përmirësimi dhe përafrimi i legjislacionit të prokurimit me <i>acquis</i> të BE-së	Aktiviteti 1.1.1	Rishikimi (<i>Screening</i>) i legjislacionit, me qëllim përcaktimin e shkallës së përafrimit me direktivat e BE-së dhe identifikimin e boshllëqeve kryesore për t'u adresuar	1. Analiza e legjislacionit e realizuar 2. Tabela e përputhshmërisë	APP		TM III 2020	TM IV 2020
		Aktiviteti 1.1.2	Finalizimi i procesit të hartimit dhe të miratimit të draftligjit të ri për prokurimin publik duke transpozuar direktivat 2014/24 dhe 2014/25	1. Ligji i transpozuar i hartuar	APP		TM I 2020	TM II 2020



		Aktiviteti 1.1.3	Hartimi dhe miratimi i rregullave plotësuese dhe i legjislacionit dytësor për zbatimin e ligjit në mënyrën e duhur	1. VKM për miratimin e rregullave 2. Miratimi i ligjit në Parlament 3. Udhëzimet në zbatim të ligjit dhe VKM-ve të miratuara 4. Dokumentet standarde të Tenderit të rishikuara	APP		TM IV 2020	TM I 2022
Objektivi 1.2	Fuqizimi i rolit dhe kapaciteteve të Agjencisë së Prokurimit Publik	Aktiviteti 1.2.1	Rritja e kompetencave të APP-së në të gjitha fazat e procesit	1. Përcaktimi i saktë i kompetencave në nenet e ligjit të ri të PP-së	APP		TM I 2020	TM IV 2020
		Aktiviteti 1.2.2	Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve të APP-së sipas fushave	1. Plani i trajnimit i hartuar 3. Trajnimi i rreth 40 punonjësve të APP-së sipas fushave 4. Vizita studimore/trajnime në vendet e tjera	APP		TM I 2020	TM IV 2023
Objektivi 1.3	Organizimi dhe profesionalizimi i funksionit të prokurimit	Aktiviteti 1.3.1	Hartimi i një udhërrëfyesi për profesionalizimin e funksionit të prokurimit ku të parashikohen hapat e nevojshëm për finalizimin e procesit	1. <i>Gap analysis</i> 2. Udhërrëfyesi për profesionalizimin e funksionit të prokurimit i hartuar	APP		TM II 2020	TM I 2021



		Aktiviteti 1.3.2	Përgatitja e një kurrikule të re trajnimi për nëpunësit e përfshirë në procedurat e prokurimit dhe një plan trajnimi - Hartimi i një programi trajnimi certifikues dhe të posaçëm për trajnimin e trajnuesve për prokurimin publik i shoqëruar me kurrikulën e re të trajnimit - Hartimi i një kurrikule për trajnerët - Hartimi i një kurrikule trajnimi për prokurimin publik - Pilotimi kurrikulës	1. Një kurrikul trajnimi e re për trajnerë 2. Kurrikul trajnimi bazë dhe e avancuar	APP, ASPA		TM I 2021	TM IV 2022
		Aktiviteti 1.3.3	Rishikimi i kriterëve specifike që duhen plotësuar për punonjës prokurimi dhe rishikimi i përshkrimeve të punës për këto pozicione në institucionet pjesë e fushës së veprimit të legjislacionit për nëpunësin civil, në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe me këtë strategji, si dhe hartimi dhe miratimi i tyre për të njëjtat pozicione në institucionet e tjera	1. Kriteret specifike që duhen plotësuar për të qenë punonjës prokurimi të përcaktuara 2. Përshkrimet e punës të hartuara	APP, DAP		TM II 2021	TM IV 2022
		Aktiviteti 1.3.4	Ngritja dhe funksionimi i plotë i rrjetit të profesionistëve të prokurimit	1. Rrjeti i profesionistëve të prokurimit i ngritur	APP		TM IV 2021	TM IV 2023



Objektivi 1.4	Rritja e eficiencës në prokurimin publik	Aktiviteti 1.4.1	Përcaktimi i rregullave për planifikimin e prokurimit të ndërlidhur me procesin e planifikimit buxhetor mesëm (PBA)	1. Dokument udhëzuese për lidhjen e sistemit të prokurimit elektronik me AGFIS (Sistemi i Informimit Financiar të Qeverisë Shqiptare)	APP, MFE		TM I 2020	TM IV 2020
		Aktiviteti 1.4.2	Parashikimi për përdorimin e detyrueshëm të kodeve CPV nga ana e autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë	1. Vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e kodeve CPV	APP		TM IV 2020	TM II 2021
		Aktiviteti 1.4.3	Nxiti e përdorimit të njoftimit paraprak/periodik për procedurat e prokurimit	1. Njoftimi paraprak/periodik i parashikuar në ligj dhe akte nënligjore	APP		TM I 2021	TM IV 2021
		Aktiviteti 1.4.4	Miratimi i dokumenteve udhëzuese, në lidhje me zbatimin e duhur të dispozitave ligjore për vlerësimin e ofertave dhe rishikimi i Dokumenteve Standarde të Tenderit	1. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit i përfshirë në dokumentet standarde të tenderit	APP		TM I 2021	TM I 2023
				1. Udhëzimet/rekomandimet e APP-së (mesatarisht 2 udhëzime/rekomandime në vit)	APP		TM I 2023	TM IV 2023
		Aktiviteti 1.4.5	Analizimi i funksionimit të tregut publik, duke u bazuar nëkohësisht edhe në këndvështrimin e blerësve-autoriteteve kontraktorë edhe në atë të operatorëve ekonomikë	1. Raporti i analizës së funksionimit të tregut të prokurimit publik i hartuar çdo vit	APP	AK	TM I 2021	TM IV 2023
		Aktiviteti 1.4.6	Ngritja e një forumi për konsultim dhe dialog me sektorin privat		APP, MFE		TM IV 2021	TM IV 2023



		Aktiviteti 1.4.7	Hartimi i dokumenteve udhëzues për përmirësimin e funksionalitetit dhe atraktivitetit të tregut të sektorit publik për SME-në	1. Dokumentet udhëzuese për sektorin privat, në lidhje me të bërit biznes me sektorin publik të hartuara	APP, MFE	AK	TM IV 2021	TM IV 2023
		Aktiviteti 1.4.8	Përmirësimi i monitorimit të zbatimit të kontratës nëpërmjet ngritjes së një mekanizmi për menaxhimin e kontratës	1. Plani i Zbatimit të Kontratës 2. Formulari i raportimit të ecursisë së kontratës 3. Udhëzues për menaxhimin e kontratës; 4. 5 punonjës të APP-së dhe 100 punonjës të AK-së të trajnuar për menaxhimin e kontratës	APP		TM I 2021	TM IV 2021
Objektivi 1.5	Zgjerimi i politikave dhe metodave përprokurimin e qendrueshëm	Aktiviteti 1.5.1	Parashikimi i procedurave më të thjeshtuara të prokurimit që garantojnë mbrojtjen e mjedisit: - Parashikimi ligjor në LPP - Hartimi i legjislacionit dytësor - Parashikimi i kriterëve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit	1. Ligji për prokurimin publik, i ndryshuar 2. Legjislacioni dytësor i hartuar	APP, MSHMS, MTM, MIE		TM IV 2020	TM IV 2022
		Aktiviteti 1.5.2	Ngritja e kapaciteteve dhe përgatitja për prokurimin e shërbimeve sociale: - VKM për prokurimin e shërbimeve sociale - Trajnim i stafit të APP-së dhe AK-së për prokurimin e shërbimeve sociale	1. VKM për prokurimin e shërbimeve sociale e miratuar 2. 40 punonjës të APP-së dhe 100 punonjës të AK-së të trajnuar.	APP, MSHMS, MTM, MIE		TM I 2021	TM IV 2022



Objektivi 1.6	Forcimi i integritetit prokurimin publik	Aktiviteti 1.6.1	Hartimi dhe zbatimi i një politike për integritetin dhe përgjegjshmërinë, brenda autoriteteve kontraktore në përputhje me LPP-në	1. Përfshirja e risqeve dhe e masave të lidhura me prokurimin publik në Manualin e Integritetit dhe në planet e integritetit, si pjesë e Strategjisë kundër Korrupsioni: - Dokument i përbashkët për integritetin e punonjësve në prokurimin publik - Dokument i përbashkët për integritetin e operatorëve ekonomikë në prokurimin publik 2. Manual mbi parandalimin e konfliktit të interesave në prokurimet publike	APP	MD, ILDKPKI, AK	TM I 2021	TM IV 2023
		Aktiviteti 1.6.2	Ngritja e kapaciteteve dhe rritja e ndërgjegjësimit për integritetin në fushën e prokurimit publik	3. Hartimi i udhëzimeve për integritetin në fushën e prokurimit publik 4. 40 punonjës të APP-së dhe 100 punonjës të AK-së trajnuar për integritetin 5. Fushata ndërgjegjësimi mbi integritetin të zhvilluara	APP	ILDKPKI, AK	TM II 2021	TM IV 2023
Objektivi 1.7	Përmirësimi i sistemit elektronik prokurimit	Aktiviteti 1.7.1	Përdorimi i detyrueshëm i kodeve CPV në sistemin elektronik, jo vetëm për autoritetet kontraktore, por edhe për operatorët ekonomikë, ofertuesit	1. VKM për miratimin e kodeve 2. Manuali teknik për përdorimin e kodeve 3. Trajnimi për përdorimin e kodeve (për AK-në do të jetë pjesë e kurrikulës)	APP		TM IV 2020	TM IV 2021



		Aktiviteti 1.7.2	Ndërlidhja e sistemit elektronik të prokurimit me sistemin elektronik të thesarit	1. Moduli i ndërveprimit në sistemin AGFIS për verifikimin e fondeve në momentin e fillimit të procedurave të PP-së (strategjia e PFM-së) 2. Moduli i shkëmbimit të të dhënave të kontratave të fituara nga sistemi i APP-së në sistemin AGFMIS 3. Manuali teknik i brendshëm i përdorimit dhe i përgjegjësi 4. Manuali shpjegues për autoritetet kontraktore i shoqëruar me <i>e-Instruction</i> (video shpjeguese)	APP, AKSHI, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit		TM I 2020	TM IV 2020
		Aktiviteti 1.7.3	Përfshirja e një moduli për menaxhimin e kontratës	1. Analiza funksionale për menaxhimin e kontratës 2. Moduli për menaxhimin e kontratës	AKSHI		TM I 2021	TM IV 2023
		Aktiviteti 1.7.4	Bërja plotësisht funksional i sistemit dinamik të blerjes	1. Analiza funksionale për sistemin dinamik të blerjes 2. Moduli i sistemit dinamik të blerjes	AKSHI		TM I 2023	TM IV 2023
10. Kërkuesi në kërkesën nr. 11321/11 (shih rreshtin nr. 10 të shtojcës), më tej u ankua se kishte pasur shkelje të së drejtës së tij për të hyrë në gjykatë, siç garantohet nga neni 6§1 i Konventës, për shkak të mosshqyrtimit nga ana e autoriteteve të padisë së tij për njohjen e të drejtave të pronësisë, sipas pretendimit të tij.

11. Së fundmi, kërkuesit, në kërkesat nr. 47807/12 dhe 48401/12 (shih rreshtat nr. 34 dhe 37 të shtojcës), u ankuan se kishte pasur një shkelje të nenit 14 të Konventës, pasi nuk u ishte rikthyer toka për të cilën ishte njohur e drejta e parablerjes së ndërtesave.

LIGJI

12. Gjykata vëren se kërkuesit u ankuan në bazë të nenit 6§1 të Konventës dhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, të marra veçmas dhe në lidhje me nenin 13 të Konventës, të cilët, për aq sa është relevante, përcaktojnë sa më poshtë:

Neni 6

E drejta për një proces të drejtë gjyqësor

“1. Në përcaktimin e të drejtave dhe i detyrimeve të tij civile ... çdokush ka të drejtën e një procesi të drejtë ... nga [një] gjykatë ...”

Neni 13

E drejta për zgjidhje efektive

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

Neni 1 i protokollit nr. 1

Mbrojtja e pronës

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pronave të tij. Askush nuk privohet nga pronat e tij përveç në rastet e interesit publik dhe në bazë të kushteve të parashikuara me ligj dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat pararendëse nuk cenojnë në ndonjë mënyrë të drejtën e një Shteti për të zbatuar ato ligje që i çmon të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës, në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose gjobave të tjera.”

A. Çështja paraprake

13. Më 27 korrik 2020, kërkuesit e përfaqësuar nga z. Sokol Puto, përveç kërkuesve në kërkesën nr. 67286/14, bënë një kërkesë për shtyrjen e shqyrtimit të kërkesave të tyre, në pritje të zbatimit të vendimit *Beshiri dhe të tjerët* nga ana e autoriteteve.

14. Pasi shqyrtoi arsyet e paraqitura nga kërkuesit, Gjykata vendosi të rrëzojë kërkesën për shtyrje, në funksion të gjetjeve të bëra në vendimin e çështjes *Beshiri dhe të tjerët* (vendimi). Do të ishte e papërshtatshme të miratohej një qasje tjetër në këto raste nga ajo që Gjykata ka miratuar tashmë në vendimin *Beshiri dhe të tjerët*.

B. Bashkimi i kërkesave

15. Gjykata, duke pasur parasysh lëndën e ngjashme të kërkesave, e gjen të përshtatshme që t'i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm, në përputhje me rregullën 42§1 të Rregullores së Gjykatës.

C. Ankesa sipas nenit 13 të Konventës, si dhe ankesat sipas nenit 6§1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës

1. Për sa i takon vendimit nr. 251, të datës 21 gusht 2008, në kërkesën nr. 78958/11



16. Për sa i përket vendimit nr. 251, datë 21 gusht 2008, dhënë në lidhje me kërkesën nr. 78958/11 (shih rreshtin nr. 18 të shtojcës), Gjykata mban shënim dëshirën e kërkuësve për të tërhequr ankimet e tyre. Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuësit nuk kanë ndërmend të ndjekin ankimet e tyre në lidhje me atë vendim, brenda kuptimit të nenit 37§1 (a) të Konventës dhe nuk gjen asnjë arsye me interes të përgjithshëm, në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, brenda kuptimit të fjalisë së fundit të nenit 37§1, i cili do të kërkonte vazhdimin e shqyrtimit të atyre ankimeve. Nga kjo rrjedh se, për aq sa u takon ankimeve në lidhje me vendimin nr. 251, të datës 21 gushtit 2008, ajo pjesë e kërkesës duhet të hiqet nga lista e çështjeve të Gjykatës.

2. Për sa i takon pjesës së mbetur të kërkesave

17. Në fillim, Gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme të shqyrtohen argumentet e palëve, në lidhje me statusin ligjor të disa kërkuësve ose trashëgimtarëve të tyre, përqindjet e pronave të trashëguara të kërkuësve ose të drejtën e tyre për kompensim ose çdo mospërputhje faktike, në lidhje me vendimet në vend, pasi kërkesat në çdo rast janë të papranueshme për arsyet e mëposhtme.

18. Gjykata vëren se në vitin 2012 ajo ka miratuar një vendim pilot, në lidhje me këto çështje (shih *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më lart), në të cilin konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 6§1 të Konventës, si dhe të nenit 1, të protokollit nr. 1, për shkak të moszbatimit të tejzgjatur të vendimeve të formës së prerë për dhënien e kompensimit dhe shkeljes së nenit 13 të Konventës, për shkak të mungesës së një zgjidhjeje efektive në këtë drejtëm brenda vendit.

19. Më tej, në zbatim të këtij vendimi pilot, u miratua ligji për pronat i vitit 2015, i cili prezantoi një mjet të ri kompensimi (shih paragrafët 5 dhe 6 më lart).

20. Gjykata ka konstatuar kohët e fundit se mjeti juridik i prezantuar nga ligji për pronat i vitit 2015 është efektiv, brenda kuptimit të nenit 35§1 dhe nenit 13 të Konventës (shih *Beshiri dhe të tjerët* (vendimi), cituar më lart, §215). Gjykata nuk sheh asnjë arsye për t'u larguar nga ky konstatim në kontekstin e çështjes në fjalë dhe konsideron se ankimi i kërkuësve, sipas nenit 13 të Konventës (shih paragrafin 8 më lart) është qartazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§§3

dhe 4 të Konventës (shih *Beshiri dhe të tjerët* (deklarata), cituar më sipër, §221).

21. Duke pasur parasysh gjetjet e saj në vendimin *Beshiri dhe të tjerët*, cituar më lart, §224–29, i njëjti konkluzion është i vlefshëm në lidhje me ankimet e kërkuësve se kishte pasur shkelje të nenit 6§1 të Konventës, për shkak të zbatimit retroaktiv të ligjit për pronat të vitit 2015 (shih paragrafin 7 më lart). Gjykata konsideron se ky ankim është, gjithashtu, qartazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§§3 dhe 4 të Konventës.

22. Për sa u përket ankimeve të mbetura të kërkuësve, sipas nenit 6§1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 (shih paragrafin 8 më lart), Gjykata vëren se, në varësi të fazës aktuale të procedurave, në lidhje me secilën kërkesë, mund të veçohen situatat e mëposhtme.

23. Në radhë të parë, Gjykata konstaton, se, pavarësisht nga data e paraqitjes së kërkesave, kërkuësve në kërkesat që gjenden në rreshtat 1–29 dhe 31–73 të shtojcës, përveç vendimeve specifike individuale të dhëna në lidhje me një numër të kufizuar kërkesash, të cilat janë shqyrtuar veçmas në paragrafin 24 më poshtë, u është kërkuar ose u kërkohej në bazë të nenit 35§1 të Konventës për të përfituar nga mjetet e reja juridike në vend, të paraqitura në bazë të ligjit për pronat të vitit 2015, në përputhje me rregullat përkatëse në vend. Doli në pah nga informacioni i dhënë nga Qeveria më 4 mars 2019 se ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar kryesisht (*ex officio*), në lidhje me pothuajse çdo vendim brenda vendit, siç përshkruhet në kolonën që u përket detajeve të zbatimit. Kërkuësit ose nuk kanë arritur të shterojnë mjetet juridike vendëse ose nuk kanë informuar Gjykatën për ndonjë veprim që mund të kenë ndërmarrë në lidhje me këtë. Kjo vlen njësoj si për ato raste në të cilat ATP-ja nuk ka kryer një vlerësim financiar, për shkak të mungesës së dokumentacionit të kërkuar ose për shkak të arsyeve të tjera, në lidhje me të cilat kërkuësve u kërkohej në mënyrë të ngjashme të ndiqnin procedurat përkatëse në vend. Gjykata nuk gjen asnjë rrethanë të jashtëzakonshme që mund të përjashtojë kërkuësit nga detyrimi për të shteruar mjetet e brendshme juridike (shih *Beshiri dhe të tjerët* (vendimi) cituar më sipër, §§216–18). Nga kjo rrjedh se këto ankime duhet të rrëzohen sipas nenit 35§§1 dhe 4 të Konventës për mosshterimin e mjeteve juridike vendëse. Pavarësisht nga konkluzioni i mësipërm, Gjykata rikujton



përcaktimet e bëra në paragrafin 222 të vendimit në çështjen *Beshiri dhe të tjerët* (vendimi), cituar më lart, në lidhje me kushtet që autoritetet duhet të plotësojnë në mënyrë që mjeti të vazhdojë të mbetet efektiv.

24. Së dyti, në lidhje me vendimin nr. 2406, datë 8 nëntor 2013, dhënë në lidhje me kërkesën nr. 68195/14 (shih rreshtin nr. 57 të shtojcës); vendimin nr. 70, të datës 14 prill 2006, dhënë në lidhje me kërkesën nr. 74968/14 (shih rreshtin nr. 62 të shtojcës); dhe kërkesat nr. 70211/13, 70730/014 dhe 9152/15 (shih rreshtat nr. 74-76 të shtojcës), Gjykata vëren se procedurat e brendshme, në lidhje me përcaktimin e shumës së kompensimit kanë mbetur pezull në gjykatat kombëtare. Prandaj, ajo konsideron se do të ishte e parakohshme që ajo të trajtonte këto ankime, të cilat duhet të rrëzohen sipas nenit 35§§1 dhe 4 të Konventës (shih *Beshiri dhe të tjerët* (vendimi) cituar më lart, §219). Praktika gjyqësore vijuese e Gjykatës së Lartë rikonfirmon më tej se, kur një ankim është depozituar në gjykatën më të lartë, vendimet e gjykatave më të ulëta do të marrin formë të prerë dhe do të bëhen të zbatueshme me dorëzimin e një vendimi nga Gjykata e Lartë (shih paragrafin 7 më lart).

25. Së treti, Gjykata, duke pasur parasysh pagesën e plotë të shumës së kompensimit sipas kërkesës së kërkuësve, siç përcaktohet në parashtrësën e Qeverisë, të datës 4 mars 2019, konsideron se kërkuësit në kërkesën nr. 67286/14 (shih rreshtin nr. 77 të shtojcës) nuk mund të pretendojnë më të jenë “viktimë” e shkeljeve të të drejtave të tyre, sipas nenit 6§1 të Konventës dhe nenit 1, të protokollit nr. 1, brenda kuptimit të nenit 34 të Konventës (shih *Beshiri dhe të tjerët* (vendimi) cituar më lart, §220). Nga kjo rrjedh se kjo kërkesë është e papajtueshme *ratione personae* me dispozitat e Konventës për qëllimet e nenit 35§1 dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§4.

26. Së fundmi, Gjykata vëren, se procedurat në vend në lidhje me njohjen fillestare të të drejtave për pronat e trashëguara të kërkuësve në kërkesën nr. 30942/12, janë akoma pezull (shih rreshtin nr. 30 të shtojcës). Nuk është marrë asnjë vendim i formës së prerë, nuk mund të thuhet se kërkuësit kanë “posedime ekzistuese” brenda kuptimit të nenit 1, të protokollit nr. 1. Besimi se, në të ardhmen, autoritetet mund të nxjerrin një vendim që njeh të drejtat për pronat e trashëguara të

kërkuësve nuk mund të konsiderohet si një formë e “pritshmërisë legjitime” për qëllimet e nenit 1, të protokollit nr. 1. Gjykata rikujton se ekziston një ndryshim midis një shprese të thjeshtë për rikthim, sado e kuptueshme që mund të jetë shpresa, dhe një pritshmërie legjitime, e cila duhet të jetë e një natyre më konkrete se sa një shpresë e thjeshtë dhe të bazohet në një dispozitë ligjore ose në një akt juridik, të tillë si vendimi gjyqësor (shih *Kopecky k. Sllovakisë* [GC], nr. 44912/98, §49, GJEDNJ 2004-IX; dhe *Gratzinger dhe Gretzingerova kundër Republikës Çeke* (vendimi), nr. 39794/98, §73, GJEDNJ 2002-VII). Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se, për momentin, kërkuësit nuk kanë treguar se ata kanë pasur një kërkesë, e cila ishte vërtetuar mjaftueshëm për t’u zbatuar dhe për këtë arsye ata nuk mund të argumentojnë se kanë pasur një “posedim” brenda kuptimit të nenit 1, të protokollit nr. 1. Nga kjo rrjedh se ky ankim është i papajtueshëm *ratione materiae* me dispozitat e Konventës brenda kuptimit të nenit 35§3 dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§4 të Konventës.

D. Shkelje të tjera të pretenduara të Konventës

27. Duke pasur parasysh të gjithë materialin në zotërim të saj dhe për aq sa ankimet i përkasin kompetencës së saj, Gjykata konstaton se ankimet sipas nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me një shkelje të pretenduar të së drejtës së kërkuësit për të pasur akses në gjykatë dhe, sipas nenit 14 të Konventës (shih paragrafët 10 dhe 11 më lart), nuk paraqesin asnjë shfaqje të shkeljes së të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë ose në protokollet e saj. Nga kjo rrjedh se kjo pjesë e kërkesës duhet të rrëzohet si e pabazuar, në përputhje me nenin 35§§3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht:

Vendos të bashkojë kërkesat;

Vendos të heqë pjesën e kërkesës nr. 78958/11 lidhur me vendimin nr. 251, datë 21 gusht 2008 nga lista e çështjeve të saj;

Deklaron pjesën e mbetur të kërkesave të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 1 tetor 2020.

Hasan Bakırcı
ZËVENDËSSEKRETAR

Egidijus Kūris
KRYETAR



SHTOJCË

Nr.	Nr. i kërkesës dhe data e regjistrimit	Emri i plotë i kërkuarit	Data e komunikimit/nenet	Përshkrimi i vendimeve të formës së prerë të marra në vend	Detajet e zbatimit	Emri i përfaqësuesit
1	13618/10 Depozituar më 8.3.2010	Mihallaq Gjergo Athina Gjergo Jorgjie Gjokopulli née Gjergo Elvira Babichenko née Gjergo	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimet nr. 34 dhe 35, të datës 10 korrik 2007, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Vlorës (Komisioni) njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 25,200 metra katrorësh, për të cilat do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) ka kryer vlerësimin financiar për çdo vendim.	Artan Hajdari
2	36482/10 Depozituar më 20.5.2010	Donard Strazimiri Indrit Strazimiri Bedrie Florini née fortuzi Bledar Florini Alma Hyka née Fortuzi Fisnik Preza Dhurata Karajani née Fortuzi Fatbardha Agushi née Fortuzi Aferdita Husha née Fortuzi Fatri Llagami ⁸ Bujar Llagami ⁹ Vera Panariti ¹⁰ Miranda Nosi Dashuri Llagami Denis Llagami Helidon Llagami Mysin Pilku Lira Kasharaj Nimet Pilku Niada Shima	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 419, të datës 9 nëntor 2000, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 41,618 metra katrorësh, nga të cilat 6,055 metra katrorë iu kthyen dhe pjesa e mbetur prej 35,563 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Ajo, gjithashtu, njohu të drejtën e kërkuarve për parablerjen e disa ndërtesave në rast privatizimi.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim. ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të sipërfaqes së zënë nga ndërtesat, pasi kërkuarët nuk kanë hequr dorë nga e drejta e parablerjes.	Artan Hajdari

⁸ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Bedar Llagami dhe Etleva Llagami.

⁹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Fatbardha Llagami, Diana Dhamo dhe Aferdita Shehu.

¹⁰ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Qamil Panariti, Suzana Haveri.



		Floran Pillu Hamijet Zogolli Gojar Dishnica Rebeka Verdha née Dishnica Bardhyl Zogolli Nazime Zogolli Adrian Zogolli Hasan Zogolli Mybara Zogolli Erjon Zogolli Helga Zogolli Luan Fortuzi Arben Fortuzi Avni Fortuzi Miranda Fortuzi Eva shehaj née Fortuzi Zana Fortuzi Fisnik Fortuzi Astrit Fortuzi Liri Fortuzi Enri Laku Ilir Laku Ariana Laku Artan Fortuzi Sokol Fortuzi Ballkez Fortuzi ¹¹ Sokol Fortuzi				
3	37381/10 Depozituar më 21.10.2010	Gezim Shehi Makbule Cene Lirie Meca Shpresa Hysaj Bardha Shehi Myhyrije Shehi Adrian Shehi Haki Shehi	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1055, të datës 24 qershor 2003, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 34,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Spiro Dodbiba
4	41859/10	Eqerem Risilia	20.12.2013	Me vendimin nr. 116, të datës 19 nëntor 1996, Komisioni i Vlorës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar	Palët nuk kanë dhënë ndonjë informacion në lidhje me kryerjen e	Spiro Dodbiba

¹¹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtari i saj: Sokol Fortuzi.



	Depozituar më 23.10.2010		Nenet 6§1 dhe 13 dhe neni 1, i protokollit nr. 1	prej 11,400 metra katrorësh, nga të cilat 10,000 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 14, të datës 14 mars 2000, Komisioni i Vlorës njohu të drejtat e kërkuarit për pronën e trashëguar prej 20,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	vlerësimit financiar të vendimit. ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	
5	48830/10 Depozituar më 19.7.2010	Agim Toro Ervehe Ceribashi Lindita Kapaj-Toro	26/05/2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 321, të datës 16 maj, Komisioni i Gjykostrës njohu të drejtat e kërkuarit për pronën e trashëguar prej 17,062 metra katrorësh, nga të cilat 10,000 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 7.062 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Qeveria parashtoi se vendimi nr. 937 i Gjykatës së Rrethit Gjykostrës, datë 29 maj 2008, kishte vendosur të anulonte të drejtat pronësore të kërkuarit për 1,260 metra katrorësh, pasi ato mbivendoseshin me të drejtat pronësore të një pale të tretë.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të vendimit, vendosi që kërkuarit të konsiderohen të kompensuar. Qeveria më tej parashtoi se, krahas një ankimi të depozituar nga kërkuarit kundër vendimit të ATP-së, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nr. 187, i datës 14 nëntor 2018, kishte vendosur që t'ua kthente ankimin kërkuarit për korrigjim. Deri më sot, kërkuarit nuk kanë dhënë ndonjë informacion përkatës të përditësuar në përgjigje të këtij vendimi.	Spiro Dodbiba
			Neni 6§1 (aksesi në gjykatë)	Me vendimin nr. 174, të datës 5 maj 2009, Gjykata e Lartë shpalli veprimin civil të kërkuarit kundër një vendimi të Komisionit, i cili kishte njohur të drejtat pronësore të një pale të tretë, jashtë juridiksionit të gjykatave të zakonshme, për shkak të mosparaqitjes nga ana e kërkuarit të një ankese administrative në atë kohë në Agjencinë Qendrore për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave¹² (Agjencia Qendrore), drejtori i së cilës kishte kompetencën për të rishikuar vendimin e Komisionit. Më 6 shtator 2009, pas ankesës së mëvonshme të kërkuarit më 16 korrik 2009, drejtori i Agjencisë Qendrore i informoi ata se kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit pas mbarimit të afatit ligjor për të bërë një ankesë. Më 13 korrik 2010, pas ankesës së re të kërkuarit më 11 shkurt 2010, drejtori i Agjencisë Qendrore i informoi ata se,	Nuk ka informacione të disponueshme që, pas letrës së drejtorit të datës 13 korrik 2010, kërkuarit e ndoqën çështjen përpara gjykatave vendëse.	

¹² Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (Agjencia) zëvendësoi Komisionin në vitin 2006.



				në funksion të vendimit nr. 27 të Gjykatës Kushtetuese më 26 maj 2010, i cili kishte deklaruar jokushtetuese kompetencat e tij për të rishikuar vendimin e Komisionit, ankesa e tyre nuk mund t'i nënshtrohej shqyrtimit administrativ.		
6	56958/10 Depozituar më 27.9.2010	Klerenti Dume Bedri Fesko Zana Dume Ilirdume Agim Dume Vladimir Dume Ermira Dume Nuri Dume Vjollca Dume Svjetllana Dume Besa Dume Fatbardha Dume Teuta Matua Gramoz Mborja Donika Mborja née Dajlani	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 169, të datës 1 shkurt 1996, Komisioni i Ersekës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 3,561 metra katrorësh, nga të cilat 1,529 metra katrorë u kthyen dhe 1,057 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Ai, gjithashtu, njohu të drejtën e kërkuarve për parablerjen e një ndërtese.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dy vendimeve, vendosi që kërkuarët të konsiderohen të kompenzuar.	Artan Hajdari
7	60264/10 Depozituar më 27.9.2010	Agron Skenderi Bashkim Kaca	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 67 të datës 21 tetor 1999, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 7,000 metra katrorësh, nga të cilat 1,164 metra katrorë u kthyen dhe 5,281 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Asnjë kompensim nuk është bërë në lidhje me 555 metra katrorë, të cilët ishin zënë nga godina të ndërtuara në mënyrë të paligjshme; ata që i kishin zënë u udhëzuan që t'u paguanin qira kërkuarve. Komisioni, gjithashtu, njohu të drejtën e kërkuarve për parablerjen e një ndërtese që zinte 2.736 metra katrorë.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuarët të konsiderohen të kompenzuar.	Gentiana Tirana
8	4899/11 Depozituar më 24.12.2010	Fadil Omari Liri Maci	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 394, të datës 23 shtator 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 162 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Artan Hajdari
9	4901/11 Depozituar më 24.12.2010	Elvana Samarxhija née Cepunja	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 255, të datës 3 tetor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 416.5 metra katrorësh, nga të cilat 30 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 386.5 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Artan Hajdari



10	11321/11 Depozituar më 15.11.2010	Refat Puto ¹³	25.4.2016	Me vendimin nr. 195 të datës 8 janar 1996, Komisioni i Pronave Sarandë pranoi që babai i kërkuetit kishte pasur në pronësi një pjesë, përkatësisht një të tetën, të një kullote me përmasa 1,000,000 metra katrorë, me vendndodhje në Lëkurës (kullota e parë) dhe të një kullore tjetër me përmasa 3,500,000 metra katrorë me vendndodhje në Berdenesh (kullota e dytë). Meqenëse kullota e parë dhe vetëm 225,000 metra katrorë nga kullota e dytë rezultuan <i>infra mums</i> , Komisioni njohu pjesën e trashëguar të kërkuetit në të dyja kullotat me një total prej 152,000 metra katrorësh nga të cilat 4,642 metra katrorë u kthyen. 1.098 metra katrorë që janë kthyer tashmë me anë të dy vendimeve të mëparshme të dhëna në vitin 1994 dhe në vitin 1995 dhe pjesa e mbetur prej 146,260 metra katrorësh do të kompensoheshin në natyrë dhe me anë të obligacioneve. Gjithashtu, u njoh e drejta e kërkuetit për parablerjen e një ndërtese që zë 960 metra katrorë (shih, gjithashtu, kërkesën nr. 13258/11 më poshtë)	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuetit të konsiderohen të kompensuar.	Sokol Puto
			Neni 6§1 (aksesi në gjykatë)	Duke u bazuar në materialet në dosjen e çështjes, del se në mars 1997, kërkueti paraqiti një kërkesë pranë Komisionit të atëhershëm për t'i kthyer atij pjesën e mbetur të kullotës së dytë. Si rezultat, me vendimin nr. 257, datë 10 korrik 2008, Agjencia e Pronave të Vlorës njohu titullin e trashëguar të kërkuetit për një shtesë prej 121.200 metra katrorësh, që i përkisnin kullotës së dytë, nga të cilat 119,350 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 1.850 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Kërkueti apeloj tek Agjencia Qendrore në Tiranë. Në të njëjtën kohë, më 25 shkurt 2010, Agjencia Qendrore e informoi aplikantin se, pas shpërbërjes së zyrave vendore, kërkesa që ai kishte paraqitur në vitin 1997 do të shqyrtohej nga Agjencia Qendrore. Në vitin 2013 Agjencia Qendrore deklaroi ankimin e kërkuetit kundër vendimit nr. 257/2008 jashtë juridiksionit në funksion të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, që kishte shfuqizuar kompetencat e drejtorit të saj për të rishikuar vendimet e dhëna nga zyrat vendore të Agjencisë.	Pas hyrjes në fuqi të ligjit për pronat të vitit 2015, nuk duket se aplikanti ka depozituar padi të re pranë ATP-së ose në gjykatat vendëse për njohjen e të drejtave të trashëguara për tokën e mbetur të kullotës së dytë.	
11	11489/11	Gurije Dvorani Née	20.12.2013	Me vendimin nr. 1024, të datës 30 qershor 2009, Agjencia e	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar	Artan Hajdari

¹³ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Ermira Allabashi Arapi, Roza Allabashi, Ledia Hobdari dhe Bersant Hobdari.



	Depozituar më 16.2.2011	Starova14 Shpetim Dvorani Svjetllana Dume Besa Dume Fatbardha Dume Valter Mborja Pranvera Bejleri née Mborja Diana Qyteti née Mborja	Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Korçës njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 11.000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	për këtë vendim.	
12	13258/11 Depozituar më 29.12.2010	Zamir Myftiu Adile Kondi née Puto Arben Puto Bleriana Myftiu Beatty	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 196 të datës 8 janar 1996 Komisioni i Sarandës njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 152,000 metra katrorësh, nga të cilat 7,942 metra katrorë u kthyen, 1,098 metra katrorë ishin kthyer tashmë me anë të dy vendimeve të mëparshme të dhëna në vitin 1994 dhe në vitin 1995 dhe pjesa e mbetur prej 142,960 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Gjithashtu, u njoh e drejta e kërkuësit për parablerjen e një ndërtese që zë 960 metra katrorë.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Sokol Puto
13	28124/11 Depozituar më 5.2.2011	Naim Frasheri Feride Komnino Lejda Frasheri Enrik Bregasi Brunilda Castelluchio Manuel Komnino	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 75, të datës 27 qershor 2002, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 1,100 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Artan Hajdari Mirko Walbach
14	28137/11 Depozituar më 5.2.2011	Shefqet Tigani Feim Tigani Drita Boshnjaku (Tigani) Muhamet Tigani Sylejman Tigani Fatlum Domniku Burim Domniku Laura Dranqolli née Domniku Lendita Radoni née Domniku Bekim Domniku Ardita Dobroshi née	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 80, të datës 30 maj 1995, Komisioni i Vlorës njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 40,000 metra katrorësh, nga të cilat 2,664 metra katrorë u kthyen dhe 20,000 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Artan Hajdari

¹⁴ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Lejla (AGO) Belli.



	Domniku Gjemajlije Mulhaxha née Domniku Besnik Domniku Besim Tigani Hajrije Tigani Gentiana Tigani Aulona Tigani Granit Tigani Lorik Tigani Ibrahim Tigani Atifete Tigani Arjeta (Tigani) Hoti Armend Tigani Antigona Kabashi née Tigani Agron Tigani Servete Tigani Nurco Muratoviq Ahmet Muratoviq Fikreta Muratoviq Mersija Muratoviq Femi Tigani Demir Tigani Magdalena Tigani ¹⁵ Millka Tigani Bujar Tigani Suzana Tigani Merita Tigani Sabahat Gorani Nasire Gorani Nevzat Gorani ¹⁶ Arbnor Gorani Alush Tigani				
--	--	--	--	--	--

¹⁵ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Femi Tigani dhe Demir Tigani.

¹⁶ Nevzat Gorani ndërroi jetë pas depozitimit të kërkesës në gjykatë, por kërkuessit nuk mund të paraqisnin një certifikatë trashëgimie në kohë për kërkesat JS, por rezervojnë të drejtën për të dorëzuar certifikatën dhe për ta dërguar menjëherë në gjykatë.



		Jakute Tigani ¹⁷				
15	29139/11 Depozituar më 1.4.2011	Ardian Maci Maksim Lesko Hatlije Llagami ¹⁸ Skender Bylyku Gezim Maci ¹⁹ Mahmudije Golia ²⁰	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1018, të datës 24 mars 2003, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 46,000 metra katrorësh dhe për 130 pemë ulliri, vlera totale e të cilave u përcaktua në 675,200 lekë (5,367 euro). Kërkuessit do të kompensoheshin me anë të obligacioneve.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Elton Gongo
16	33144/11 Depozituar më 10.5.2011	Preng Tosku ²¹	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 111, të datës 27 dhjetor 1998, Komisioni i Matit njohu të drejtat e kërkuessit për pronën e trashëguar prej 96.823 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Xhevdet Sheta
17	46474/11 Depozituar më 18.7.2011	Ljulzim Jajaga Sadulla Kerliku	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 412, të datës 7 nëntor 2000, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 11,816 metra katrorësh, nga të cilat 10,118 metra katrorë u kthyen ose kompensuan dhe 635 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyjs vendimeve, vendosi që kërkuessit të konsiderohen të kompensuar.	Elton Gongo
18	78958/11 Depozituar më 12.12.2011	Mirvet Petrela Albi Petrela Genci Petrela Miranda Petrela née Bakiri	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 205, të datës 5 gusht 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 1,278.4 metra katrorësh, nga të cilat 1,036 metra katrorë u kthyen dhe 232 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Gjithashtu, ai njohu të drejtën e kërkuessit për parablerjen e një ndërtese që zë 144 metra katrorë, e cila ndodhet në sipërfaqen që do të kompensohet.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, në lidhje me 88 metra katrorë. Sidoqoftë, nuk ka përcaktuar vlerësimin financiar për pjesën e mbetur prej 144 metra katrorësh, meqenëse kërkuessit nuk kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.	Aida Prifti
				Me vendimin nr. 78, të datës 14 prill 2008, Agjencia e Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 21.2 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	

¹⁷ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Valbona Baqaj, Vjollca Rexhepi dhe Flutura Sokoli.

¹⁸ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Shpetim Llagami, Eshref Llagami, Blend Llagami, Ismail Llagami, Apostolia Llagami, Marcio Llagami dhe Ana Llagami.

¹⁹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Adem Maci dhe Ondina Karabeci.

²⁰ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Hajten Meta, Fatmir Golia. Edmond Golia dhe Alben Golia.

²¹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Viktor Tosku, Bardhe Tosku, Kol Tosku dhe Rexhina Tosku, më 28 gusht 2014, z. Zef Tosku, z. Edmir Merlika, znj. Eva Tosku, z. Vili Tosku, znj. Angela Saal, znj. Kristina Tosku dhe znj. Gjele Tosku shprehën dëshirën e tyre për t'u bashkuar në kërkesë, për shkak se ata janë trashëgimtarë të së njëjtës sipërfaqe toke.



				Me vendimin nr. 251, të datës 21 gusht 2008, Agjencia e Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 28,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Del se ky vendim më pas është prishur ndërsa procedurat po vazhdonin	Më 28 shtator 2016, kërkuessit shprehën dëshirën e tyre për të tërhequr ankimet e tyre në lidhje me këtë vendim.	
19	6312/12 Depozituar më 26.1.2012	Sabri Jella ²² Zana Jella Ema Jella Hasan Jella ²³ Eleen Jella (Yella) Bernice Jella (Yella) Mary (Jella) Mc Dermott	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 249, të datës 1 shtator 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 99 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto
20	9217/12 Depozituar më 26.1.2012	Sabri Jella ²⁴ Zana Jella Enia Jella Hasan Jella ²⁵ Hysni Jella Eleen Jella Bernice Jella Mary (Yella) Mcdermott	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 200, të datës 6 qershor 1997, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 15,500 metra katrorësh, nga të cilat 3,160 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 12,340 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto
21	9218/12 Depozituar më 26.1.2012	Sabri Jella ²⁶ Zana Jella Ema Jella	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 82, të datës 1 dhjetor 1999, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 303 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol PUTO
22	11629/12 Depozituar më 26.1.2012	Zana Jella Sabri Jella ²⁷ Ema Jella Hasan Jella ²⁸ Eleen Jella	22/09/2014 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 516, të datës 9 prill 1996, Komisioni i Tiranës njohu të drejtën e kërkuessve për kompensim në lidhje me dy sipërfaqe toke, përkatësisht 177 5 metra katrorë dhe 238.6 metra katrorë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto

²² Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Halit Jella, Gazmend Jella, Adela Jella dhe Hans Jella.

²³ Ka ndërruar jetë.

²⁴ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Halit Jella, Gazmend Jella, Adela Jella dhe Hans Jella.

²⁵ Ka ndërruar jetë.

²⁶ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët et ij: Halit Jella, Gazmend Jella, Adela Jella dhe Hans Jella.

²⁷ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Halit Jella, Gazmend Jella, Adela Jella dhe Hans Jella.

²⁸ Ka ndërruar jetë.



		Bernice Jella Hysni Jella (Karapici) Mary (Yella) Mc Dermott				
23	21447/12 Depozituar më 28.3.2012	Dhimitraq Eqimijatru Kleri Cika ²⁹ Gabriel Eqimijatru Petri Eqimijatru	22.9.2014 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 633, të datës 22 prill 2002, Gjykata e Rrethit Durrës, pasi kishte ndryshuar vendimin nr. 1424 të Komisionit, datë 1 qershor 1996, njohu të drejtën e kërkuësve për kompensim në lidhje me 5.000 metra katrorë.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Petrika Demiri
24	21527/12 Depozituar më 12.3.2012	Julian Benusi Valeria Benusi Anton Benusi	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 140, të datës 20 korrik 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 1,217.35 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Më tej, ajo njohu të drejtën e kërkuësve për parablerjen e godinave të ndërtuara aty.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të tokës së zënë nga ndërtesa pasi kërkuësit nuk kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.	Sokol Puto
25	21529/12 Depozituar më 12.3.2012	Valeria Vrioni Gherardo La Franceska Oliver Vrioni Dario La Franceska	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Kjo kërkesë, e cila është një vazhdim i vendimit të kësaj Gjykate në çështjen <i>Vrioni dhe të tjerët k. Shqipërisë</i> ((vetëm plotësim), nr. 35720/04 dhe 42832/06, 7 dhjetor 2010) në të cilin Gjykata dha kompensim në lidhje me një sipërfaqe toke që zë 1,456 metra katrorë, lidhet me mospagimin nga ana e autoriteteve të kompensimit të kërkuësve në lidhje me 181 metra katrorë të mbetur. Autoritetet më tej njohën të drejtën e kërkuësve për parablerjen e disa godinave të ndërtuara aty.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të tokës së zënë nga ndërtesa, pasi kërkuësit nuk kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.	Sokol Puto
26	21532/12 Depozituar më 12.3.2012	Oliver Vrioni	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 230, të datës 31 mars 2006, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 837 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto
27	21599/12 Depozituar më 12.3.2012	Oliver Vrioni Valeria Vrioni Gherardo La Franceska Dario La Franceska Nevin Godo Vrioni Age Vrioni Alan Vrioni	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 448, të datës 10 maj 1996, Komisioni i Beratit njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 12,915 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Sokol Puto
28	21675/12	Orhan POJANI	25.3.2015	Me vendimin nr. 960, të datës 1 prill 1996, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Spiro Dodbiba

²⁹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Nikolla Cika, Leonard Cika dhe Robert Cika.



	Depozituar më 18.12.2012		Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	prej 1,100 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Në vitin 2006 kërkuesi mori kompensim financiar për 200 metra katrorë. Me vendimin nr. 323, të datës 30 qershor 2006, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuetit për pronën e trashëguar prej 409.04 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.		
29	30941/12 Depozituar më 28.12.2012	Lavdiqe Kalasa (Pojani)	25.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 265, të datës 5 maj 1994, Komisioni i Korçës njohu të drejtat e kërkuetit për pronën e trashëguar prej 1.587 metra katrorësh, e cila do të kompensohej me anë të obligacioneve. Në vitin 2009 kërkuesi mori kompensim financiar për 200 metra katrorë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Spiro Dodbiba
30	30942/12 Depozituar më 26.4.2012	Mit'hat Gega Jari Demishaga Ibrahim Demishaga Qazim Demishaga Pellumb Demishaga Ermila Demishaga Bedri Elezaj ³⁰ Fatbardha Dervishi Pranvera Rexho Vjosa Luto Edmond Gega	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 992, të datës 2 qershor 2009, Agjencia e Korçës njohu të drejtat e kërkuetit për pronën e trashëguar prej 333.3 hektarësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	Nga vëzhgimet e palëve del se vendimi u anulua më pas. Procedura ka mbetur pezull përpara Gjykatës së Lartë.	Mit'hat Gega
31	33619/12 Depozituar më 15.5.2012	Andon Melo Reno Melo	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 357, të datës 19 shtator 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuetit për pronën e trashëguar prej 800 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Në vitin 2006 kërkuetit morën kompensim financiar për 200 metra katrorë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto
32	45721/12 Depozituar më 13.6.2012	Grigor rexho	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 927, të datës 3 maj 1996, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuetit për pronën e trashëguar prej 5,271 metra katrorësh, nga të cilat 3,509 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Komisioni udhëzoi kërkuetin të fillojë procedurat gjyqësore në lidhje me 1,514 metra katrorë, të cilat i ishin kthyer padrejtësisht një pale të tretë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Kosta Gazeli

³⁰ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Flutura Elezaj, Dorian Elezaj dhe Ina Elezaj.



33	47797/12 Depozituar më 29.7.2012	Kostaq Sahatci ³¹ Alberto Laca Laura Laca Antigoni Hoxha Dhoksi Sahatci Klajdi Sahatci Aurora Sahatci	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 645, të datës 17 janar 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 1,100 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Në vitin 2007 kërkuessit morën kompensim financiar për 200 metra katrorë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Doris Andoni
34	47807/12 Depozituar më 27.7.2012	Emilia Sahatci née Kondi Luiza Dhama née Kondi	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 54, të datës 29 maj 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 1,100 metra katrorësh, nga të cilat 235 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 865 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Ai, gjithashtu, njohu të drejtën e kërkuessve për parablerjen e një ndërtese që ndodhet në zonën që do të kompensohet.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të tokës së zënë nga ndërtesa, pasi kërkuessit nuk kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.	Doris Andoni
35	47825/12 Depozituar më 26.7.2012	Liri née Myrteza Rexhep Myrteza Enver Dibra Ylli Dibra Adrian Voilla Edlena Ahmetaj née Voilla Xhoana Myslim (Dibra) Enton Dibra Fatime Dibra Kozma Voilla ³²	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1, të datës 29 tetor 2001, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 61,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Artan Hajdari
36	48173/12 Depozituar më 12.7.2012	Klaudio Ligori ³³	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 601, të datës 1 dhjetor 1998, Komisioni i Gjirokastrës njohu të drejtat e kërkuessit për pronën e trashëguar prej 3,836 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin, me kusht që kërkuessi të mos ketë ushtruar të drejtën e parablerjes për objektin e ndërtuar aty (e cila ju kompensohet ... në rast mosprivatizimi, gjë e cila mbështetet ... për të drejtën e parablerjes).	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të tokës së zënë nga ndërtesa, pasi kërkuessi nuk ka hequr dorë nga e drejta e tij e parablerjes.	
37	48401/12 Depozituar më	Hyrije Derhemi née Duka Arsed Bodinaku Liljana Liku Née Mezini	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe	Me vendimin nr. 90, të datës 17 korrik 1997, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 4.500 metra katrorësh, nga të cilat 839 metra katrorë u	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuessit të	Suela Meneri

³¹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Etleva Sahatci, Emilia Sahatci dhe Doris Andoni née Sahatci.

³² Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Adria Voilla dhe Edlena Ajmetaj (Voilla).

³³ Më 15 gusht 2014, kërkuessi kërkoi që vëllai i tij të bashkohej me procedurat e mbetura pezull në Gjykatë.



	26.7.2012	Nazmi Derhemi Ardjan Derhemi Lirie Derhemi Besnike Ndoni Semiha Lluqi née Derhemi Qamile Llaci ³⁴ née Derhemi Bedrije Lici Iglimona Kalaja (Derhemi) Ridian Derhemi	13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	kthyen dhe pjesa e mbetur prej 3,661 metra katrorësh do të kompensohej. Ai, gjithashtu, njohu të drejtën e parablerjes së objekteve të ndërtuara në zonën që do të kompensohet. Me vendimin nr. 241, të datës 13 korrik 2000, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 3,000 metra katrorësh, nga të cilat 1,865 metra katrorë u kthyen dhe 955 metra katrorë do të kompensoheshin. Ai, gjithashtu, njohu të drejtën e parablerjes së objekteve të ndërtuara në zonën që do të kompensohet.	konsiderohen të kompensuar.	
38	50791/12 Depozituar më 25.7.2012	Jorgji Stavri Maksim Sinemati Gezim Sinemati	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1602, të datës 25 shtator 1996, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 73,000 metra katrorësh, nga të cilat 10,000 metra katrorë u kompensuan në natyrë (me vendim nr. 72, datë 29 janar 1997) dhe 6,300 metra katrorë (10% e pjesës së mbetur prej 63.000 metra katrorësh) do të kompensoheshin me anë të obligacioneve.	ATP-ja ka vendosur që të mos përcaktojë vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Artan Hajdari
39	53998/12 Depozituar më 16.8.2012	Ajet Shembitraku	22.4.2016 Nenet 6§1 dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1920, të datës 22 tetor 2003, Gjykata e Rrethit të Korçës, pasi ndryshoi vendimin nr. 49, të datës 10 dhjetor 1993 (vendimi i parë), dhe vendimin nr. 163, të datës 22 prill 1994 (vendimi i dytë), të Komisionit, njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 2,126 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Ajo, gjithashtu, njohu të drejtën e parablerjes së objekteve të ndërtuara aty.	Qeveria parashtroi se ATP-ja kishte kryer vlerësimin financiar të vendimit të parë. Sidoqoftë, zona për të cilën ishte njohur e drejta e parablerjes nuk iu nënshtrua një vlerësimi financiar, pasi kërkuar nuk hoqi dorë nga kjo e drejtë. Për sa i përket vendimit të dytë, ATP-ja ka vendosur që kërkuar të konsiderohen të kompensuar.	Anesti Shembitraku
40	54729/12 Depozituar më 8.5.2012	Petraç Nishe Irinë Shkurti née Nishe Ilia Çili Margarita Tola née Çili Sotir Çili	22.9.2014 Nenet 6§1 dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 2772, të datës 19 nëntor 1997, Gjykata e Apelit e Tiranës, pasi ndryshoi vendimin nr. 851, datë 18 shtator 1996, të Gjykatës së Rrethit të Devollit, njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 510 metra katrorësh, nga të cilat 50 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 460 metra katrorësh do të kompensohej në natyrë dhe me anë të obligacioneve.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Spiro Dodbiba
41	65797/12	Sherjar Vaqari Gazmend Bakiu	31.1.2015	Me vendimin nr. 83, të datës 5 qershor, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej	ATP-ja ka vendosur që të mos përcaktojë vlerësimin financiar të	Sokol Puto

³⁴ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Ilir Llaci, Kosta Llaci, Nexhmi Llaci dhe Ruzhdi Llaci.



	Depozituar më 21.9.2012	Ida Peni ³⁵	Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	70,000 metra katrorësh, nga të cilat 10.000 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 60,000 metra katrorësh do të kompensohej me anë të obligacioneve. Me vendimin nr. 1014, të datës 24 mars 2003, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 193,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej me anë të obligacioneve në vlerën prej 3,067.200 lekësh (24,432 euro).	vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes. ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	
42	74866/12 Depozituar më 31.10.2012	Fatmir Majuni	12/03/2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me një vendim të datës 29 gusht 1995, Gjykata e Rrethit Durrës, duke ndryshuar vendimin nr. 683 të Komisionit datë 17 Nëntor 1994 njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 500 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Redi Petushi
43	74867/12 Depozituar më 1.10.2012	Dhimitraq Eqimijatru Kleri Cika ³⁶ Gabriel Eqimijatru Petri Eqimijatru	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 148, të datës 27 korrik 2006 (vendimi i dytë), Komisioni i Korçës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 7,292 metra katrorësh, nga të cilat 6,750 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Kërkuessve iu kthyen 11,728 metra katrorë nga Gjykata e Apelit e Korçës me vendimin nr. 141, të datës 21 maj 1999, i cili ndryshoi vendimin nr. 1292 të Komisionit të datës 22 dhjetor 1995 (vendimi i parë).	Qeveria, duke konsideruar që zona për t'u kompensuar me anë të vendimit të dytë ishte pjesë e pronës së njohur me anë të vendimit të parë, parashtroi se ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar.	Petrika Demiri
44	4692/13 Depozituar më 17.9.2012	Zamira Marku née Daja	25.3.2015 Nenet 6§1 dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 113, të datës 12 qershor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 441 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, në lidhje me të cilin ka mbetur pezull kërkesa për zbatim e kërkuessit.	Xhevdet Sheta
45	64182/13 Depozituar më 3.10.2013	Dashamir Luga ³⁷ Sanije Hyskaj Hysen Tepelena Gezim Luga Hajrie Nallbani Hysen Luga Jusuf Fani	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1083, të datës 31 tetor 1995 Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 43,000 metra katrorësh, nga të cilat 10,000 u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 33,000 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka vendosur që të mos përcaktojë vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Ledio Milkani

³⁵ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Fation Peni dhe Musa Peni.

³⁶ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Nikolla Cika, Leornard Cika dhe Robert Cika.

³⁷ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Mehriban Luga, Edlira Luga dhe Gentian Luga.



		Prandvera Kalaci ³⁸ née Luga Dilaver Tepelena				
46	26412/14 Depozituar më 6.8.2014	Ymer Gega	25.4.2016 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 128/1, të datës 25 korrik 1996, Komisioni i Gjirokastrës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 39,000 metra katrorësh, nga të cilat 20,000 metra katrorë u kthyen dhe 510 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Gjithashtu, ai njohu të drejtën e kërkuessit për parablerjen e godinave që zënë 5,590 metra katrorë, nga të cilat 3,025 metra katrorë u transferuan në pronësi të kompanisë së shpërndarjes së energjisë elektrike në vijim të privatizimit të kompanisë kombëtare për furnizimin me energji elektrike.	ATP-ja ka vendosur që të mos përcaktojë vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Avni Shehu
47	30096/14 Depozituar më 9.6.2014	Kujtim Spahiu Lumnan Spahiu Saniye Bilalaj née Spahiu Manushaqe Mena née Spahiu Bukurije Gjoka née Spahiu Sose Kastrati née Spahiu Nuhi Spahiu Kahit Spahiu Fllanza Cengu née Spahiu	31.1/.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 38, të datës 20 shkurt 1998, Komisioni i Kukësit njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 92,649 metra katrorësh, nga të cilat 76,000 metra katrorë do të kompensoheshin me anë të obligacioneve në vlerën prej 2,239.542.3 lekësh (17.845 euro).	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Ardian Spahiu
48	39836/14 Depozituar më 8.8.2014	Ylvije Pinari	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 211. të datës 7 korrik 1995. Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 1,658 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim, në lidhje me të cilin kërkesa për zbatim e kërkuessit ka mbetur pezull, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Xhevdet Sheta
49	44461/14 Depozituar më 26.7.2014	Liri Kaba	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 66, të datës 28 dhjetor 1994, Komisioni i Vlorës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 7,200 metra katrorësh, nga të cilat 5,000 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit brenda afatit trevjeçar të përcaktuar nga ligji për pronat e vitit 2015.	Agim Toro
50	48714/14 Depozituar më	Abdulla Kasmi	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe	Me vendimin nr. 1, të datës 20 prill 2007, Agjencia e Durrësit njohu të drejtat e kërkuessit për pronën e trashëguar prej 160,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Adi Brovina

³⁸ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Mirvana Kadiu, Arben Kalaci, Lauresha Kapidani dhe Amela Lila.



	24.6.2014		13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	përputhje me ligjin.		
51	55175/14 Depozituar më 18.7.2014	Ali Arbana ³⁹	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 81, të 24 qershorit 2002, Komisioni i Tiranës, në plotësim të vendimit nr. 367, të datës 25 prill 1994, dhe të vendimit nr. 526, të datës 22 prill 1996, të Komisionit, njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 8.207 metra katrorësh, nga të cilat 7,999 metra katrorësh do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Në vitin 2013 kërkuarshi mori kompensim financiar për 500 metra katrorë.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Xhevdet Sheta
52	57161/14 Depozituar më 31.10.2014	Ferit Llagami Nusret Llagami Razije Manhasa Nezahet Hoxha Bukurije Gjonaj Emine Themeli Liliana Llagami Altin Llagami Letfije Llagami Indrin Llagami Andri Llagami	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 120, të datës 27 gusht 2002, Komisioni i Tiranës, duke ndryshuar vendimet e tij nr. 586, të datës 29 korrik 1994, dhe nr. 317, të datës 16 shtator 2000, njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 48,753 metra katrorësh, nga të cilat 29,768.5 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuarshi të konsiderohen të kompensuar.	Xhevdet Sheta
53	57229/14 Depozituar më 24.7.2014	Egon Gjadri ⁴⁰ Lejla Muça	28.1/2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 18, të datës 27 dhjetor 2005, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 80,000 metra katrorësh, nga të cilat 3.786 u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 76,214 metra katrorësh do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 19, të datës 27 dhjetor 2005, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 75,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 20, të datës 27 dhjetor 2005, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 60,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për çdo vendim.	Viktor Gum1

³⁹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Lirije Arbana, Evis Bajo dhe Valbona Dajzmaili.

⁴⁰ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Ikbale Gjadri dhe Ervin Gjadri.



54	58130/14 Depozituar më 18.8.2014	Ismet Vorpsi Seit Vorpsi Myzejen Erfbara	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1701, të datës 23 nëntor 1996, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 17,000 metra katrorësh nga të cilat 632.5 ishin kthyer me anë të vendimit nr. 1501 të Komisionit, datë 11 korrik 1996, dhe 10,067.5 metra katrorë do të kompensoheshin në natyrë ose me anë të obligacioneve.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Viktor Gumi
55	63020/14 Depozituar më 24.7.2014	Egon Gjadri ⁴¹	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 21, të datës 17 janar 2006, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 203,924 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Viktor Gumi
56	66622/14 Depozituar më 4.12.2014	Ismete Shehi Ermira Shehi Endrit Shehi Eliana Shehi Arkan Shehi	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Kjo kërkesë është depozituar pas komunikimit të kërkesës nr. 37381/10, detajet e së cilës janë dhënë në rreshtin 3 më lart, nga trashëgimtarë shtesë.	Ju lutemi shikoni detajet e dhëna në lidhje me kërkesën nr. 37381/10.	Spiro Dodbiba
57	68195/14 Depozituar më 10.10.2014	Engjellushe Gega née Luli Haxhire Luli Selim Luli Petrut Luli Vjollca Sauku née Luli Flora Foci née Luli Arben Luli	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 2406, të datës 8 nëntor 2013, Gjykata e Apelit Tiranë, ndërkohë që la në fuqi vendimin nr. 916, të Komisionit, datë 26 prill 1996, njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 8,087 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka realizuar vlerësimin financiar, në lidhje me Xhevdet Shetën për çdo vendim, kundër të cilit një ankim i depozituar nga njëri prej kërkuësve ka mbetur pezull në Gjykatën Administrative të Apelit.	Xhevdet Sheta
				Me vendimin nr. 918, të datës 26 prill 1996, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 6,512 5 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuësit të konsiderohen të kompenzuar.	
				Me vendimin nr. 90, të datës 15 dhjetor 1999, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 4.061 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	
58	72752/14 Depozituar më 17.11.2014	Shazivar Karaosmani Anita Alicka Shegushe Kosova	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i	Me vendimin nr. 47, të datës 21 janar 2008, Komisioni i Fierit njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 617,400 metra katrorësh, nga të cilat 360,150 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për Sokol Puton në këtë vendim.	Sokol Puto

⁴¹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Ikbale Gjadri dhe Ervin Gjadri.



59	72770/14 Depozituar më 17.11.2014	Bulcent Tela Anita Alicka Shegushe Kosova Edmond Tela Agron Tela Nesfije Selenica Lavdije Kalasa Teuta Fora Nebi Sefa Hajali Ypi Xhaneta Prodani Suhela Libohova Gjerak Karaiskaj Felatun Karaiskaj Shazivar Kalraosmani	protokollit nr. 1 25.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 2997, të datës 30 qershor 2004, Gjykata e Rrethit Tiranë, duke ndryshuar vendimin nr. 359 të Komisionit, datë 19 shtator 1995, njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar me një sipërfaqe toke 1.110 metra katrorë. Në vitin 2009 kërkuësit morën kompensim financiar për 200 metra katrorë. Me vendimin nr. 207, të datës 1 qershor 2009, Agjencia e Elbasanit njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 154,488 metra katrorësh, nga të cilat 19,479 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 135,009 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar të vendimit. Sidoqoftë, ajo konstatoi se disa pjesë të tokës së kërkuësve mbivendoseshin me ato të njohura në favor të një pale të tretë. Kështu që, ATP-ja ka proceduar në përputhje me seksionin 18, të ligjit për pronat të vitit 2015, në lidhje me tokën e mbivendosur. ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuësit të konsiderohen të kompensuar.	Sokol Puto
60	72779/14 Depozituar më 17.11.2014	Ali Kosova Astrit Permeti Arjan Permeti Aida Podgorica Sokol Kosova Shqipe Kosova Ermira Hydi	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 347, të datës 10 mars 1994, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 5,000 metra katrorësh, nga të cilat 1,000 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 4,000 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 1652/1, të datës 29 tetor 1996, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 3,458 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 1652/3, të datës 29 tetor 1996, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 2.476 metra katrorësh, nga të cilat 223 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 2,253 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 170, të datës 23 qershor 2009, Agjencia e Durrësit, në plotësim të vendimit nr. 1696/1 të Komisionit, datë 23 nëntor 1996, njohu titullin e pronësisë së trashëguar të kërkuësve për një sipërfaqe toke 5,000 metra katrorësh, nga të cilat 3,177.2 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 1,822.8 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 596, të datës 7 dhjetor 2000, Komisioni i	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto



				Durrësit njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 1,600 metra katrorësh, nga të cilat 72 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 1,528 do të kompensohej në përputhje me ligjin.		
				Me vendimin nr. 734, të datës 5 qershor 2003, Komisioni i Pronave në Durrës njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 352 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.		
61	74962/14 Depozituar më 18.11.2014	Sara Myshketa Agron Myshketa Suzana Myshketa Hasan Myshketa Kujtim Myshketa Aishe Shehu Teuta Gjezi (Myshketa) Lejla Kodra (Myshketa) Verusha Kurani (Myshketa) Emine Petrela (Myshketa)	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 849, të datës 27 prill 1995, Komisioni i Durrësit njohu të drejtën e kërkuësve për kompensim për 4.999.5 metra katrorë. Me vendimin nr. 1539, të datës 6 gusht 1996, Komisioni i Durrësit njohu të drejtën e kërkuësve për kompensim për 1,684.5 metra katrorë.	Palët nuk kanë paraqitur ndonjë informacion në lidhje me kryerjen e vlerësimit financiar të secilit prej vendimeve.	Sokol Puto
62	74968/14 Depozituar më 18.11.2014	Sara Myshketa Agron Myshketa Suzana Myshketa Hasan Myshketa Kujtim Myshketa	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 70, të datës 14 prill, Komisioni i Durrësit, në plotësim të vendimit të tij nr. 933, datë 4 korrik 1995, njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 2,825 metra katrorësh, nga të cilat 142 metra katrorë iu kthyen dhe 2,593 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Ai, gjithashtu, njohu të drejtën e tyre të parablerjes së një ndërtese që zë 90 metra katrorë. Me vendimin nr. 441, të datës 9 mars 1999, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 4,250 78 metra katrorësh, nga të cilat 661 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 3,589.78 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuësit të konsiderohen të kompensuar. Kërkuësit kanë apeluar kundër vendimit të ATP-së dhe procedurat duket se kanë mbetur pezull në Gjykatën e Lartë. ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto
63	510/15 Depozituar më	Ilirian Cani Enrieta Vozga née Cani Nadire BACELLI née CANI	12.3.2015 Nenet 6§1 dhe	Me vendimin nr. 1218, të datës 27 nëntor 1996, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 130,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Xhcvdet Sheta



	16.12.2014	Emin Shijaku Myzejen Murthi ⁴² née Cani Haxhi Cani Arben Cani Albana Thodhori née Cani Merita Toska	13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	përputhje me ligjin.		
64	551/15 Depozituar më 6.1.2015	Petro Axha Jolanda Axha Vlash Heba Aurel Heba	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 471, të datës 12 prill 1996, Komisioni i Pronave në Kavajë njohu të drejtën e kërkuësve për kompensim për 1,148 metra katrorë.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit brenda afatit trevjeçar të përcaktuar nga ligji për pronat e vitit 2015.	Sokol Puto
65	3082/15 Depozituar më 30.1.2013	Dhimitraq Eqimijatru Kleri Cika ⁴³ Gabriel Eqimi Jatru Petri Eqimi Jatru	12.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 691/1, të datës 9 tetor 2002, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 58,000 metra katrorësh, nga të cilat 15,800 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka vendosur që të mos përcaktojë vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Petrika Demir1
66	6543/15 Depozituar më 28.1.2015	Aferdita Koxhaj Genc Koxhaj Andrea Koxhaj	12.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1410, të datës 28 maj 1996, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 379 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në natyrë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Dorant Ekmekçiu
				Me vendimin nr. 1712, të datës 28 nëntor 1996, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 51 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në natyrë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar të vendimit. Sidoqoftë, ajo konstatoi se disa pjesë të tokës së kërkuësve mbivendoseshin me ato të njohura në favor të një pale të tretë. Kështu që ATP-ja ka proceduar në përputhje me seksionin 18 të ligjit për pronat të vitit 2015 në lidhje me tokën e mbivendosur.	
67	6613/15 Depozituar më 28.1.2015	Aferdita Koxhaj	12.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 861, të datës 18 nëntor 1994, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 762.56 metra katrorësh nga të cilat 448.3 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Ai njohu të drejtën e saj për parablerjen e disa godinave. Me vendimin nr. 283, të datës 10 tetor 1995, Komisioni i	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për çdo vendim.	Dorant Ekmekçiu

⁴² Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Ismail Murthi dhe Fatlinda Struga.

⁴³ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Nikolla Cika, Leonard Cika dhe Robert Cika.



				Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 1,239 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 449, të datës 19 shkurt 1996, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 396.5 metra katrorësh, nga të cilat 18 metra katrorë iu kthyen dhe pjesa e mbetur prej 378.5 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 188, të datës 31 korrik 1996, Komisioni i Kavajës njohu, ndër të tjera, të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 5,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.		
68	10728/15 Depozituar më 23.2.2015	Elton Lelo Gigi (Haxhire) Lelo Helda Rock (Lelo)	12.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 49, të datës 10 gusht 2007, Agjencia e Vlorës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 14,400 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar të vendimit dhe konstatoi se disa pjesë të tokës së kërkuessve mbivendoseshin me ato të njohura në favor të një pale të tretë. Kështu që, ATP-ja ka proceduar në përputhje me seksionin 18, të ligjit për pronat të vitit 2015, në lidhje me tokën e mbivendosur.	Sokol Puto
69	11214/15 Depozituar më 20.2.2015	Ndricim Dibra Vjollca Mesi Amir D1bra	25.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 807, të datës 13 shkurt 1995, Komisioni i Shkodrës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 10,210 metra katrorësh, nga të cilat 5,805 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 4.405 metra katrorësh do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuessit të konsiderohen të kompensuar.	Avni Shehu
70	12394/15 Depozituar më 6.3.2015	Asllan Picari Xhumaje Hajdari née Picari Ahemal Picari Fatime Aliu née Picari	25.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 153, të datës 28 maj 2009, <i>the Tirana Agency, supplementing the Commission decision no. 35 of 30 mars 1994</i> , njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 41,000 metra katrorë <i>which would be compensated in accordance with the law</i> .	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Besim Peka
71	21648/15 Depozituar më 28.4.2015	Shpresa Kercani Nuri Kercani Luljeta Kercani	25.4.2016 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1255, të datës 20 mars 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 631.5 metra katrorësh nga të cilat 234 sq. m were restored and the remaining 397.5 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 493, të datës 20 nëntor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim. ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyjs vendimeve,	Sokol Puto



				prej 59,500 metra katrorësh, nga të cilat 30,000 metra katrorë <i>were restored and the remaining 29,500 sq. m</i> do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 494, të datës 20 nëntor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 64,500 metra katrorësh, nga të cilat 10.000 metra katrorë u kthyen dhe 29,500 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Ai njohu më tej të drejtën e tyre për parablerjen e objekteve që zënë 25,000 metra katrorë .	vendosi që kërkuarët të konsiderohen të kompensuar.	
72	21704/15 Depozituar më 27.4.2015	Hamid Meneri Tahir Meneri ⁴⁴ Pranvera Reci Aferdita Saraci Luljana Llagam ⁴⁵ Reshat Meneri Luan Meneri Suzana Tafaj Dhurata Reci Ilir Meneri Betina Xhepa	25.4.2016 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Sipas kërkuarve, me vendimin nr. 158, të datës 23 qershor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 713.5 metra katrorësh, nga të cilat 266.1 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 447.4 metra katrorësh do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Ai njohu më tej të drejtën e tyre për parablerjen e disa godinave që ndodhen në zonën që do të kompensohet. Me vendimin nr. 761, të datës 28 shkurt 1996, Komisioni i Tiranës njohu titullin e trashëguar të kërkuarve për 59 metra katrorë, të cilat do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 643, të datës 30 korrik 1996, Komisioni i Tiranës njohu titullin e trashëguar të kërkuarve për 400 metra katrorë, nga të cilat 60 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 340 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Ai njohu më tej të drejtën e tyre për parablerjen e disa godinave që ndodhen në zonën që do të kompensohet.	Vendimi i është nënshtruar vlerësimit financiar, përveç zonës në të cilën ishte njohur e drejta e parablerjes, pasi kërkuarët nuk kanë hequr dorë nga ajo në përputhje me ligjin për pronat. ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim. ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Suela Meneri
73	8789/15 Depozituar më 10.2.2015	Mas-Har Kapidani Isuf Kapidani Meleqe Daja née Kapidani	12.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me tri vendime të ndryshme nr. 2, 3 dhe 4, të datës 20 prill 2007, Agjencia e Durrësit njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 239,000 metra katrorësh do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Xhevdet Sheta
74	70211/13 Depozituar më	Xhemil Gjergji Minerva Kotherja Ferzilet Sakrja	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe	Me vendimin nr. 373/2, të datës 27 korrik 1994, Komisioni i Elbasanit njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 2.490 metra katrorësh e cila do të	ATP-ja ka realizuar vlerësimin financiar të vendimit. Një ankim kundër vendimit të ATP-së,	Endri Kotherja

⁴⁴ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Anila Agaraj Meneri dhe Eneida Janku Meneri.

⁴⁵ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Bledar Llagami dhe Etleva Beliu.



	1.11.2013	Zedlir Bylykbashi Armand Bvlykbashi Myzejen Caku Ermira Garunja	13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	kompensohej në përputhje me ligjin.	depozituar nga njëri prej kërkuesve ka mbetur pezull në Gjykatën Administrative të Apelit.	
75	71730/14 Depozituar më 5.11.2014	Hysni Kotherja Artan Kurti Silvana Dracini Mirela Dracini Minerva Kotherja Hyqmet Kotherja ⁴⁶ Burbuqe Kotherja	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 523/2, të datës 23 shtator 1996, Komisioni i Elbasanit njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 330 metra katrorësh e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka realizuar vlerësimin financiar të vendimit. Një ankim kundër vendimit të ATP-së, depozituar nga njëri prej kërkuesve ka mbetur pezull në Gjykatën e Lartë.	Endri Kotherja
76	9152/15 Depozituar më 12.2.2015	Halil Kadria	12.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 15, të datës 24 dhjetor 1996, Komisioni i Kukësit njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 7,211 metra katrorësh e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka realizuar vlerësimin financiar të vendimit dhe ankimi i kërkuesit kundër vendimit të ATP-së duket se ka mbetur pezull në Gjykatën Administrative të Apelit.	Xhevdet Sheta
77	67286/14 Depozituar më 7.10.2014	Ikbal Hyka Fatbardha Zhegu (Hyka) Lindita Tola (Hyka) Amir Hyka Genti Hyka	28/01/2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 259, të datës 23 nëntor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 2,009 metra katrorësh, nga të cilat 1.439 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 570 metra katrorë do të kompensohej në përputhje me ligjin.	Si rezultat i vlerësimit financiar të vendimit, Qeveria ka parashtruar se kërkuesit kanë marrë kompensim financiar dhe në natyrë, si rezultat i të cilit vendimi është zbatuar plotësisht. Kërkuesit nuk kanë paraqitur ndonjë informacion të azhurnuar në përgjigje të kësaj.	Sokol Puto

⁴⁶ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Elida Kotherja, Dored Kotherja dhe Elvis Kotherja.

**UDHËZIM****Nr. 44, datë 9.11.2020****PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 24, DATË 2.9.2008, “PËR
PROCEDURAT TATIMORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON

Në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 90.1 ndryshon me këtë përmbajtje:

“90.1 Në kuptim të paragrafit 1, të nenit 90, si datë e mospagimit në mënyrë vullnetare të detyrimeve tatimore do të merret dita e parë e punës mbas datës së vendosur në njoftimin e bërë nga ana e administratës tatimore, sipas paragrafit 1, të nenit 89, të ligjit dhe procedurave dhe afateve të parashikuara në paragrafin 3, të nenit 23.

Në rast se në këtë datë nga ana e tatimpaguesit nuk është paguar detyrimi tatimor, drejtori i drejtorisë përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve të papaguara apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, apo titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore, nxjerr urdhërblokimin e llogarive bankare dhe të llogarive depozitë të tatimpaguesit, si masë për garantimin e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor. Ky urdhër bllokimi u dërgohet bankave të cilat administrata tatimore ka dijeni se tatimpaguesi ka llogarinë e tij.

Urdhri i bllokimit mund të dërgohet me postë ose në rrugë elektronike (në adresat e postës elektronike që administrata tatimore dhe banka i kanë komunikuar njëra-tjetrës zyrtarisht).

Në rast se administrata tatimore lëshon urdhra bllokimi për më shumë se 20 tatimpagues, në të njëjtën ditë, ata duhet të dërgohen në format elektronik. Në të dyja rastet, çdo urdhër

bllokimi duhet të përmbajë të gjitha elementet e përshkruara si më poshtë.

Në urdhër përshkruhet identiteti i plotë i tatimpaguesit (personit juridik, personit fizik tregtar apo individit), llogaritë e të cilit preken nga dalja e këtij urdhri, që duhet të përmbajë detyrimisht emrin e plotë dhe NIPT-in përkatës të subjekteve tregtare. Urdhri i bllokimit duhet të përmbajë shkaku e nxjerrjes së tij, llojin e detyrimit që po ekzekutohet, datën kur tatimpaguesi duhet ta kishte paguar vetë detyrimin tatimor, si dhe shumën që bankat duhet të bllokojnë (në çdo rast, shuma që kërkohet të bllokohet nga bankat, është shuma më e vogël ndërmjet shumës që administrata tatimore kërkon të marrë me shumën që rezulton në llogarinë bankare të tatimpaguesit në momentin e nxjerrjes së urdhërblokimit.

Nëse urdhri i bllokimit nuk përmban elementet e përcaktuara si më sipër dhe banka e ka të pamundur të identifikojë saktë subjektin, ajo nuk vendos masën e bllokimit të llogarive/depozitave, por njofton administratën tatimore në lidhje me mangësitë e konstatuara.

Kur urdhri i bllokimit përmban elementet e përcaktuara si më sipër, Banka, brenda ditës së nesërme të punës nga dita e marrjes së urdhrit, bën bllokimin e llogarive/depozitave të tatimpaguesit, deri në shumën e detyrimit tatimor të papaguar dhe brenda 5 ditëve pune nga marrja e urdhrit njofton administratën tatimore për gjendjet e llogarive/depozitave të tatimpaguesit. Në qoftë se tatimpaguesi ka më shumë se një llogari në të njëjtën bankë, banka, mbi bazën e urdhrit të organit tatimor, bllokon vetëm llogarinë/llogaritë që kanë shumën e mjaftueshme të detyrimit të papaguar.

Informacioni në lidhje me gjendjet e llogarive/depozitave të bllokuara mund të dërgohet nga banka me shkresë zyrtare ose në rrugë elektronike. Gjithashtu, brenda këtij afati banka bën njoftimin e debitorit me shkrim ose në mënyrë elektronike për marrjen e urdhrit të bllokimit.

Brenda 2 ditëve pune nga marrja dijeni për bllokimin e shumave të caktuara në llogaritë/depozitat bankare, administrata tatimore i dërgon bankës apo bankave të cilat kanë konfirmuar gjendjet në llogari, një urdhër ekzekutimi, i cili duhet të përmbajë shumën që kërkohet të



transferohet, si dhe numrat e llogarive. Urdhri i ekzekutimit duhet të jetë i shoqëruar edhe me urdhër pagese ose faturë për arkëtim, ku përcaktohen kodet e llogarive apo *barcode*-t.

Transferimi i shumës mbi bazën e urdhrit të ekzekutimit bëhet nga banka jo më vonë se 3 ditë pune nga dita e marrjes së urdhrit. Për kryerjen e këtij veprimi dhe brenda të njëjtit afat, banka njofton administratën tatimore dhe subjektin me shkrim ose në rrugë elektronike.

Në rast se detyrimi i tatimpaguesit ekzekutohet plotësisht, administrata tatimore dërgon menjëherë një urdhër zhbllokimi në adresë të bankave ku tatimpaguesi është klient.

Në rast se detyrimi i tatimpaguesit ekzekutohet pjesërisht, administrata tatimore dërgon një urdhër të ri bllokimi drejtuar bankave, ku tatimpaguesi ka llogari bankare për shumën e detyrimit tatimor të papaguar që rezulton mbas kryerjes së ekzekutimit të pjesshëm.

Në rast se tatimpaguesi nuk ka gjendje në llogaritë bankare në asnjë nga bankat, llogaritë do të vazhdojnë të mbahen të bllokuara në bazë të urdhërbllokimit, që është lëshuar nga administrata tatimore.

Në zbatim të nenit 99, të ligjit nr. 9920/2008, nëse pas zbatimit ndaj subjektit të të gjitha masave shtrënguese për mbledhjen me forcë të detyrimit (duke përfshirë edhe shitjen e pasurisë së sekuestruar), detyrimet tatimore të personit juridik nuk shlyhen plotësisht, administrata tatimore e transferon detyrimin tatimor të mbetur të subjektit tek ortakët, aksionarët dhe administratorët. Për këtë qëllim, fillimisht administrata tatimore garanton mbledhjen e detyrimit nëpërmjet vendosjes së urdhërbllokimit mbi llogaritë dhe depozitat e ortakëve, aksionarëve dhe administratorëve të subjektit dhe më pas zbaton ndaj tyre masat shtrënguese të mbledhjes me forcë të parashikuara në Ligjin nr. 9920/2008. Edhe në këtë rast, urdhërbllokimi si masë preventivuese vendoset sipas procedurave të paragrafit të dytë të kësaj pike.

Një urdhër bllokimi do të jetë i vlefshëm për një periudhë 12-mujore nga dita e vendosjes së masës së bllokimit të llogarive /depozitave. Me kalimin e këtij afati, llogaritë /depozitat zhbllokohen automatikisht nga banka pa nevojën e ndonjë njoftimi shtesë.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 451, datë 28.10.2020

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHTETIN E BELGJIKËS,
BULLGARISË, KROACISË,
GJERMANISË, LUKSEMBURGUT,
ZVICRËS, PORTUGALISË, RUMANISË,
GREQISË DHE MAQEDONISË SË
VERIUT**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, e Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në informacionin e marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE),

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë për shtetet e mëposhtme:

- Shteti i Belgjikës, përkatësisht provinca Neufchâteau, Luxembourg; Oostkamp, West-Vlaanderen; Meix-devant-Virton, Luxembourg.

- Nga shteti i Bullgarisë, përkatësisht provinca Sliven dhe Lovec.

- Nga shteti i Kroacisë, përkatësisht qarku Istarska, Bashkia Buzet, fshati Sveti Martin; qarku Istarska, Bashkia Buzet, fshati Seljaci; qarku Istarska, Bashkia Labin, fshati Bartici.

- Nga shteti i Gjermanisë përkatësisht provinca Rheinland-Pfalz, rrethi Trier-Saarburg, Bashkia Farschweiler; provinca Saarland, rrethi Merzig-Wadern, Bashkia Losheim am See.

- Nga shteti i Luksemburgut, përkatësisht kantoni Redange, fshati Colpach.

- Nga shteti i Zvicrës, përkatësisht kantoni i Bern, rrethi Bern-Mittelland, Bashkia Oberbalm;



kantoni Luzern, rrethi Willisau, Bashkia Dagmersellen.

- Nga shteti i Rumanisë, përkatësisht qarku Vilcea, zona e Turcesti.

- Nga shteti i Greqisë, përkatësisht provincat: Dytiki Makedonia; Kentriki Makedonia; Samos_4, Voreio Aigaio; Samos_5, Voreio Aigaio; Lesvos_1, Voreio Aigaio; Lesvos_2, Voreio Aigaio; Lesvos_3, Voreio Aigaio; Anatoliki Makedonia Kai Thraki; Thessalia; Sterea Ellada; Dytiki Ellada; Dytiki Makedonia; Peloponnisos dhe Ipeiros.

- I gjithë territori i shtetit të Maqedonisë së Veriut.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit për çdo

ngarkesë të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 275, datë 15.7.2020, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Gjuhës Blu, të shfaqur në shtetin e Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 728 lekë